PETRAQ KOLEVICA

ARKITEKTURA DHE DIKTATURA

MARIN BARLETI
1997

PETRAQ KOLEVICA

ARKITEKTURA DHE DIKTATURA

TIRANË 1997

© të drejta të rezervuara nga autori

Shtypur në shtypshkronjën e shtëpise Botuese
"MARIN BARLETI"

Para se të filloj të shkruaj këto faqe kujtimesh nga jeta ime profesionale, dëshiroj të përshëndes arkitektët e rinj të sotëm e ca më tepër ata të nesërm, me këto vargje të poetit B BREHT:

"Ju, që dolët mbi ate dallgë,
Poshtë së cilës u zhytëm ne,
Kur të flisni për dobësitë tona,
Kujtoni
Edhe kohët e errëta
Nga të cilat shpëtuat"

Duke qenë një nga të paktët arkitektë që kanë mbetur prej atyre të cilët kaluan një jetë profesionale intensive në kushtet e diktaturës komuniste në Shqipëri dhe ndoshta i vetmi që mund të shkruajë më gjerë për sa pësuan arkitektët dhe arkitektura në atë kohë të mbrapshtë, e ndiej për detyrë të rëndë morale e madje historike, të hedh dritë mbi të vërtetat e hidhura të cilat duhet t'i dinë ata që do të vinë. Ky është qëllimi i këtij shkrimi. Nëse dikush tjetër ka për të thënë më tepër, bën mirë të mos heshtë.

HYRJE

Në një familje patriarkale të vjetër korçare prej katërmbëdhjetë frymësh, ku gjyshi ishte autoritet absolut, nga një baba i urtë e punëtor dhe një nënë e gjatë, elegante, e fortë, që në moshën 36 vjeçare bënte fëmijën e gjashtë, pas pesë çupave, na lindi një djalkë i bukur, i shëndetshëm.Ishte duke u gdhirë 11 Janari i vitit 1934.

Gjyshi, që mezi e priste, tha: "Emrin do ta ketë si i ndjeri im vëlla, Petro. I them vetë kumbarës." Me këtë emër e pagëzuan në kishën e Mitropolise. Djalka rritej, zbukurohej, me sy të kaltër, si i ati. E mbanin pastër, e vishnin bukur. E deshin fort të gjithë, por ledhat ishin të ndaluara.

Kur u bë tre-katër vjet, në mbrëmje, kur gjyshi rrinte shtrirë te këndi pranë vatrës, i thoshte: "Petro, pa na i loj atë vallen."

Dhe djalka çohej e hidhte këmbët lart e poshtë duke kënduar:

"O, kjo nepërka pika-pika,
O, kur e pashë ç'më zu frika..."

Pastaj, në ata dimrat e bukur të Korçës mbuluar me dëborë, e ëma gjente kohë e rrinte me të pranë dritares prej nga shihnin se si kërcenin rabeckat e verdhashët, që atëherë ishin të shumtë dhe i fuste dashurinë për ta. Dhe ai kurrë nuk mbajti llastikë e nuk vrau zogj, nuk kapi flutura e nuk lidhi buzëbardhë.

Ende pa shkuar në shkollë, dinte diçka nga poezia që fillon me vargjet:

"Një zog të bukur zuri një djalë,
Ai po dridhej e i thosh ca fjalë..."

Qysh i vogël pati rritur çdo vit nga një qengj të bardhë rudak duke e ushqyer me qumësht me biberon. Pastaj mbajti lepura, pëllumba. Kishte Tomin, një qen të bukur, të zi. Në kopshtin e shtëpisë kishin breshkë, iriq. Mbanin dy mace të zeza. Moli lopë, lau e fshiu bajga pa ndot. I ndoqi kuajt në lëmë, u hodh e i çorri shalët nëpër mullarët me kashtë dhe kur ktheheshin në mbrëmje kapte ndonjë xixëllonjë dhe e ngjiste në ballë. Por shpejt erdhën vitet e luftës... Ditët e hyrjes së ushtarëve italianë, megjithëse atëherë ende nuk i kishte mbushur gjashtë vjetët, do t'i sillte ndërmend gjithmonë si pamje filmash dokumentarë të dëmtuar vende-vende nga drita e të çjerrat. Pastaj bombardime, vrasje. Ardhje ushtarësh grekë, italianë, pastaj ushtarë të rëndë gjermanë.

Tani-tha daja i madh-mos bëni më shakara si me italianët. I pashë vetë këta se ç'bënë, kur hynë në Greqi. Këta s'kanë burg. Kanë plumb. Dëgjuat, moj çupa? Mos bëni shakara!

Mirëpo, dy motrat e mëdha përsëri vazhduan të thurnin triko, të qëndisnin e të prisnin yje për partizanët, ndërsa dy më të voglat, bënin mbledhje e këndonin këngë të ndaluara. Këngët i mësonin shpejt edhe djali i këndonte bashkë me to, kur dilnin nga fushat. Pastaj kontrolle, arrestime. Dy motra partizane. Së fundi gjëma e madhe: Ndërsa ushtria gjermane largohej, partizanët afroheshin për të hyrë në Korçë. Për t'i mbajtur ata sa më larg, artileria gjermane qëllonte fushën përqark dhe aty, në fermën e tij të dashur, u vra babai.

Djalit, tashmë dhjetë vjet, i thane: "Je burri i

shtëpisë" dhe ai priti ngushëllime përkrah nënës të veshur në të zeza.

Erdhi dhe çasti ta merrnin babanë. Puthe-i thanë-se do ta marrin. Ai u ul, e puthi në ballë, po ftohtësia e atij balli, i mbeti në buzë për gjithë jetën.

* * *

Të tëra këto, më vonë, do të kujtoheshin si ndodhi lufte për t'i ritreguar në netë të gjata dimri, sikur në ato vite lufte të mos kishte ndodhur një shpërthim fatal: Ditë e bukur Korriku 1941. Në oborr janë gratë e shtëpisë e bëjnë biseda e punë dore. Djali se ku paska gjetur një si fishek, se ç'i thotë men tja të ndezë një shkrepse e ta futë brenda në të dhe në çast, një krismë e tmerrshme!

Dora e djalit e mbytur në gjak... E zeza gjyshe nxorri një shami të bardhë e ia mbështolli shpejt. Një djalë i mëhallës, që po kalonte rastësisht me biçikletë, e rrëmbeu, e vuri përpara dhe e shpuri në spital.

Pas nja dy javësh dora e fashuar u hap për herë të parë në shtëpi. E pa e ëma, babai, motrat. E pa vetë djali. S'kishte më dorë të majtë. Në vend të saj, një si gisht i gjatë...

Dalëngadalë plaga u pastrua dhe ajo si dorë gjeti vend në xhepin e pantallonave, të xhaketës, të palltos. Djali nuk para loste jashtë. Loste në oborr ose shkonte nga teta, ku s'kishte fëmijë dhe e donin fort.

Ah, të mbarojë kjo e shkretë luftë-thoshte Ollga-pa ne do të na dërgojë Agathia ilaçe nga Amerika, do t'i hedhim në një legen me ujë të ngrohtë, do ta fusim doçkën brenda dhe do të shikoni se si do të rriten gishtërinjtë. Djali qeshte por, nganjëherë, i pëlqente gënjeshtra. Megjithatë jeta filloi të jepte shuplaka: Rriteshin thonjtë e dorës së djathtë. Nuk donte t'ia prisnin të tjerët, as e ëma dhe i këputste me dhëmbë. Duheshin lidhur këpucët. Pse, gjithnjë të tjerët do t'ia lidhin? Dhe ai fshihej prapa shtëpisë e cfilitej duke bërë prova t'i lidhte me atë gisht. Në shkollë

kishte shokë të mirë dhe asnjëherë nuk e ngacmuan, por veten e ndjente ngushtë dhe kjo e bënte të vuante. Për të, ora më e vështirë në shkollë ishte ajo e fizkulturës, kur mësuesi thërriste: "Zhvishni xhaketat"! e vazhdonte: "Duart lart! Duart anash! Shtriji! Zgjati"! Dhe ai ishte i detyruar të zgjaste jo dorën e majtë, si të gjithë, po atë gisht të gjatë, sikur desh t'i nxirrte sytë shokut çfarë kishte pranë. Po kur i vinte mësuesi të losnin volejboll, ai ç'të bënte? Si ta priste topin? Po në klasën e pestë, pse e vunë në bango me një çupë? Si ta mbante fletoren ai?

Pastaj erdhi një kohë, kur i pëlqente të shihte veten në pasqyrë... Shihej e krihte flokët, rregullonte vetullat, shihte sytë. Pastaj, si palloi, që mbasi ka hapur bishtin e bukur ngjyrashumë, ul kokën e sheh këmbët e veta të shëmtuara e klith me zë të mbytur edhe atij i kujtohej dora e majtë, shtynte pasqyrën e binte përmbys në shtratin e tij. Jo, jo, nuk qante. Hante jastëkun me dhëmbë.

KREU I PARE

Për këtë djalë që-siç e kuptoni-jam unë, deri këtu e kisha më të lehtë të flisja në vetën e tretë. Tani do tëvazhdoj të flas në vetën e parë:

Viti 1952. Përpara se të mbaronim klasën e katërt në Gjimnazin e Korçës, na thanë të bënim lutje me kërkesën se në ç'degë dëshironim të vazhdonim studimet e larta. Nuk shikohesha me sy të keq nga njerëzit e partisë në Gjimnaz, po as me sy përkëdhelës, prandaj e dija se nuk do të më jepej bursë për studime jashtë shtetit. Megjithatë, duke u tallur me veten e me shoku-shokun, i bëmë ato lutje me kërkesa qesharake, ku pata shprehur dëshirën të studjoja për tregti të jashtme, sepse më kishin thënë që atje mësonin dy-tre gjuhë të huaja dhe mua ato më duheshin për qëllime të tjera.

Të vërtetën e asaj kohe për bursën time e mora

vesh plot dyzet vjet më vonë, kur më ra në dorë dosja me shkresa që mbahej për mua në zyrën e kuadrit të Institutit, ku pata punuar. Aty gjendej dhe shkresa me vendimin e organizatës bazë të partisë të Gjimnazit, ku thuhej:

I ati ka pasur 20 ose 30 dynym tokë në të cilën ka mbajtur dhe bagëti si lopë...nga reforma agrare i është marrë toka. Për bagëtinë që kanë, nuk u janë dhënë triskat e bukës".

Dhe përfundon:

"Opinioni i komisionit është që t'i akordohet gjysëm burse brenda shtetit".

Nejse. Fundi i Gushtit i dha fund pritjes sime e merakut të nënës. Më lajmëruan se më jepej bursë të studioja në Institutin Politeknik të Tiranës, në degën e Inxhinierisë së Ndërtimit.

Në kushte të tilla të këqia banimi, ushqimi e studimi, që s'mund të kuptohen nga studentët e sotëm e ca më pak nga ata të nesërm, mbarova të pesë vjetët e asaj shkolle.

Me disa profesorë rusë dhe me inxhiniera shqiptarë, që para tre-katër vjetësh kishin mbaruar studimet e tyre, kryesisht në Bashkimin Sovjetik, zhvilluam një mori lëndësh teknike, ku arkitektura zinte vendin përtej fundit.

Zoti Besim Daja, më shumë nga dëshira e tij e mirë për të na dhënë disa njohuri, se sa për plotësimin e programit mësimor, na bëri katër a pesë orë mësimi mbi historinë e arkitekturës ku, mbasi kaluam në një panoramë të shpejtë dhjetra shekuj të arkitekturës antike, asiro-babilonase, egjiptiane, greke, romake, asaj mesjetare e të rilindjes, një orë e tërë iu kushtua kritikës së arkitekturës të epokës tëkapitalizmit e veçanërisht asaj amerikane, që stigmatizohej si më e keqja. Doemos, profesori ynë i nderuar, s'mund të bënte dot ndryshe kur, në çdo gjë, lëvdohej Bashkimi Sovjetik e shahej Amerika.

Gjatë viteve që vazhdova atë shkollë, e vetmja revistë arkitekture që vinte e lejohej të shihej ishte

Petraqi rrjeth prej një shtrese me origjinë sociale bujk i mesëm,i ati ka pasur 2o ose 30 dynym tokë në të cilën ka mbajtur dhe bagëti si lopë.Qëndrimi i sotëm politik është i mirë vetëm se nga Reforma Agrare i është marrë toka.I ati i tij është vrarë nga gjermanët gjatë kohës që punonte,me gjith këtë gjendja e sotme ekonomike është e mirë,kanë katër lopë dhe një shtëpi.Për bagëtinë që kanë nuk u janë dhënë triskat e bukës.

Dëshëron të ndjekë studimet e larta në njërën nga këto degë:1)Inxhinieri radjo,2)Mjekësi dhe 3)Tregti të jashtme.Opinioni i Komisionit është që ti akordohet gjysmë burse brenda Shtetit.

K O M I S I O N I :

E delehuar e Kom.Partisë:
(LIRI ARANITASI)

Drejtori i Gjimnazit:
(KRISTAQ DRIJAKO)

N/Kryetar i Kom.Ekz.:
(I[illegible])

Sekretari i Org.Bazë Gjimnazit:
(NESTI KARAGUNI)

"**Arkitektura CCCP**" (Arkitektura e B.Sovjetik). Ekspozitat me fotografi nga B.S. paraqesnin përgjithësisht pamje nga Metroja e Moskës, nga Universiteti me majuca i Moskës, nga ndërtimet e vjetra të Leningradit të gjitha të një arkitekture neoklasike, si dhe vepra të kota zbukurimi me monumentin e Stalinit gjatë kanalit Vollga-Don. I vetmi libër mbi historinë e arkitekturës në B.S. lëvdonte arkitekturën butaforike, që lulëzoi në B.S. pas luftës së dytë botërore dhe shante ashpër fillimet e arkitekturës moderne në B.S. në vitet '30. Së fundi u propogandua Ekspozita Bujqësore e B.S. që ishte me të tërë kuptimin e fjalës, një marrëzi arkitektonike.

Në ato vite, (1952-1957) kur unë vazhdoja Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, shtypi, radioja, kinemaja, konferencat, s'kishin gjë tjetër veçse lëvdata për B.S. të cilat amplifikoheshin në muajin e miqësisë shqiptaro-sovjetike (muaji Tetor) kur na mësonin të këndonim këngën për kodrat "Lenin", ku ngrihej Universiteti i Moskës, këngë që fillonte me vargun:

"Druzja', ljublju' Ja Leninskie góri..."
("O miq, unë i dua kodrat e Leninit...")

Në këtë atmosferë më gjeti pranvera e vitit 1957, kur do të filloja projektin e diplomës. Si temë m'u caktua projektimi i një kinoteatri dhe konsultent u caktua arkitekti Gani Strazimiri, që kishte studiuar në B.S. dhe në atë kohë mbahej si arkitekti më i zot. Dhe me të vërtetë, për atë lloj arkitekture, ai ishte pa konkurent.

Në vitin 1952-1953, kur fillova Institutin Politeknik, në një nga sallat e "Shtëpisë së miqësisë Shqipëri-B.S." në Tiranë, u ekspozua projekt-diploma e Gani Strazimirit. Kishte kryesisht pamje në perspektivë ndërtesash banimi të stilit të arkitekturës sovjetike, por të punuara prej tij me aftësi të rralla profesionale.

Fatkeqësi, që ai njeri nuk bëri shkollë të mirë europiane perëndimore dhe që jetoi në një kohë, kur ideologjizimi mbyste gjithçka.

Para se të vazhdoj të flas më tej për projektin e diplomës sime, më duhet të hap një parantezë te gjerë:

Në periudhën e Shtetit të parë shqiptar, që lindi si

Republikë e vdiq si Mbretëri, veçanërisht në vitet 1930-1940, nëpër qytetet tona kryesore u bënë ndërtime nën frymën e arkitekturës protomoderne, e cila kishte filluar të përhapej në Europë. Kështu mund të përmendim godinat e bankave në Korçë e në Tiranë, hotelin "Dajti" etj. Vlen të përmendet në këtë kohë arkitekti Qemal Butka, që projektoi Bashkinë e Korçës, një kopësht fëmijësh në Tiranë, që fatkeqësisht u prish, si dhe banesën e tij, ku është i pari që futi me sukses elementë të arkitekturës kombëtare në arkitekturën e kultivuar. Nuk duhet harruar as shoku i tij, arkitekti austriak, që bëri plot ndërtime të bukura në Sarandë.

Pushtimi fashist italian, ndonëse i shkurtër e në gjendje lufte, për interesat e veta e me synime koloniale, bëri ndërtime deri atëherë të panjohura në Shqipëri Kështu p.sh. u ndërtuan të parët blloqe banesash 3-4 katshe me apartamente, godina e Kryeministrisë Kompleksi i sotëm Universitar dhe Materniteti në Tiranë. Nuk duhen harruar as vilat nazike që u ndërtuan në Tiranën e re para e gjatë atij pushtimi, e as ndërtesa e kishës katolike

Megjithëse në ndërtesat qeveritare të ndërtuara gjatë pushtimit ndihej fryma e stilit të arkitekturës fashiste të Piacentinit, në përgjithësi u bënë ndërtime të bukura, me arkitekturë moderne, me materiale veshës e punime të cilësisë së lartë. Gjithashtu, në vitet e para të pushtimit, kur u zhvillua tregtia dhe shumë njerëz shkuan në Itali e gjetiu, panë ndërtimet e reja të atjeshme, gjë që e forcoi edhe më shumë shijen e popullit pro arkitekturës moderne aq dhe si mundnin ta kuptonin intuitivisht ata njerëz.

Kështu, viti 1945, e gjeti popullsinë qytetare shqiptare, veçanërisht atë të shkolluar, me një shije relativisht të formuar pro arkitekturës moderne, racionale, funksionale.

Intelektualët, që kishin studiuar në vendet kryesore të Evropës dhe ishin kthyer të punonin në vendlindje, dinin t'i çmonin ndërtesat si hotel 'Dajti', Banka e Materniteti në Tiranë dhe ato mbetën për shumë kohë njësi matëse krahasimi në gjykimin e vlerave arkitektonike të ndërtesave të mëvonshme.

Ndërkohë filloi ndryshimi i sistemit shoqëror.

Krahas entuziazmit sipërfaqësor të rindërtimit, filluan traumat e para sociale: burgimet, internimet, shpronësimet. Pas dashurisë me Titon, filloi inçesti me Bashkimin Sovjetik. Krahas ndihmave ekonomike me synime politike, vërshuan e na përmbytën dallgëtpropagandistike Radioja fliste gjithe ditën për B.S. e prej saj buçisnin këngët ruse. Përmbi letërsinë dhe artet shkoi ruli i realizmit socialist. Ansambli "Bjerjoska" me fustanet e gjata mbuloi skenat tona. Ballallajka e mbyti çiftelinë, Tvardovski përshkonte Labërinë, poetët himnizonin Stalinë.

Duke mos dashur të le shteg për keqkuptime, them se mëria për propagandën e kohës nuk ma zbehu dëshirën për të njohur kulturën ruse.

I mësuar me kanconetat melodioze e zërin e ëmbël të tenorëve italianë, nuk e pata të lehtë të pëlqeja të madhin Shaljapin apo basin Rajzen.I mësuar me operat italiane, nuk më tërhiqnin operat ruse, por dalëngadalë fillova t'i shijoja e të mësoja pjesë nga ariet e tyre. Jo rrallë, kur më dilnin pengesa në punën time dhe nuk bëja dot atë që dëshëroja, e këndoja arien e njohur të knjaz Igorit: O dajte, dajte mnje svabodu !..

(O nëmni, nëmni mua lirinë !...)

Shumë shpejt pastaj u familiarizova me këto opera, dëgjoja i panginjur arien e Ivan Susaninit dhe entuzjazmohesha me finalen madhështore që mbyllet me kumbimet magjepsëse të kambanave dhe korin që buçet duke kënduar: Sllavsja, ti, sllavsja ti rus maja ...

(Lavdi më ty, lavdi, o rusia ime ...)

Njoha poezinë mahnitëse të Pusnkinit, Lermontovit, Bllokut etj. që më mësuan njësi matjesh të reja në vlerësimin e krijimtarisë poetike dhe më nxisnin t'i bëja të dëgjoheshin shqip. Njohja me kulturën ruse ishte një fenomen i dhimbshëm, një dashuri e përzjerë me urrejtje. Përmbi "Zaporozhasit" dhe "Burllakët" e Rjepinit, binin pllakatet me Stalinin. Përmbi filmin "Ivani i tmerrshëm" binin filma të shpifur si "Kazakët e Kubanit". Përmbi poezinë klasike ruse binin cicërimat e Isakovskit dhe vargjet trumbetuese të Majakovskit.

"Shikoëni, kimëni zili!

Jam qytetar i Bashkimit Sovjetik."

Qysh në vitin e fundit të gjimnazit ne filluam të talleshim me propagandën megallomane shoviniste ruse. Në librin tonë të historisë, fizikës etj. në shumë faqe kishte shënime ku "sqarohej" se shumë shpikje të bëra nga shkencëtarët europianë apo amerikanë në shek. XVIII e XIX ishin bërë kohë më parë nga rusët. Në njërin prej këtyre shënimeve p.sh. thuhej se hekurudhën e kishte shpikur një kovaç nga Urali që shinat i pati bërë prej druri.Bujë të madhe bëri dhe pretendimi rus për shpikësin e radios, - Jo!- klithej atëherë - radion nuk e ka shpikur Markoni, por shkencëtari i madh rus Popov! U botua edhe një karikaturë ku Markoni paraqitej si xhuxhmaxhuxh që kacavirej të zgjatej për të arrirë Popovin të paraqitur si burrë të gjatë, madhështor e plot dinjitet. Madje dhe hija e Lomonosovit mbulonte Njutonin.

Shkurt mund të thuhet se propaganda e atëhershme mundohej t'i bindte njerëzit që më e larta, më e mira, më e bukura, më e madhja, më e vogla gjë në botë ishte bërë për herë të parë në Rusi, por nuk ishte marrë vesh, fajin e kishte regjimi carist.

Për të vënë në lojë këtë propagandë megallomane absurde, atëhere qarkullonte një barcaletë e tillë: "Elefanti i kopështit zoologjik të Moskës - elefanti më i madh në botë."

Propaganda e llojit të mësipërm u shtri pastaj e u materializua në arkitekturë.

Këtu ora eci mbrapsht të paktën një shekull. Me projekte të ardhur nga "Bashkimi i madh Sovjetik" e me saze propagandistike nga prapa, u ndërtuan Kombinati i Tekstileve e Kinostudioja në Tiranë. Në fillim të viteve '50 erdhën disa arkitektë që kishin studiuar në B.S. e bashkë me ta, u zyrtarizua arkitektura butaforike sovjetike, që polli e mbolli në të gjithë Evropën Lindore monstra ndërtesash të shëmtuara. Kështu tek ne u ndërtuan banesat në Shallvare e gjatë Lanës, në Tiranë, hoteli "Adriaktik" në Durrës, Teatri në Shkodër etj. Dhe ky stil u kurorëzua me ndërtesën e Komitetit Qëndror. Të gjitha këto bëheshin në kohën kur unë vazhdoja Fakultetin dhe ndonjëri nga ata arkitektë ishte dhe pedagog tek ne. Madhështia e rremë, që kërkohej të

arrihej me ndërtimet e mësipërme, solli një farë arkitekture të shpërshishur me kollona të kota, kapitele, korniza e dekore jashtë kohe që gjeti shpejt mosmiratim në popullin tonë-siç thamë-të edukuar me një shije krejt tjetër, aq më tepër që kjo lloj arkitetkure importohej detyrimisht me dhunën ideologjike.

KREU I DYTE

E thashë, se po mbaroja Fakultetin e Inxhinierisë pa marrë në atë shkollë njohuri të sakta mbi historinë e arkitekturës botërore dhe i stërngopur me lëvdatat për arkitekturën socialiste sovjetike, megjithatë formimi im botëkuptimor e kulturor, herë i ndërgjegjshëm e herë jo, ishte tërësisht properëndimor. Në këtë çështje kishte ndihmuar ambienti familjar e shoqëror, ku u rrita.

Qysh kur isha 5-6 vjeç, nëna e babai im shkuan në Athinë dhe pastaj, për shumë vite me radhë nëna më tregonte ç'kishte parë atje, si ishte jeta, si qe Akropoli e më tregonte fotot që kishin bërë atje pranë Kariatideve etj.

Në kohën e pushtimit italian të Shqipërisë, motra e dytë, e talentuar për pikturë, mori pjesë në kurset që hapën murgeshat, ku mësoi të bënte punë dore me ngjyra vaji etj. por atje mësoi dhe italishten. Gjatë kohës së luftës dhe deri sa mbarova gjimnazin, radioja në shtëpinë tonë buçiste nga këngët italiane, duke filluar nga trio Leskano, që sot janë harruar e deri tek ariet e shkëlqyera të Beniamino Xhilit. Pas luftës, kur Italia mori Triesten, së bashku me motrën, dëgjuam koncertin e fundit të Xhilit përpara popullit të Triestes. Dhe përsëri, së bashku, dëgjonim gjithë ankth krizën e Berlinit dhe urën ajrore. Pastaj, isha në klasën e parë të gjimnazit, kur munda të dëgjoja për herë të parë nga fillimi deri në fund një opera në radio. Ishte opera "Madam Batërflaj", ajo që më mbajti me veshin të mbërthyer pas radios. Prej kohësh, i njihja melodítë e "korit gojëmbyllur" dhe finalen prekëse të saj, por asaj nate u mrekullova. Pas luftës, Kristo Kono, me

korin e Shtëpisë së Kulturës në Korçë, vuri në skenë pjesë nga operat italiane. Në atë kor mermin pjesë dhe dy motrat e mia dhe për shumë kohë shtëpia jonë kumbonte nga zërat e tyre të bukur, kur këndonin:

Noi siamo Zingarelle
Venute da lontano...

Ndërsa e ndjera nëna ime, që ishte gjithnjë e zënë me punë, kur dëgjonte të transmetohej në radio kori i skllevërve hebrej nga "Nabuko" e Verdit, më thërriste: "Petri! Hapja zërin gjer në fund ta dëgjojmë mirë". Pastaj, kur qëllonte të transmetohej në radio kënga "La paloma" e dëgjonte me vëmendje kokulur e fliste me vete plot mallëngjim: "Sa bukur e kanë kënduar këtë të shkretë këngë në dasmën time...".

Daja im i madh kishte qenë në Athinë, në Itali e për mjaft kohë në Paris dhe tregonte për jetën në ato vende, tregonte për Metronë që kalon poshtë Senës, tregonte foto të qyteteve nga kish kaluar.Në bibliotekën e vogël të dajës tjetër, që ndiqte shkollën tregtare në Vlorë, ishin dy vëllime italisht me ilustrime (vizatime) të shkëlqyera mbi Revolucionin Francez, ku unë njoha fytyrat e të mëdhenjve iluministë, që në shkollë i përmendnim cektas në orën e historisë.Në atë bibliotekë gjendej dhe një Petit Larousse. Deri në klasën e parë të gjimnazit kisha bërë një vit e gjysëm frengjisht. Lexoja lirshëm dhe kuptoja tekste të thjeshtë. Te Laroussi lexoja kapitullin ku kish foto dhe pak biografi të njerëzve të shquar. Aty gjeta dhe Leninin! Fotografia jo e bukur, siç e shihnim nëpër pllakatet sovjetike, kurse biografia fillonte me fjalët: "V.L.Lenin. Dictateur russe!" Pra, Laroussi, që në ambientin filofrancez korçar kishte autoritet të padiskutueshëm, e quante Leninin, Diktator!Po këta, pse e lëvdojnë?

Ndërkohë u martuan tri motrat e mia. E madhja kishte burrin me pak shkollë, por punëtor e mjeshtër të punimit të drurit. Kishte dhe një punishte me makineri të kohës. Ishte tepër i çiltër, i drejtë, fliste me zë të lartë si pasojë e profesionit me shumë zhurmë. Ishte tipi i korçarit të thjeshtë, që do të punojë, të fitojë, të jetojë mirë vetë e

familja. Në rrethin familjar, në ato kohë të trazuara, deri në fillim të viteve '50, zhvilloheshin shpesh diskutime të zjarrta. Ndër të afërmit kishte dhe komunistë që qëllonin të ndodheshin në ato diskutime.

Burri i motrës së madhe ishte i papërmbajtur kundër afrimit me Bashkimin Sovjetik dhe ngandonjëherë u drejtohej të afërmve komunistë duke u thënë:

- E, ore, juve jini korçarë, e njihni Kovin?

(Kovi ishte një lypsar shumëvjeçar në Korçë, më leckamani i lypsarëve)

- E, bre, flisni, e njihni Kovin?

- Po-i thoshin ata.

- E po, ë, në Korçë, bën njeri krushqi me Kovin? E, bre, flisni, bën njeri krushqi me Kovin?

- Jo, thoshin ata me ndrojtje, se s'dinin ku desh të dalë.

- E po, ja!-thërriste i ndjeri Miti-Rusia është si Kovi, leckamane, bythëjashtë. Ç'doni që bëni krushqi me Rusinë, me Kovin? Bëni, ore krushqi me Calen! (Cale, familje e njohur dhe e pasur në Korçë).

-Amerika është si Calja. Bëni krushqi me Amerikën. Dollari shkon në gjithë botën, nuk shkojnë mangëret e Rusisë (Mangëre - monedha bakri të vjetra turke, të mbetura pa vlerë e me to luanin kalamajtë).

Unë nuk merrja pjesë në ato diskutime. Dëgjoja, inkasoja dhe i ribluaja me vete. Për Bashkimin Sovjetik, aq fort të lavdëruar asi kohe, hidhte dritë të papëlqyeshme edhe kjo: Vëllai i gjyshes sime nga nëna, kishte qenë me punë në Odesë qysh para revolucionit, ku kishte krijuar dhe familje por, në fillim të viteve '30 e dëbuan, ia morën ç'kishte pasuri e shtëpi dhe ai u kthye në Korçë. E shoqja e tij, Manja, grua ruse, e dashur, punëtore, e shëndoshë si burrë, tregonte gjithë ato gjëra të këqia për Rusinë Sovjetike, por njerëzit nuk e besonin sepse s'mund ta konceptonin dot rrëmbimin e pasurisë nga shteti dhe sepse propaganda prosovjetike e grupeve komuniste ishte e madhe, veçanërisht gjatë luftës. Pastaj, pas luftës, kur erdhën në pushtet komunistët në Shqipëri, Manja qeshte me burrat e gratë e fisit tim: "Tani do të më besoni-u thoshte-Tani do ta besoni Manjan...". Dhe pastaj e besuan, por ishte tepër vonë...

Ndërkohë, ende pa u konsoliduar mirë pushteti komunist, filloi plot bujë reforma agrare që-siç thuhej-ua merrte tokat bejlerëve të cilët ia kishin rrëmbyer popullit. Edhe ne, ajo reformë,-siç shënohet në shkresat e dosjes sime të zyrës së kuadrit-na mori 20-30 dynym tokë. Unë atëherë, tepër i ri, nuk e kisha ndjenjën e pronës, por e dija që babai im, për t'i pasur ato toka, as vrau njeri për t'ia rrëmbyer, as vodhi. Qysh se ardha ndërmend e deri në moshën 11 vjeçare, kur ai u vra duke mbledhur misrin, djersën e vet, ai nisej në punë herët në mëngjes, kur unë ende flija dhe kthehej në mbrëmje vonë. Ulej te minderi, më merrte pranë e duke pirë një gotë raki me pak djathë, fillonte dremiste nga lodhja e tepërt, ndërsa gishtat vazhdonin t'i lëviznin sikur milte lopët. Me punë të tillë të rëndë ishin vënë ato 20-30 dynym tokë.

Aktin e rrëmbimit të tyre nga reforma, unë nuk e shihja si rrembim të pronës, por si një padrejtësi ndaj punës së babait tim dhe kjo më revoltonte.

Vera e vitit 49. Në shtëpinë e kulturës, në Korçë, u hap një kurs vizatimi me nja 10-15 veta. Mora pjesë në atë kurs, ku isha më i riu. Kursin e drejtonte ish-profesori im, i ndjeri piktor Vangjush Tushi. Përveç kujdesit që tregonte ndaj meje për mësimin e vizatimit, më ftoi disa herë në shtëpi, ku më tregonte pikturat e tija dhe më fliste për Rilindjen Italiane. Natyrisht, si i ri që isha, pesëmbëdhjetë vjeç djalë, ndaj profesorit tim rrija me ndrojtje, dëgjoja e s'guxoja të flisja. I ndjeri profesor e shihte këtë dhe gjeti një mënyrë fisnike të më zhgarkonte nga ndrojtja. Nuk do ta harroj atë lëvizjen e tij delikate, kur nxorri nga dollapi një shishe të gjatë me liker të zgjedhur kymeli. Atë shishe transparente me disa kristale të mëdhenj e një degë të thatë kymeli brenda, mbase mund ta mbajë mend ende ndonjë intelektual sqimatar 70-75 vjeçar.

Nga ai liker më mbushi një gjysëm gote të vogël, shtiu po aq për vete dhe më ftoi të pija, që ta ndjeja veten burrë. Duke pirë, ose më mirë duke lëpirë atë liker, për disa mbasdite me rradhë kam dëgjuar tregimin e tij të rrallë mbi tre të mëdhenjtë e Rilindjes Italiane.

Për herë të parë ishte V.Tushi, ai që më foli për piktorët modernë, ndër të cilët pëlqente më shumë

Modilianin. Ai më bëri të shijoj portretet qafë gjatë e me sy bosh të atij piktori. Më foli për krizat nervore të atij piktori gjatë të cilave gërvishte muret me thonj, se nuk mund të shprehte në pikturë gjithë sa ndjente.

Pastaj, gjatë viteve të gjimnazit, çdo kohë pushimi e kaloja në bibliotekën e pasur të Korçës, ku pata mundësi të shihja mjaft nga vëllimet e Enciklopedisë Trecani. Me italishten time gjysmake të atëhershme, lexoja e më shumë shihja foto të veprave të pikturës, skulpturës e të arkitekturës të të gjithë kohrave e veçanërisht ato të Rilindjes Italiane, çelësin e së cilës ma kishte dhënë V.Tushi.

Në atë kohë pashë edhe pamjet më të shëmtuara që mund të shihen në një bibliotekë në kohë rrëmujash ideologjike të drejtuara nga injorantë. Atëherë pata mundësi të zbres në bodrumin e bibliotekës me pamjen e të cilit mund të skuqej nga turpi vetë Savonarola dhe nazistët më fanatikë që dogjën veprat e Hajnes e të Cvajgut.

Në mes të rrëmujës me kapica librash e revistash italisht, frengjisht, anglisht e gjermanisht, që prisnin ekzekutimin e dënimit me zjarr, ishin dhe dy buste prej mermeri të bardhë të Thoma Turtullit e të gruas së tij, që patën dhënë fondet për ndërtimin e kompletimin me libra të asaj biblioteke si dhe për ndërtimin e Spitalit civil e të Liceut në Korçë.

Nuk e di nëse ndonjë Savonarol shqiptar, me kasketë kaki në vend të kapuçit të zi, pati guxim të ketë dhënë urdhër për t'u thyer bustet e atij çifti fisnik, që dha aq shumë për rilindjen e Shqipërisë...

Nuk do ta harroj gjithashtu një arraba plehrash, që vinte për ditë te porta e atij bodrumi e ngarkohej me librat e revistat e grmbulluara aty. Sa gjëra me vlera të pakthyeshme ka marrë e ka zhdukur kushedi se ku ajo arraba plehrash!

Pata fatin të mësoja në Gjimnazin e Korçës që ngrihej mbi themelet e shëndoshë të ish Liceut Francez. Mjaft nga profesorët tanë kishin mbaruar atë lice si dhe Universitetin Francez por, në kushtet e "shkollës së re" shpesh e ndienin veten ngushtë. Në situatat tragji-komike që detyroheshin të përballonin profesorët tanë, ne

qeshnim, por dhe na vinte keq madje turp dhe një ndjenjë e turbullt revolte na e nxehte gjakun.

Nuk harrohet profesori Ligor Serafimi me elokuencën e tij të pa arritëshme që bënte akrobacira mahnitëse fjalësh për ta "lidhur me jetën" mësimin e biologjisë. Nuk harrohet i ndjeri profesor Kristaq Fundo. Në jetë ai nuk njihte tjetër gjë përveç se formulat e matematikës.

Pse nuk martohesh,- guxoi ta pyeste një miku i tij dhe ai u përgjegj: "Jam martuar me matematikën".

Mirëpo ishte koha, kur profesorëve u kërkohej të abonoheshin e të lexonin gazetën. dhe i ndjeri Kristaq Fundo e blinte gazetën "Zëri i popullit", e paloste për së gjati dhe e fuste në xhepin e xhaketës në mënyrë që t'i dukej sa më shumë dhe ta besonin se ai ishte i "lidhur me shtypin e partisë"

Nuk harrohet as profesori fjalëbutë i letërsisë shqipe, Zoti Besim Qorri që nuk shihej me sy të mirë. Një bashkënxënësi i ynë ishte sekretar i partisë i shkollës. Tepër rrallë e çonte në mësim atë profesor Besimi, por dhe atëherë ndodhnin të tilla skena:

- Na flisni ju lutem për krijimtarinë e Gëtes,- tha profesori.

- Gëthja, Gëthja, domethënë, kupton si të thuash... filloi bashkënxënësi ynë.

- Gëte, Gëte, - duhet me thanë, - mundohej t'ia mësonte me durim profesor Besimi e vazhdonte të thoshte mësimin që bënte sikur e thoshte bashkënxënësi ynë.

- Uluni ju lutem, - tha profesori. Nuk mund t'ju ve më shumë se katër. Nga shumë shokë dhe shoqe dëgjohej një "O" habitore e zgjatur. - "Ç'asht e vërteta, mir' e paraqiti",- përsëriste i shkreti profesor duke u munduar të na bindte ne dhe veten se kishte vënë notë të merituar.

Nuk harrohet edhe një marrëzi tjetër e asaj kohe:

Jemi në Nëntor të vitit 1951. Pasdite vonë na lajmëruan të mblidheshim në shkollë. Aty nga ora tetë e mbrëmjes na thanë se do të shkonim më këmbë në Maliq sepse do të dilte sheqeri i parë nga fabrika e ndërtuar "me ndihmën e madhe bujare të Bashkimit Sovjetik".

U nisëm një vargan me nja njëqind nxënës të klasave të katërta. Rruga Korçë-Maliq, e gjatë nja 15 km., ishte mbuluar me më shumë se një pëllëmbë dëborë dhe të priste thëllimi që vinte nga gryka e Cangonjit. Në këtë rrugë të mundimeve, ku duhej të këndonim dhe këngë revolucionare, na shoqëronin dhe disa profesorë. Ndonjëri prej tyre kishte mbase tre fishin e moshës sonë...

Kur arritëm ne, sheqeri "i parë" kishte dalë. Disa nga bashkënxënësit tanë më aktivë e më afër partisë, hynë brënda, mbushën grushtat me atë sheqer me një ngjyrë të verdhë të vrarë dhe e hanin si viçat tagjinë duke futur turinjtë në të, për të treguar entuzjazmin e madh që i kishte pushtuar. U kthyem po atë natë duke ecur më këmbë përsëri 15 km. përmes dëborës së ngrirë.

Në gjimnaz nuk zura shoqëri me ata bashkënxënës që ishin bërë anëtarë të partisë komuniste e as me disa, që u rrinin nga pas. Dy shokë e nja dy shoqe, me të cilët rrija gjithmonë, ishin nga familje të hershme intelektuale korçare e që nuk futeshin në vorbullën euforike të kohës.

Të gjithë ishim tipa që gjenim kënaqësi në leximin e librave. Në shtëpinë time kisha libra shkollore të motrave më të mëdha e libra të tjerë të vjetër, që më ndihmuan shumë të kuptoja më mirë kohën.

Qysh në vitin e parë të gjimnazit kisha lexuar disa herë librin e leximit të Kostë Çekrezit. Lexoja me ëndje "I pari mish i pjekur" e aty, për herë të parë, njoha Maksim Gorkin me tregimin "Pushteti i nënës".

Kisha lexuar edhe librin me historinë e Shqipërisë të Kostë Çekrezit, ku kisha mësuar disa të vërteta mbi Haxhi Qamilin, që Hoxhë historiani i ndryshoi si ia donte qejfi.

Në atë kohë lexova dhe librin e Lefter Dilos, "Ligjëron Fan Noli", ku kisha mësuar gati përmendësh fjalimet e tij, veçanërisht atë që kishte mbajtur në Korçë, ku me fjalët e Linkolnit kishte thënë: "Na duhet një qeveri e popullit, prej popullit, për popullin".

Në atë libër mësova për ndihmën që kishte dhënë Presidenti Willson për shpëtimin e Shqipërisë. Ai i tha Nolit: Një zë do të kem në Lidhjen e Kombeve dhe atë do ta përdor për Shqipërinë. Mirëpo propaganda

komuniste thonte vetëm sharje për të.

Në vitet e para të pasluftës pata rastin të më binte në dorë një libër i vogël me titull "Amerika", me sa duket i sjellë nga misionet amerikane që erdhën atëherë. Ai libër flet për pikat kulmore të historisë së SHBA e të personaliteteve të saj, për jetën shoqërore amerikane, për ndihmën që i dhanë SHBA gjatë luftës B.Sovjetik, për planin Marshall etj. Kisha mësuar, pra, disa të vërteta, që më vonë u thanë e u propaganduan krejt ndryshe.

Ky libër mbeti i fshehur në shtëpinë time për më se 40 vjet dhe sot besoj se është kopja e vetme në Shqipëri (Fotokopjen e Kopertinës së tij po e vendos në vazhdim). Tek ai libër, nga fjalimi i Presidentin Roosvelt lexoja:

"Liria personale e vërtetë nuk mund të egzistojë pa pasur një sigurim pavarësie ekonomike. Njerëzit, që janë të varfër, nuk janë njerëz të lirë. Diktaturat lindin, përgjithësisht, në vende ku njerëzit vuajnë nga uria".

Në një shkrim të Presidentit të Universitetit Harvard, thuhej:

"Një student i rritur me një regjim shpirtëror dhe intelektual të pamjaftueshëm, bëhet vegël dhe viktimë e një botëkuptimi totalitar".

Në një shkrim tjetër mbi mënyrën e qeverisjes në SHBA e mbi personalitetet e fuqishme që krijuan atë mënyrë qeverisje thuhej:

"Asnjëri nuk mendonte se e vetmja mënyrë qeverimi ishte të vriste ose të burgoste ata që kishin mendime të ndryshme".

Vetëkuptohet se asimilimi i plotë i këtyre mendimeve as që mund të mendohej në atë moshë rinore e në ato vite të turbullt të gjimnazit, kur disa bashkënxënës këndonin gjithë pathos këngë ruse e kur disa të tjerë përfundonin në burg por, leximi i tyre gjithsesi më vinte në mendime. Gjithashtu, qysh herët kisha lexuar gjithë ç'kishin botuar në shqip Mitrushi e Lasgushi. Njihja diçka Fishtën dhe kur në historinë e letërsisë shqiptare që bënim në vitin e tretë apo të katërt, Mitrushi e Fishta quheshin shkrimtarë fashistë, më vinte të plasja.

Kisha lexuar pak gjëra nga F.Konica dhe dija vlerësimin që bënte Noli për të: "Korrim grurin që ka mbjellë Faiku..." dhe heshtja rreth tij e rriste atë më shumë


Amerika
HOTAM I VEGANTË PËR BALKANIN

në syt' e mi.

Kur isha në Fakultet, nëpër miq e shokë, mundohesha të gjeja ndonjë libër arkitekture perëndimore. Më ra në dorë një libër italisht me fotografi e planimetri vilash të ndërtuara nëpër Evropë aty nga vitet '30-40, me autor Bruno Moretti.

Kur i shihja unë, ato vila ishin bërë demode, por për ne atëherë ishin supermoderne, në krahasim me ç'ka shihnim në revistat sovjetike.

Në praktikën e vitit të katërt, që e bëra në ndërtimin e Teatrit të Shkodrës, u njoha me disa të rinj atje dhe dorë pas dore më sollën disa numra të revistës italiane të paraluftës, "DOMUS". Ndonëse kishte më shumë interiere, kishte dhe ndonjë pamje apo shkrim. Kishte gjëra me vlerë se drejtohej nga arkitekti i njohur Gio Ponti.

Pastaj, në Tiranë, më ra në dorë një libër tjetër me pamje nga sallat e kinemave e të koncerteve të ndërtuara nëpër botë. Atje p.sh. pashë sallën Pleyel të ndërtuar në Paris e që më pëlqeu së tepërmi. Pashë sallën Koncert Hall të New Yorkut dhe u çudita që kishte tre ballkone një mbi një e kapacitet 6200 vende. Pashë dhe kinema të vogla, komode, zgjidhje të sforcuara etj. po kryesorja ishte se po vendoseshin piketa krahasimi.

* * *

Ja, me këto kontraste kalejdoskopike formimi kulturor, botëkuptimor e profesional, ulesha në tavolinën e vizatimit për të bërë projektin e diplomës. Siç thashë, konsulent pata arkitektin Gani Strazimiri.

Qysh në fillim, ai më dha një skemë planimetrike tipike si të kinoklubeve sovjetike, që ndërtoheshin nëpër kolkhoze, me frontone e me kollona.

Nuk punova sipas asaj skeme, por bëra diçka nga mendja të derivuar nga ato pak gjëra që kisha parë në librin me kinema e teatro perëndimore. Në konsultën e

dytë e të tretë mendimet na u ndanë përfundimisht dhe ai tha: "Me këtë lloj arkitekture, që do të punosh ti, unë nuk di të të konsultoj. Bëje vetë. Unë marr përsipër të t'i firmos fletët". U ndamë ftohtë. Ai s'humbiste asgjë. Unë rrezikoja gjithçka. Megjithatë, me kryeneçësinë e të riut munda të bëja diçka, që nuk ishte për t'u përqeshur. Komisioni Shtetëror i vlerësimit të Projekt-Diplomave me kryetar inxh.Kiço Gliozheni e ku merrnin pjesë inxhinierë të shquar të asaj kohe, si Gjovalin Gjadri, Farudin Nuri etj. dha vlerësimin maksimal, notën 5.

KREU I TRETE

Kështu, pra, mbarova Institutin Politeknik të Tiranës dhe tashmë isha inxhinier por, ndërsa ngjitja për herë të parë shkallët e Ministrisë së Ndërtimit për të marrë urdhrin e emërimit, nuk i dija ato shkresa që kishin shoqëruar emrin tim, të cilat munda t'i gjeja tani, pas dyzet vjetësh. Në njërën prej tyre, dërguar nga Drejtoria dhe organizata e partisë e Institutit Politeknik nga fundi thuhej:

- Mund të japë më shumë në Ndërmarrjen Projekti si arkitekt.

Veçse, pak më lart, në të njëjtën shkresë thuheshin edhe këto:

- Reforma agrare i ka marrë 20-30 dynym tokë.

- Nuk ka marrë pjesë në ndonjë aksion të rinisë.

- Eshtë anëtar i Bashkimit të Rinisë pa ndonjë detyrë organizative.

- Eshtë student me karakter të fortë, aqë sa disa herë kalon në gjaknxehtësi.

Duke mos i ditur këto, dilja nga zyra e kuadrit dhe lexoja e rilexoja atë letër të emërimit tim, ku shkruhej:

"Emëroheni inxhinier në Ndërmarrjen e Ndërtimeve, Gjirokastër".

I hutuar e kokulur po zbrisja shkallët e nuk vura re se përballë kish ndaluar konsulenti i diplomës sime,

i.Eshte student me karakter te forte, aqe sa disa here kalon ne gjaknxehtesi.

Projekti i dipilomes konsiston ne projektin e nje theatri. Nen do jme se shoku Petraq Kolevica do, te jape me shume ne Ndermarjen e Projektit, si Arqitekt.

Tirane, me 8/V/1957.

SEKRETAR I ORG.BAWE	DEKAN I FAK.NDERTIMIT	DREJTORI:
(Kiço Negovani)	(Kiço Nzgovani)	(Ing.Zija Kelliçi)

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPERISE M. INDUSTRIE E MINERAVE INSTITUTI POLITEKNIK TIRANE

arkitekti Gani Strazimiri.

- Ç'paske ardhur këtu?-më pyeti.
- Mora emërimin.
- Ku të kanë caktuar?
- Ja!-i thashë dhe zgjata letrën që posa kisha marrë.

E lexoi, ngriti sytë, më pa i menduar dhe tha: "Do të flas vetë me Ministrin".

Nuk m'u dha t'i thosha faleminderit, madje më erdhi turp që po interesohej, por s'munda ta kundërshtoja.

S'di se ç'bisedoi i ndjeri Gani dhe s'di nëse ishte vetëm fjala e tij që zuri vend, por pas disa ditësh më lajmëruan që emërohesha në Ndërmarrjen Projekti.

KREU I KATERT

Më 16 Korrik 1957 fillova punën në Ndërmarrjen Shtetërore Projekti, që atëherë ishte në ndërtesën e Ministrisë së Ndërtimit.

Kur hyra në ato zyra, më dukej se po hyja në një koshere bletësh punëtore, ku të gjitha bënin mjaltë, ndërsa veten time e dija që s'ishte veçse një grenxë hollake, e re, e panjohur, që s'bënte dot as pite dylli.

Fillimi i punës atje, ishte një rast fatlum jo vetëm për profesionin. Për fatin tim të mirë atje gjeta plot njerëz bujarë, të dashur, të aftë, të afruar. Këta ishin teknikë të vjetër e të rinj. Ata më afruan të parët e me ta lidha miqësi të mirë. Atje njoha të ndjerin **Shahin Delvina**, disenjatorin e përsosur, shkrimet elegante të të cilit edhe sot mund t'ia ketë zili kompjuteri më i sofistikuar. Njoha të ndjerin **Zija Fterra**, njeri zemërgjerë e njeri praktik i paarritshëm. Ai më dha librin e Hendrik Van Loon "Historia e qytetërimit" (italisht) si dhe librin tjetër të tij mbi historinë e lundrimeve, i cili megjithëqë nuk më interesoi shumë, më mësoi mjaft gjëra, por kryesorja ishte se ato libra u bënë shkak bisedimesh më të gjera e për shkëmbime mendimesh, ku gjenim gjëra të përafërta. Më vonë rasti e solli të bënim

së bashku një shërbim disa ditor nga Tirana në Laç-Lezhë-Milot-Shkodër. Në ato net të gjata hotelesh me lagështi e pa ujë, Zijai më foli për gënjeshtrat e kohës. Jo,-më tha,-Partinë nuk e ka bërë Enver Hoxha. Ndër ato që thotë ai e që thuhen për të, ka plot gënjeshtra. Ajo që s'thuhet është vrasja e Qemal Stafës...Për këtë nuk më tha ndonjë gjë konkrete. Vuri vetëm një pikëpyetje që as sot nuk i është përgjigjur njeri.

Foli gjatë në ato net, fliste në gjysëm errësirë e me zë të ulët, por ato fjalë më hidhnin një dritë të fortë në errësirën e kohës. Më vonë dëgjova sikur Zijai qysh herët paskësh qenë pranë grupeve komuniste, por s'dihet se pse pastaj e patën larguar.

Njoha të ndjerin **inxh.Vasil Noçka** apo më mirë të them e pashë dhe dëgjova për të, sepse ai kishte më shumë se dyfishin e moshës sime dhe ne, inxhinierët e rinj, e shihnim me respekt të veçantë e me drojtje. Kishte studiuar në Gjermani, por në Ndërmarrjen Projekti kishte ardhur mbasi bëri universitetin e rëndë të burgut komunist dhe ishte pikërisht ky burg shkaku që ai i ngjiste shkallët ngadalë e duke u mbajtur fort pas parmakut dhe me siguri ishte pasojë e burgut, vdekja e tij nga një atak në zemër.

Atje njoha të ndjerin **inxh.Lutfi Strazimiri**. Dhe ai kishte studjuar në Gjermani, por mbi të gjitha kishte trashëguar intuitën ndërtuese të dibranëve. Pata fatin ta kisha tryezën e punës puq me të tijën dhe pata favorin e miqësisë së tij të çiltër. E patën futur në burg, por s'dinte se përse e patën futur. Dyzet e tetë orë, - më thoshte një ditë, - më kanë lënë të varur me duar të lidhura prapa kurrizit. Kur më zgjidhën, doja të shtrihesha për tokë, ku kisha një si dyshek e një si jastëk, por njëri nga ata kriminelët e burgut shkoi i ndyvi këpucët në nevojtore dhe erdhi i fshiu përmbi jastëkun tim. Shumë shpejt Lutfiu më dhuroi nja dhjetë numra të revistës italiane të paraluftës "Casabella". Merri ti-më tha,-se mund të të hynë në punë. Dhe me të vërtetë, atje gjeta plot gjëra me vlerë.

Njoha **Ibrahim Prushin**, inxhinierin ndoshta më punëtor e më modest në Ndërmarrjen Projekti. Kishte bërë shkollën teknike të H.Fulcit e pastaj Akademinë Ushtarake të Torinos, si oficer i xhenjos, por në Ndërmarrjen Projekti e më vonë në ISP bëri një nga punët më të vlefshme në

studimin e banesave. Seksionet e banesave që nga viti 1958 e deri në vitin 1980 janë frut i punës së tij këmbëngulëse prej së cilës përfitova mjaft.

Meqë punuam në një dhomë, u miqësuam shpejt dhe për këtë ndihmuan këngët e vjetra italiane që shpesh i këndonim së bashku duke vizatuar projektet.

Njoha të ndjerin **inxh.Çefo Fico**. Kishte studiuar në Itali dhe më fliste me admirim për revistën "l'Ingeniere" të cilën nuk e shihte më se s'lejohej të vinte.

Aty nga viti '65 erdhi në bibliotekë një numër i ri i asaj reviste. I gëzuar e rrëmbeva dhe shkova t'ia tregoja të ndjerit Çefo. Për habinë time e pa, e pa i dëshpëruar, nuk e mori ta shfletonte, por e shtyu me kurrizin e dorës e më tha: "Falemnderit. Ka më se njëzet vjet që nuk e kam lexuar këtë revistë. Nuk e hap, se s'dua të tmerrohem kur të shoh se sa prapa kam mbetur".

Tek zyra e ixh.Çefos qëllonte të vinte ngandonjëherë edhe një rus që punonte në bibliotekën e Ministrisë e që e quanin me përbuzje "rus i bardhë". Thoshin se ishte me prejardhje nga familja e Carit. Kjo duhet të ishte e vërtetë po të shihje sjelljen e tij me fisnikëri të natyrshme. I shkreti **Kozllovski**, përveç rusishtes dinte mirë gjermanisht, frengjisht e italisht. Ngandonjëherë e pyesja për ndonjë fjalë të vjetër ruse dhe më jepte shpjegim pa përtesë e ndoshta sot jam unë i vetmi në botë, që po e kujtoj. Nga fillimi i viteve '60 atë e internuan diku nga Lezha bashkë me të motrën dhe vetëm një Zot mund ta dijë se ku u prehen kockat.

Atje njoha të ndjerin **inxh. Haxhi Dauti**, inxhinierin konstruktor të talentuar, por dhe me një dell të fortë letrari me të cilin pata afrim shoqëror më shumë se me këdo tjetër. Kishte studiuar disa vjet në Itali. Pëlqente shumë Ada Negrin, urrente Papinin, i cili pati shkruar kundër shqiptarëve në kohën e fashizmit. Haxhiu, qysh i ri pati përkthyer për qejf të vet "Kira Kiralina" të Panait Istratit. Dorëshkrimi mbase ndodhet ende diku në shtëpi të tij.

Nuk i duronte dot marrëzitë e ligësitë e diktaturës dhe ishte nga të paktit, që e shihnin qartë humnerën, ku po e çonte Shqipërinë diktatura komuniste. S'kam për ta harruar kurrë këtë ndodhi:

Ishte koha kur I.Kadare pati shkruar poemën e

bujshme "Përse mendohen këta male". Një ditë e pashë Haxhiun që rrinte vetëm i menduar e i trishtuar. Për ta sjellë disi në humor e ngacmova duke i thënë me të qeshur: "Përse mendohen këto male?" Dhe Haxhiu në çast mu përgjigj: *"Se s'po mendohen këta hale!"*

Me këtë rast më kujtohet dhe diçka tjetër, që s'duhet lënë pa u treguar.

Ishte ndoshta vera e vitit 1965. Bashkë me Haxhiun kishim shoqëri të mirë me të ndjerin **ark.Pandi Borova**, me të cilin flisnim pa drojtje. Një ditë Haxhiut seç i shkrepi: kësaj të shtune të vidhemi nga puna e ta kalojmë paraditën në plazhin e Durrësit. Nuk e zgjatëm. Ia hipëm trenit e pas ndonjë ore mbërritëm në plazh. Bëmë si bëmë, gjetëm një nga ato kabinat ditore ku u zhveshëm. U lamë sa u lamë në det, ndejtëm sa ndejtëm në diell mbi rërën e nxehtë, na mori uria. U çuam, u veshëm e shkuam mos gjenim ndonjë gjë nga ato që shiteshin atëhrë: peshk të stërkripur të fërguar, të ashtuquajturat qofte apo thjesht ndonjë gjysmë panine të ftohtë me djathë. Nuk gjetëm asgjë. E po të shohim të paktën se mos pimë nga një gotë birrë. Asgjëkundi nuk gjetëm! Dhe Haxhiu, që nuk i shpëtonte gjë, tha: "E dini si na ka gjetur ne? Si ajo fjala e mençur që thotë populli: **"Rron bleta në majë të malit, rron dhe miza në bythë të kalit"**. Në këtë Shqipërinë socialiste ne na ka rënë në hise fati i mizës. Ejani të ikim, sa s'kemi ngordhur për të ngrënë! Ja, edhe ne e bëmë **uikendin** si gjetkë e gjetkë. Pika, që s'na bie - vazhdonte të fliste Haxhiu, ndërsa nxitonim të kapnim trenin për t'u kthyer...".

Haxhiu në ato pak vite që punoi, ishte në rradhët e para të inxhinierëve që mundoheshin të futnin koncepte moderne të konstruksionit. Pati një dështim në ndërtimin e sallës së operacioneve të spitalit onkologjik në Tiranë dhe për të u bë një gjyq i turpshëm që nuk nderoi as drejtuesit , as disa kolegë të cilët në vend të dashamirësisë treguan cmirën. Haxhiun e dënuan duke e dërguar në zbatimin e ndërtimeve, kur dihej se vuante nga një sëmundje e pashërueshme e veshkave. Në këtë punë të re, Haxhiut i duhej të ecte përditë kilometra të tëra më këmbë, ndërsa vazhdimisht urinonte gjak.

Shumë shpejt erdhi vdekja që e rëndoi edhe më

tepër njollën e turpit mbi disa njerëz. Në varrimin e tij nuk erdhi askush nga udhëheqja e Ministrisë apo Institucionit. Nuk u mbajt fjalim zyrtar mbi varrin e tij.

Në mes të asaj atmosfere të rëndë që u krijua, u afrova e fola këto fjalë lamtumire si shok e koleg:

"Sot, kur po të përcjellim, vëlla, përgjithmonë, kujtojmë me nderim jetën tënde të shqetësuar, të përshkuar nga një vullnet e dashuri për punën që arrinte deri në vetmohim. Në mes të kësaj gjëme, në mes të këtij pikëllimi për humbjen tënde, o shoku i ynë i vyer, kemi ngushëllimin se në mes nesh do të mbetet e paharruar dhe frymëzuese figura yte fisnike e profesionistit idealist. S'u lodhe kurrë Haxhi! I mbajte librat hapur. E mbylle dritën pas mesnate dhe nga sytë e tu nuk t'u shua kurrë pasioni për punën që ishte kuptimi i jetës tënde, se gurin, që do të vendosje në veprën e madhe të ndërtimit të Atdheut, doje t'a gdhëndje mirë duke mbetur gjithmonë kërkues e predikues entuzjast e i guximshëm i së resë.

Po ndahemi, Haxhi, por ne, shokët e kolegët e tu, nuk harrojmë shoqërinë tënde rreptësisht të sinqertë. Të gjithëve na pate dhënë ndihmë të pakursyer, këshillë të matur, mendim të çmuar, prandaj e ndjejmë kaq shumë këtë bosh të madh që na le sot..."

Në këtë kohë, në Ministri u bë një i ashtuquajtur gjyq, apo demaskim përpara kolektivit të një teknikuu topograf kolonjar, që siç thonin, gjatë luftës pati qenë me Ballin. Atë e akuzonte një kolegu i tij gagaç, sikur gjoja e kishte dëgjuar të këndonte himnin e Jugosllavisë. "Po dale, bre-thoshte ai tekniku i gjorë,-unë kolonjar jam, por s'di të këndoj. S'kam kënduar kurrë"!. Mirëpo oficerët e sigurimit i vunë prangat në sytë e të gjithëve dhe e morën.

Më vonë u njoha me **inxh.Naim Shashain**. Ishte nga një familje e njohur elbasanase. Kishte studiuar në Torino dhe pas lufte mbeti atje, por vëllai i tij që kishte studiuar në Austri, po bënte vite të rëndë burgu dhe Naimi, për të ndihmuar nënën, u kthye në Shqipëri dhe mbeti brenda çarkut komunist. E dërguan lart e poshtë nëpër punëra të rënda, derisa u ra ndërmend ta futnin në projektim.

Me të dhënat e atyre që më njihnin, apo që kishin filluar të më njihnin, e mposhti ndrojtjen e një mbrëmje më tha: "Eja të ngjitemi bashkë nga shtëpia, se do të të jap një libër". Në errësirën e asaj mbrëmje më dha librin "Storia dell'architettura moderna" të Bruno Zevit, ku pashë panoramën e plotë të asaj historie të përshkruar me aftësi e dashuri nga një dorë mjeshtri.

U njoha e bashkëpunova dhe me inxhinierë e teknikë të tjerë si këta, që kishin siç thuhej atëhere, ndonjë "infiltrat" apo' kavernë" në biografi, të cilët punonin e duronin me stoicizëm të pashoq brutalitete, fyerje, përçmime e kërcënime, të drejtuesve shtetërorë e partiakë.

Përreth meje kishte dhe arkitektë të tjerë, ku më i riu ishte të paktën pesë vjet më i madh se unë e që kishin studiuar në Bullgari, Rumani, Çekosllovaki, por në kohën kur edhe në këto vende sundonte stili i arkitekturës sovjetike. Ishin edhe dy arkitektë më të vjetër, të dy të shkollës austriake, **Skënder Luarasi** dhe **Anton Lufi**.

Me të ndjerin arkitekt Skënder Luarasi, pata rastin të bashkëpunoj qysh në fillim. Nuk kisha as një javë që fillova punën, kur ai më mori në zyrën e vet, se kishte dëgjuar që vizatoja mirë. Më dha një revistë gjermanisht të paraluftës ku ishte projekti në shkallë të vogël i një fabrike duhani. Këtë,-më tha-do ta përpunosh në shkallë të madhe, t'i bësh dhe një fasadë të bukur, me ngjyra si pas këtij modeli. Kije parasysh,-tha ai-se përpunimi për arkitektin ka shumë rëndësi. Për fatin tim të mirë, këtë fjalë e vura në vesh dhe më vlejti në gjithë karrierën profesionale. Pata dhe rast tjetër bashkëpunimi me të për projektin e Sanatoriumit të Tiranës.

Në atë kohë s'mund të jepja ndonjë kontribut në zgjidhjen planimetrike funksionale apo arkitektonike të atij objekti ku Skënder Luarasi kishte pranuar për oportunitet si bashkëautor Eqrem Dobin. Unë ndihmova vullnetarisht në bërjen e maketit të objektit, që ndihmoi në ndonjë përmirësim vëllimor të mëtejshëm. Kryesorja ishte, se objekti u bë i konceptueshëm lehtas nga të gjithë që interesoheshin për të. Foto e maketit u botua në revistën "Ylli". Ky ishte maketi i parë që bëhej për objektet e projektuara në Institut. Këtë e vazhdova dhe për objektet

e tjera, që projektova më vonë si p.sh. Posta e Tiranës, banesa te fusha e tenisit, banesa 7-katëshe në Korçë, banesa për diplomatët e huaj në Tiranë, Hoteli i madh i Tiranës etj. Kjo punë ishte një hamallëk i madh, se e bëja gjithçka vetë, por asnjëherë nuk u pendova, se më jepte siguri dhe lehtësi në miratimin nga të tjerët. Shembulli im nuk u ndoq asnjëherë nga asnjë arkitekt tjetër në Institut apo në Zyrën e Tiranës. Maketet më vonë bëheshin nga teknikë të specializuar.

Skënder Luarasi i përkiste asaj shtrese të intelektualëve që pushteti i ri nuk i donte, por i shfrytëzonte. Pati punuar në ndërtimin e Kombinatit të Tekstileve në Tiranë, të godinës së Komitetit Qëndror, veçanërisht në zbatimin e rifiniturave etj. Kur punova me të, ai kishte ndoshta diçka më pak se dyfishi i moshës sime. Ishte punëtor, pa shok. Kishte familje, që donte ta mbante mirë. Kishte fëmijë, që donte t'i rriste, prandaj punonte edhe në shtëpi, jashtë orarit, që të tejkalonte normën e të merrte ca lekë më shumë. Brengën e vet mbase e mbyste me ato të shkreta cigare, që i ndizte njërën pas tjetrës. Nuk bëri me mua asnjë bisedë tjetër përveç atyre të punës që kishim përpara. Fjalët i kishte shumë të pakta. Sigurisht ishte rezervimi, që i impononte koha.

Për muzikën e në veçanti për operat folëm pak, kur erdhi e këndoi në Tiranë Tito Skipa, ndërsa gjatë një udhëtimi për në Vlorë më çuditi, kur më përmendi emrin e Baudelairit dhe "Les fleurs du mal". Megjithatë profili i personalitetit të tij ishte i thjeshtë: Punë. Siç qe ashtu jo fort i gjatë, me trup të ngjeshur e motor i palodhur në punë, inxh.Gjadri e quante me dashamirësi "Tady Bar", ndërsa drejtori nuk mungonte ta thërriste si me përtallje me zërin e tij të ngjirur enkas "Harush!".

Me arkitektin **Anton Lufi**, u njoha në zyrën e S.Luarasit, ku ai vinte shpesh dhe nuk di përse diskutonin fort gjermanisht, sa më dukej sikur grindeshin dhe unë dilja jashtë. Në atë kohë ylli i krijimtarisë të Lufit kishte perënduar.

Kishte mbaruar ndërtesa e Komitetit Qëndror në Tiranë dhe ajo e Teatrit të Shkodrës, të projektuara prej tij, për të cilat u lëvdua e mori çmime, por ajo lloj

arkitekture nuk mund të vazhdonte dot më. U mor disi me projektim banesash, por pa ndonjë rezultat të shquar. Biseda me të ishte e këndshme, kishte interes për historinë e arkitekturës e çështje të veçanta të saj. Ishte këmbëngulës në mendimet e veta dhe jo fort i pëlqyeshëm nga drejtuesit. Dalëngadalë kaloi në Drejtorinë teknike ose më mirë të themi e çuan atje dhe A.Lufi, dëgjohej të fliste vetëm nëpër Këshillat Teknike, ku nuk e dëgjonin.

Aty njoha dhe një vajzë, që punonte si teknike, e quajtur Edith Logoreci, që më deshi e bashkoi jetën e saj të qetë me jetën time të trazuar, prej së cilës pati pak gëzime e shumë shqetësime e hidhërime.

Atë vajzë punëtore shëmbullore, e ndiqte nga pas në biografi, një vulë e keqe për atë kohë, vulë që zyra e kuadrit s'mungoi ta vendoste në krye të nja dhjetë karakteristikave të mia, duke shkruar: **"Eshtë martuar me Edita Logorecin, e cila e ka nënën me origjinë gjermane".**

Kur fillova punën në Ndërmarrjen Projekti, kryeinxhinier ishte Koço Miho, arkitekt i formuar në shkollën sovjetike, anëtar partie. Deri atëherë kishte projektuar e ndërtuar pa ndonjë sukses ndërtesën e Fakultetit Gjuhë-Letërsi dhe kinemanë "Partizani" në Tiranë, por ishte i mençur dhe e kishte kuptuar, që duhej ndërruar rruga.

Atëhere, mua më dhanë të projektoja një kopësht fëmijësh për në Vlorë dhe Koço Miho më tha të kisha parasysh si model një foto të një objekti të tillë, nëse s'gaboj, të ndërtuar në Kaliforni. Mua më dukej çudi që ma thoshte ai këtë e më bënte të mendoja, se kishte ardhur koha për të dalë nga kornizat e arkitekturës sovjetike të imponuar deri atëhere.

Pothuajse njëkohësisht Koço Miho këmbëngulte te projekti i një banese që bënte ark.Aleko Rafaeli në bulevardin e Tiranës (përkundrejt Hotel Arbërisë) që të vinte formën karakteristike të ballkoneve të një ndërtese suedeze (nëse nuk gabohem të ark.Sven Markelius).

Të gjitha këto ishin shenja, se po perëndonte një periudhë dhjetëvjeçare projektimi të gabuar. Shumë shpejt pas kësaj, Koço Miho shkoi në Komitetin Ekzekutiv, si Kryearkitekt i Tiranës.

Reforma

i ka marë 30-30 dynym tokë; kurse djali xhaxhait ka qënë dënuar dhe burgosur për politikë.

Është martuar me Edita Logorecin inxhenjere prënë këtij Dikasteri, e cila e ka nënën e saj me x orgjinë Gjermane.

Puna e tij si në ish ndërmarrjen projekti dhe sot në Ministri çmohet e mirë.

Tiranë, më 23/3/1964

KRYETARI DEGËS KUADRIT :

(Kamil Gavoçi)

.Reforma i ka marë 20-30 dynym toke,kurse djali xhaxhait ka qenë dënuar dhe burgosur për politikë.

Është martuar me Edita Logorecin inxhinjere pranë Ministrit Ndërtimit,e cila e ka nënën e saj me origjinë Gjermane.

Puna e tij kudo që ka punuar është çmuar e mirë.

SEKRETARE ORGANIZATËS BAZË
(Qibrije Çiu)

PËR KOMIT.EKZEK.K.P.RRETHIT
ZV/K R Y E T A R I
(Sabri Pilkati)

25/VI/1968.-

.Reforma i ka marë 20-30 dynym toke,kurse djali xhaxhait ka qenë dënuar dhe burgosur për politikë.

Është martuar me Edita Logorecin inxhinjere pranë Ministrise Ndërtimit,e cila e ka nënën e saj me origjinë Gjermane.

Puna e tij kudo që ka punuar është çmuar e mirë.

SEKRETARI ORGANIZATËS BAZË
(Adem Kola)

PËR KOMITETIN EKZEKUTIV K.P.RRETHIT
ZV/K R Y E T A R I:
(Vangjel Mëhilli)

Reforma i ka marë 20-30 dynym toke,kurse djali xhaxhait ka qenë dënuar dhe burgosur për politikë.

Është martuar me Edita Logorecin inxhinjere pranë Ministrise Ndërtimit,e cila e ka nënën e saj me origjinë Gjermane.

Puna e tij kudo që ka punuar është çmuar e mirë.-

PËR KOMITETIN EKZEKUTIV K.P.RRETHIT
ZV/K R Y E T A R I:
(Abdyl Supi)

12/7/1978.-

KREU I PESTE

Pasi kisha njohur deri diku nivelin profesional të kolegëve në atë qendër pune, pasi kisha bërë provat e para të thjeshta projektuese e me ambicjen për të qenë në rreshtin e parë, e ndjeva se më duhej të plotësoja boshllëqet e mëdha që më kishte lënë shkolla në fushën e arkitekturës në përgjithësi e në veçanti të arkitekturës moderne. Për të arritur këtë, i vetmi mjet i mundshëm ishte libri dhe e vetmja rrugë ajo e autodidaktit.

Në bibliotekën e Ministrisë atëherë gjeta librin "Das Grundriswerk" (Planimetria e katit përdhe) libër tepër i vlefshëm teknikisht, veçanërisht për mua, sepse kishte shumë planimetri seksionesh banimi të ndërtuar në Evropë para luftës. Gjermanisht atëherë nuk dija, por më mjaftonin vizatimet.

Atje gjeta gjithashtu librin e dy arkitektëve të hershëm modernë gjermanë, vëllezërve Max e Bruno Taut, "Moderne Baukunst" (Arti i ndërtimit modern), ku pashë fotot e ndërtimeve të para moderne në Gjermani e në Evropë. Për fat të mirë, më ra në dorë libri "L'architecture du XX siecle" (arkitektura e shek.XX), ku gjeta personalitetet përfaqësuese të arkitekturës moderne, historinë dhe problemet e saj.

Në Bibliotekën e Universitetit dhe në Bibliotekën Kombëtare munda të gjej gjithashtu libra të vlefshëm mbi historinë e arkitekturës moderne të cilat nuk ishin të ndaluara si p.sh. "Storia dell'architettura moderna" e Leonardo Benevolo etj., ndërsa në Bibliotekën e Institutit të Arteve ishin dy libra të vlefshëm "L'art e l'architecture" dhe "L'art e l'homme". Kuadri u plotësua kur më ra në dorë libri "Tempo, spazio e architettura" e Sigfried Giedion. Ndërsa një dritare e madhe për të parë e kuptuar

problemet sociale të arkitetkurës m'u hap, kur mora me huazim nga Biblioteka e Romës librat "La citta nella storia" dhe "Storia della citta" të Lewis Mumford. E kështu me radhë, ngadalë e duke kërcitur, u hapën dyert e dritaret prej nga shihja e njihja arkitekturën moderne dhe personalitetet e saj më në zë.

Nuk dua t'i lëvdohem askujt me listën e librave që pata lexuar. Dua të tregoj vetëm se si nisi formimi apo vetëformimi im si arkitekt.

Ky formim e vetëformim gjatë gjithë jetës sime, eci në dy rrugë paralele:

Në atë **teorike**, që kishte vështirësitë e gjetjes së librave dhe në atë **praktike**, që kishte peshën e objekteve, të cilët më ngarkoheshin t'i projektoja. Vështirësitë që dilnin në këtërrugë ishin sa qesharake aq dhe të rënda e shpesh të pakapërcyeshme.

Duke dhënë më poshtë përshkrimin e situatave nëpër të cilat kam kaluar gjatë projektimit të objekteve të ndryshëm, shpresoj që lexuesi të arrijë të krijojë një përfytyrim të vagullt të vështirësive të kësaj rruge të dytë.

HOTELI I TURIZMIT NE SARANDE

Duhet të ketë qenë fundi i vitit 1957, kur së bashku me arkitektin Kostaq Sahatçiu, që ishte nja 6 a 7 vjet më i madh se unë e që kishte studiuar në Rumani, na ngarkuan të bënim projektin e një farë hoteli për turizmin në Sarandë.

Kostaqi ishte njeri i afrueshëm, e njihja qysh kur bëra praktikën mësimore në ndërtimin e Teatrit të Shkodrës, ku Kostaqi drejtonte punimet. Nga fundi i dhjetorit, shkuam në Sarandë për të parë vendin e ndërtimit. Më ka mbetur i paharruar udhëtimi gjatë bregdetit, Llogaraja, Himara, Saranda, ku vija për herë

të parë. Në majë të Llogarasë na zuri dëbora, ndërsa në breg të detit kishin çelur bajamat. E pamë vendin e ndërtimit të caktuar diku në bregun shkëmbor dhe u kthyem të nesërmen.

Deri nga fundi i prillit 1958 kishim mbaruar projektidenë dhe prisnim të bëhej mbledhja e Këshillit Teknik kur, papritmas na thanë: ngjituni shpejt në Bibliotekë! U ngjitëm... Në krye të tryezës së madhe ishte Ministri, J.Pashko, pastaj zv.Ministri Sh.Dragoti, Ministri i Tregtisë Kiço Ngjela dhe ndonjë ministër tjetër, që nuk e njihja. Ishin dhe drejtuesit e disa kuadro kryesore të Ndërmarrjes Projekti.

Foli J.Pashko: "Hotelin e Turizmit-tha-nuk do ta ndërtojmë në Sarandë. Qeveria mendon të bëjmë disa hotele turizmi në Durrës. Do të vinë njerëz nga Demokracitë Popullore si p.sh. RDGJ, Çekosllovakia. Nuk do të vinë kapitalistë. Do të na vinë njerëz të thjeshtë, pa shumë pretendime. Dhe hotelet kështu do t'i bëjmë të thjeshtë, se ata vinë për detin tonë, për klimën".

Pastaj foli Sh.Dragoti për disa probleme teknike dhe tha që projekti i hoteleve do të bëhet tip, që të përsëritet atje sipas nevojave. Projekti-vazhdoi-të jetë gati në fund të muajit, që të fillojë shpejt ndërtimi.

Unë, mëzati i pashtruar ende në parmendë, nuk u përmbajta dot dhe thashë: "Ky projekt nuk bëhet dot brenda një muaji".

"Pusho, mor ti,-klithi Shinasiu me zërin e tij të hollë e të mprehtë,-sapo ke ardhur, do të na mësosh, se si bëhen projektet!"

Nuk i mbajta dot lotët. Ula kokën e mundohesha t'i fshija pa më parë njeri. Por ark. A.Lufi më pa. Afroi karrigen pranë meje e duke më vënë dorën mbi sup, foli lehtas: "Mos u mërzit, djalë. Kështu e kanë këta. Do të mësohesh. Durim." Ajo ngrohtësi më qetësoi.

Pastaj u dhanë porosira për dhomat, për ndërtimin etj.

Kostaqi dhe unë dolëm jashtë loje, ca nga dëshira jonë për të mos u marrë me atë punë që po degjeneronte e ca më shumë nga dëshira e drejtuesve të Ndërmarrjes për të mos e vazhduar ne atë projekt.

Projekti arkitektonik iu ngarkua ark.S.Luarasit dhe

një tekniku me përvojë, V.Rusi.

Për gafën që u bë me ato hotele, gjykimin e dha koha. Në fillim u dukën se do të bëheshin ndërtime të një arkitekture moderne sepse, në krahasim me hotelin "Adriatiku" që ishte në krah të tyre, ashtu u dukën, por përpjekje për të bërë ndërtime me vlera arkitektonike, aty nuk pati. Niveli i projektimit mbeti vetëm në shkallën e atij teknik e funksional, që në bazë të porosive nga lart, ishte tepër i çalë, veçanërisht me nyjet sanitare.

VILA PER HRUSHOVIN

Gjysma e dytë e vitit 1958. Nën drejtimin e S.Luarasit bëra ca vizatime planimetrike të një godine egzistuese, ku do të bëheshin ndryshime sipas disa porosive të dhëna nga diku. Një ditë pastaj shkuam në Vlorë në zonën e vilave të ujit të ftohtë. Hymë te njëra. Ishte ajo për të cilën kisha bërë vizatimet. S.Luarasi më shpjegoi edhe njeherë në vend se ç'kërkohej të bëhej dhe ikëm.

Aty nga fundi i shtatorit më thonë: "Me urdhër të Ministrit, do të vesh të punosh për atë vilën në Vlorë". Më dhanë projektin që kishim bërë, të cilin do ta zbatoja dhe u nisa. Mbërrita. Ç'të shikoj? Ajo vilë dykatëshe ishte prishur. Ishte hequr çatia, dyshemeja ndërmjet kateve, dyert e dritaret dhe kishin mbetur vetëm muret mbajtës dy kat gati për t'u shembur në çdo çast. Për të fjetur më vunë në dhomën e një si barrake, poshtë kësaj vile, ku flinin policët.

Më dhanë një brigadë me nja 25 veta dhe fillova. Llogaritjet konstruktive i bëja në këmbë e porosisja hekurat e soletave. Arritëm në çati, të cilën e kishim parashikuar të bëhej tarracë për ta bërë një vilë disi moderne. Një ditë përpara se të betononim trarët e taracës, ia behu një Zim i zi. U hap porta: Mehmet Shehu!

Ç'bëhet këtu? Heshtje... Si do ta mbuloni sipër? Me taracë-i thashë. Si?-klithi Mehmeti. Dashkeni të na piqni këtu? Me çati të bëhet!-tha dhe krisi iku.

Erdha urgjentisht në Tiranë. Bisedova me S.Luarasin, ai shkoi bisedoi me të tjerët dhe më thanë të bëhet me çati të ulët me eternit e me parapet rreth e qark, që të mos duken. U hoqën hekurat e trarëve. U prishën kallëpet, u vunë trarë e listela për mbulim me eternit. Ndërkohë që mbulimi me eternit po përfundonte, ia mbërriti përsëri Zimi i zi. Doli Mehmeti. Me se po e mbuloni kështu? Me eternit. "Pse në barrakë do të na futni?"-klithi. "Ju thashë, mbulojeni me çati!" dhe iku.

Përsëri prishje. Përsëri nga e para çatinë. Për fat të mirë ishte hera e fundit.

Gjatë ndërtimit erdhi për të parë vetë Enver Hoxha. "Të na e bëni të mirë këtë vilë,-tha-se nuk e duam për vete, e kemi për miq". Shpejt pas kësaj, mora vesh, se do të vinte Hrushovi. Gjatë ndërtimit të asaj vile mësova shumë gjëra.

Pashë për herë të parë Koço Tashkon që pushonte në një nga ato vila të dorës së dytë. Nga sjellja haptas me mospërfillje e madje me përbuzje ndaj tij, e punonjësve të shërbimit e të rojeve, kuptova se ai tashmë ishte njeri i padëshiruar.

Pashë nga afër tërbimin e M.Shehut dhe orgjitë e tij gjahtare-gjakatare, kur dilte për të vrarë derr të egër në Karaburun. Më të tërbuar se ai, ishin rojet që e ndiqnin nga pas. Sapo ndalonin dy-tre gaze te vila mbi tunel, krijohej një atmosferë frike, terrori e tensioni të pashpjegueshëm. Qarkullimi rrugor ndalohej. Fabrika e vajit mbyllej. Shuhej kaldaja e saj se ai nuk dëgjonte dot zhurmën e lëshimit të avullit. Orgjitë e gjahut me sa duket i ishin bërë të domosdoshme atij njeriu që desh të shihte patjetër gjak.

Atëherë mora vesh, se kur nuk vriste derr të egër, bëhej vetë i egër si derr e s'guxonte t'i dilte njeri përpara. Që ta kishte të sigurtë gjahun, në zonën e Butrintit çoi derra të butë të zinj femra, që të kryqëzoheshin me të egrit e të shtoheshin.

Pashë harxhime pa kursim për ta bërë zonën e vilave parajsë të mundshme përmbi tokë. U ndërtuan

nja dhjetë vila të reja, u bënë rrugë e rrugica, mbilleshin portokalla, limona, pemë. Vetëm mua më dhanë 100 ushtarë të komanduar nga një kapiten për të bërë pastrime rreth e qark. Nga fillimi i Majit '59 vila përfundoi dhe unë ika. Në Qershor erdhi Hrushovi.

Me sa kam dëgjuar, kjo vilë që u modifikua për Hrushovin, aty nga viti 1978, u prish krejt e në vend të saj u ngrit një vilë për Mehmet Shehun e projektuar nga K. Çomi.

Pas kësaj më vunë një kërcu përmbi samar. Më dërguan të ndihmoja në bërjen e Ekspozitës me rastin e 15-vjetorit të Çlirimit, d.m.th. më 29 Nëntor '59, të cilën e drejtonte ish-profesori im, arkitekti Besim Daja. Me prodhimet e mjera të asaj kohe dhe me mundësitë materiale minimale, disa arkitektë e piktorë-dekoratorë mundoheshin të paraqisnin bukur disi me art "sukseset e arrituara" duke përdorur ngjyra të pastra, kontraste të efektshme, vizatime të thjeshta, shkrime me karaktere moderne të cilat, në ekspozitat rutinë të mëparshme nuk ishin përdorur.

Në atë kohë Sekretar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë ishte piktori Foto Stamo, vigjilent i zellshëm në mbrojtje të dogmatizmit partiak. Doemos, sekretarit në fjalë nuk mund t'i shpëtonte kjo dukuri e re që po shfaqej në atë ekspozitë.

I shqetësuar shkroi një letër mbi modernizmat dhe revizionizmat që po shfaqeshin në atë ekspozitë dhe e mbajti vrapin në Komitetin e Partisë të qytetit, ku sekretare e parë ishte Fiqrete Shehu. Fiqretja e alarmuar na i paskësh thënë Mehmetit. Mehmeti i tërbuar çatisi afër mesnatës në Ekspozitë, ku piktorët vazhdonin të punonin dhe në mes të sallës klithi: "Ç'është këtu, Beograd?"

Në një panel pa të vizatuar me viza të drejta dekorative figurën e një kameriereje.

- Kush e ka bërë këtë?-pyeti.

- Unë,-i tha piktori K.D. që para pak kohësh ishte kthyer nga studimet në Çekosllovaki.

- Ç'je ti?

- Piktor,-u përgjigj K.D.

- Ti je një gomar!-klithi Mehmeti.

Pastaj pa diçka dekorative të vizatuar me

kontraste ngjyrash të forta. Poshtë asaj figure ishte piktori dekorator i talentuar F.A.

- Ti e ke bërë këtë?
- Po-tha F.A.
- Ç'është kjo?
- Paraqitje e mineralit të kromit.

Pse s'thoni që këtu ka plasur modernizmi e revizionizmi?-tha Mehmeti e vazhdoi "Unë do të kërkoj nga Byroja Politike që kjo ekspozitë të mos hapet!" dhe iku.

Ata që e jetuan atë kohë, e dinë se ç'rreziqe përmbanin ato fjalë të Mehmetit!

Asaj nate, Besim Daja dhe piktorët që punonin me të, nuk e patën të vështirë ta shihnin fare pranë të hapur portën e burgut, prandaj deri në mëngjez punuan e i lyen me bojë të bardhë panelet, që pa Mehmeti e të tjera të ngjashme me to.

Në mëngjes erdhi Ramizi. Ku janë ato modernizmat, që pa shoku Mehmet?

I prishëm, ishte përgjigja. Pa, ç'pa, Ramizi iku.

Ca më vonë erdhi Liri Belishova. I ra qark ekspozitës dhe në një vend pa një tendë me tre ngjyra. Ç'është ky flamur jugosllav këtu?-tha-Hiqini këto ngjyra.

Sot e nesër, këto që shkrova, duken çmendurira, por të mos harrojmë, se për udhëheqjen komuniste marksiste-leniniste shqiptare ende të pakonsoliduar, atmosfera ishte e disfavorshme, prandaj tërbohej dhe jo pa shkak:

Nuk kishte shumë kohë që në Hungari ishte bërë kundërrevolucioni (apo revolucioni? Si ta quajmë?). Në ato ditë të vitit 1956, Mehmet Shehu, përpara oficerave të mbledhur në Kinema "Brigada" këlthiste: "Janosh Kadari është apo Janosh Kodoshi, ne nuk e dimë. Dimë se Hungaria e prishi kampin socialist".

Ishte bërë Konferenca e Tiranës ku, megjithë pasojat tragjike për disa, i ishte ngritur peta lakrorit dhe populli i pa lakrat që mbaheshin mbuluar.

Kishte ardhur Hrushovi, që megjithë fasadën e bukur të mikpritjes, pati disa battibecco me udhëheqjen shqiptare e pastaj vajti u puth me Titon, armikun e saj nr.1.

Në këtë ekspozitë, kontributi im ishte tepër i pakët, sepse isha i ngarkuar me detyra të tjera nga Ndërmarrja Projekti, ku punoja. E përshkrova ndodhinë e mësipërme për të mos u harruar, se në ç'kushte terrori punohej nga arkitektët e piktorët, madje edhe kur i shërbehej propagandës së partisë. (2)

POSTA E TIRANES

Jemi aty nga fillimi i vitit 1960. Mbi tryezën time të punës, më vunë një dosje të lidhur, ku ishte një projekt sovjetik. "kjo është për postën e Tiranës. Ti di rusisht-vazhdoi Eqremi, shefi i arkitektëve. Shikoje, lexoje dhe shko bisedo me ata të postës. Pastaj do ta përshtatësh sipas vendit".

Vendi i ndërtimit mendohej të ishte në parcelën prapa Bankës në Tiranë, atje ku sot është ndërtuar banesa.

E hapa atë dosje. Projekt tip i bërë për një qytet të humbur diku në ato Republikat e Azisë Qendrore. Arkitektura tipike e mureve të trashë me tulla, me kollona, korniza, frontona. Llahtari!

Vajta tek specialistët e postave, punëtorë të vjetër, që diç merrnin vesh nga vizatimet. Mirë-më thanë-këtë sallën e pritjes së popullit, mirë e ka, por të tjerat i ka të vogla.Ne na duhen edhe një herë kaq.

Me pretekstin e teknologjisë, fillova një projektide nga e para, me vija të thjeshta e të qarta, në linjë arkitektonike, që afronte disi me arkitekturën e Bankës. Nejse. E mbarova. Dale-thanë-se vendi do të ndërrohet. Posta duhet të jetë më në qendër. Kështu e kanë tërë kryeqytetet. Mirë, po ku? Ja, atje, ku është Kisha Ortodokse. Ka vend atje. (Aty, ku sot është ndërtuar Hotel Tirana).

E bëra për këtë vend një skicë-ide. Jo-u tha-vendi i Postës do të jetë në parcelën ndërmjet rrugës së Durrësit dhe rrugës së Kavajës (pjesa, tek Dhoma e Tregtisë sot).

E bëra dhe për atë vend një skicë-ide.

Jo, mor, jo,-u tha përsëri. Posta duhet të jetë në qendër. Pse, në Moskë, nuk është në qendër posta? Edhe në Tiranë, në qendër duhet të jetë! U caktua vendi nga pallati Kaceli, tek Sahati dhe gjithë parcela, ku sot janë sallat e Hotel Drinit, deri tek rrugët kufizuese të saj. U tha që të bëhet bashkë me Ministrinë e Komunikacioneve. U caktua goxha fond. Pra, punë serioze përpara.

Tepër i gëzuar për vendin e ri, me një farë përvoje, s'më mbante vendi të filloja. U mundova të qartësoj teknologjinë. Bashkë me drejtorin e atëhershëm të postës, ish punëtor i vjetër i saj, hynim nëpër ambientet ekzistuese dhe pyesnim gra, pleq, postierë. Drejtori e fillonte me ton madhor: Do të ndërtojmë Postën e re të Tiranës. Erdhëm t'u pyesim, si e doni. Ja, juve që punoni këtu, si e doni këtë dhomë, që ai e quante sallë. Ato gratë e gjora, që vetëm aq kishin parë, thonin: Po, ja, shoku drejtor, sikur të jetë edhe një herë më e madhe, se s'kemi ku vemë letrat.

Në çdo repart që vinim, përgjithësisht këto dëgjonim. Së fundi, gjeta atje një mikun tim inxhinjer, që kishte studiuar në Itali e më shpëtoi. Lëri këta-më tha. Këtu janë të tëra, por këta nuk i dinë. Tek ky dollapi këtu, janë shumë revista frëngjisht të UPU (Union Postale Universele.). Ç'të kërkosh, gjen atje. Dhe vërtet e gjeta. Atje mora vesh se ç'ishin postat në botë dhe se sa larg isha unë me punën artizanale, që kisha nisur. I studiova të tëra dhe përmirësova plot gjëra në teknologji, duke qenë i ndërgjegjshëm, se mbetesha larg asaj që duhej dhe gjithë vëmendjen ia kushtova zgjidhjes arkitektonike. E mbarova projektidenë, bëra dhe një maket dhe drejt e në Komisionin Qendror të Ndërtimeve, pranë Komisionit të Planit, që e drejtonte Spiro Koleka. U pa projekti, u pëlqye, u miratua.

U ktheva në zyrë i lumtur, lashë projektet e shkova në shtëpi. Pas dite, besoj të ketë qenë Korrik, thashë me vete:Do të dal të bëj një shëtitje gjer nga Universiteti, të shlodhem ca, se m'u hap koka. Ika.

Dalngadalë po kaloja përpara Kryeministrisë, kur dëgjova një zë të hollë, të thotë: Kolevica! Ishte Pupo Shyti, zv/ Presidenti i Komisionit të Planit, me të cilin njihesha. Duke buzëqeshur me zor me dhëmbët e tij të bardhë, më tha: Kolevicë, atë projektin që aprovuam në mëngjez, e hoqëm nga plani, Nuk kemi fonde. Mbetet për më vonë, por ti projektin vazhdoje.

Atëhere ende nuk kishim filluar t'i shihnim qartë difektet e ekonomisë së planifikuar dhe as lodrat që bënte Komisioni i Planit, sa për t'u gjendur Kola në punë.

* * *

Pasi kisha bërë projektin e Kopshtit të fëmijëve në Vlorë, i cili dhe u ndërtua; pas projektit dhe përvojës ndërtimore të vilës në Ujin e Ftohtë; pas projektidesë së dështuar të Hotel Turizmit në Sarandë; pas projektit të një banese katërkatëshe në Tiranë, e cila u ndërtua; pas punës prej Sizifi në projektin e Postës së Tiranës dhe veçanërisht me marrjen e njohurive fillestare të historisë e të problemeve të arkitekturës moderne, fillova të ndjeja veten të sigurtë, për të marrë përsipër projekte më të rëndësishme. Fati ma solli shpejt në dorë një rast të tillë:

BANESA PRAPA BANKES NE TIRANE

Në parcelën, ku mendohej në fillim të ndërtohej Posta e Tiranës, më dhanë të bëja projektin e një banese pesëkatëshe. Jemi në vitet 60-61. Punova me kënaqësi të veçantë e përqëndrim të madh, duke futur në projektim e në ndërtim për herë të parë disa elementë të rinj, të cilët u përdorën më vonë edhe nga projektues të tjerë.

Këta elementë ishin:

- U përdor seksioni me 4 apartamente në shkallë, me shkallën të ndriçuar nga lart dhe nyjet sanitare me ndriçim e ajrim me pus të brendshëm.
- U përdor shkalla me një rampë nga kati në kat.
- U përdor skeleti beton arme dhe mure krejtësisht me tulla me bira. (3)

Nga pikpamja arkitektonike, bëra përpjekje për ta trajtuar me elementë të një arkitekture moderne, me llozha e ballkone për çdo apartament, me dritare më të mëdha se tipat e zakonshëm, etj. Pas miratimit të projektidesë në Këshillin Teknik, dikush e shpuri fjalën më lart dhe shpejt u interesua inxhinjeri i Byrosë Politike, S.Koleka, i cili kërkoi të bëheshin ndryshime, që e shpërfytyronin atë projekt. M'u desh ta përpunoja nga e para, por duke këmbëngulur në mos heqjen dorë nga ajo arkitekturë. Ndërkohë projekti konstruktiv ishte mbaruar dhe kishin filluar punimet ndërtimore, që po ecnin mjaft shpejt. Mirëpo larot, që ishin përreth, e kishin shpënë fjalën shumë më lart. Duhet të ketë qenë një ditë e ftohtë Shkurti i vitit 62, kur bashkë me Ministrin Josif Pashko, na kishte thirrur për ta parë projektin, Kryeministri, Mehmet Shehu.

Bashkë me Ministrin, po prisnim më këmbë në dhomën e vogël para kabinetit të tij, kur ai hyri me pallto të gjatë e me kokore ruse në kokë. Na kaloi afër, sa mend na preku me brryl, po as na hodhi një vështrim dhe jo që nuk i shtrëngoi dorën, por as i tha "mirmëngjez" Ministrit, shokut të vjetër të luftës, ish zëvendësit të tij të Ministrisë së Brëndshme, pa le mua që s'prisja të më përfillte. Pra, vetëkuptohet ç'farë atmosfere e rëndë u krijua.

Në syrin e këtij cikloni që po formohej, rrija unë me një tub të trashë prej letrash të vizatuara të atij projekti që më ngjante si një bombë me sahat e cila pritej të shpërthente nga çasti në çast.

Pasi na la të prisnim ashtu më këmbë nja 10 minuta, roja, që rrinte aty tek porta, na tha të hynim.

Mehmeti, nursëz siç ishte, pa i ngritur sytë, më tha ta hapja projektin mbi tavolinën e tij.

Këtu më duhet të bëj një parantezë shpjeguese: Në atë kohë, të rinjtë kishin filluar të ndiqnin modën

perëndimore. Vajzat vishnin zhupon (një lloj fundi të shkurtër me shumë pala, që formoheshin nga këmisha e kollarisur poshtë tij), ndërsa djemtë mbanin pantallona të errta, të hekurosura e mjaft të ngushta poshtë. Doemos, zyrtarisht, kjo modë nuk pëlqehej dhe shahej e përqeshej.

Në fasadën e projektit të vizatuar në shkallë të madhe, me ngjyra, për ta bërë sa më të natyrëshme, kisha vizatuar dhe plot figura të rinjsh të veshur sipas kësaj mode e të vendosur në rrugë, nëpër llozhat e ballkonet, ose pranë veturave gjoja personale.

Këtë vizatim, për të "skandaloz", Mehmeti e pa, e pa me vërejtje, tërhoqi me forcë sirtarin e tryezës, nxorri prej andej një laps të kuq të trashë dhe pa e zgjatur, i bëri brutalisht një kryq diagonalisht të gjithë fletës. Pastaj, duke ma flakur projektin, tha:

"Këto lakra, që ke bërë këtu, këto ke edhe ti në kokë. Ç'janë këta karagjoza që ke bërë? Ç'janë këto dritare të mëdha? Ndryshoje!"

M'u desh të bëja ndryshime të sforcuara për ta sjellë në një gjendje të pranueshme duke i zvogluar dritaret dhe kështu vazhdoi ndërtimi, por ndërhyrjet nuk pushuan.

Kur ndërtesa ishte ndërtuar e gjitha karabina, madje ishin bërë shumë punime të brendëshme, më thirri zv/ Ministri, Sh.Dragoti e në prani të Drejtorit të Ndërmarrjes Zbatuese "21 Dhjetori" e të Drejtorit të Drejtorisë së Arkitekturës së Ndërmarrjes Projekti, më dha urdhër të shkoja t'i zmadhoja dritaret.

Ja, pra, ç'duhet të përballoje në atë kohë!

Kur i bëra dritaret të mëdha, më shanë e më thanë t'i zvogloja. Kur i zvoglova, më thanë t'i bëja të mëdha!

Nuk e pranova këtë urdhër dhe i çova urgjentisht S.Kolekës letrën e mëposhtme, që po e vë në fotokopje. Si pasojë e kësaj proteste, nuk u bënë ndryshime, megjithëse edhe për bojën e kuqe që përdora në fasadë, erdhën kritika të rrepta nga lart se, sipas tyre, ishte shumë e errët.

Për ta mbyllur këtë histori të hidhur, duhet të përmend, se mbasi mbaroi ndërtesa, në fund të Dhjetorit 1963, përpara se të futeshin banorët, shkoi e pa vetë Mehmeti, por për fatin tim, nuk gjeti ndonjë gjimë në qull...

SHOKU ZV. KRYEMINISTER

Sikundër jini në dijeni,projektit të ndërtesës banimit mbrapa Bankës në Tiranë,/i u bë zvogëlimi i dritareve simbas verejtjeve të bëra nga lart. Me udhëzimin tuaj u punuan tre variante të pamjeve kryesore me dritare më të vogla dhe aprovuat pastaj <u>variantin e tretë me dritare tre kanatshe dhe ballkone dysh</u>(shkresa e juaj dt.2/III/1962).-

Kështu u bë projekt-zbatimi dhe kështu po ndërtohet.

Tani,kur njeri ballkë i ndërtesës ka mbaruar plotësisht dhe kanë hyrë familjet,kur dy ballqet e tjerë janë mbaruar karabina, janë vendosur dyer dritare,kanë mbaruar pothuaj suvatimet e brendeshme,instalimet etj.,nga ana e drejtorisë po më kërkohet me kësëngulje që t'i zmadhoj dritaret,sepse - thonë - duken të vogla.

Një urdhër të tillë jam detyruar të mos e zbatoj për këto arësye :

1.- Dritaret në të tri pamjet kryesore janë parë dhe aprovuar nga ana juaj,prandaj unë s'mund të bëj asnjë ndryshim pa dijeninë tuaj.

2.- Dritaret që janë vendosur kanë përmasat :
1,8 m. gjërësi x 1.2 m. lartësi = 2,16 m2.
Ndërsa dritaret tip janë me përmasa
1,45 m.gjërësi x 1,5 m. lartësi = 2.17 m2.
Pra,në sipërfaqe dritaret që janë vendosur janë njëlloj me dritaret tip. Atëhere pse të zmadhohen ?

3.- Më duket se drejtorija është kujtuar tepër von për kapjen e këtij "problemi".-
Në qoftë se seriozisht interesohet për mbarëvajtjen e objektit kjo gjë duhej ngritur në mos që në projekt,të paktën në katin e parë të bllokut që u ndërtua në fillim dhe jo sot kur objekti është në mbarim e sipër dhe do të duhen të harxhohen kot rreth 500.000 Lekë,perveç përshtypjes së keqe në popull.

4.- Është e kotë të mendosh të heqesh dritaret egzistuese të prishish kasat,të dëmtosh muret me tulla me vrima etj. për të vendosur dritare të tjera me lartësi vetëm 10 cm.më tepër dhe të pretendosh që këto dritare të reja do të duken të mëdha.

5.- Në njerin ballkë që ka mbaruar plotësisht,ka filluar suvatimi i jashtëm. Drejtorija për këtë pjesë mendon të mos bëjë ndryshimine dritareve,prandaj do të ishte mirë të pritej të shifej pamja e dritareve me suvatimin e jashtëm të mbaruar dhe atëhere të vendosej.

I bindur për sa më sipër ju lutem të ndërhyni.-

Tirane,me 10/IX/1963.

Me respekt
Ing. (Petraq Kolevica)

BANESA TEK ISH FUSHA E TENISIT NE KORÇE.

Pothuajse në të njëjtën kohë me projektin e banesës prapa Bankës në Tiranë, pata bërë dhe atë të banesës tek ish Fusha e Tenisit në Korçë. Për këtë u pat interesuar vetë Ministri J.Pashko. Vendi i ndërtimit ishte i rëndësishëm. Nga njëra anë kishte një panoramë të pafundme mbi krejt fushën e Korçës, duke mbyllur kështu perspektivën e rrugës së Bilishtit, që në të ardhmen, mund të ishte rruga e hyrjes në Korçë nga Greqia dhe nga ana tjetër kishte panoramën e bukur mbi gjithë malet e Moravës dhe krejt qytetin.

Isha i detyruar të përdorja seksionet tip (59/1) të banesave, por i bëra disa përshtatje, që më ndihmuan në përmirësimin e funksionit të ambienteve dhe të linjës arkitektonike. Vizatimet e projektidesë ia tregova Ministrit. Ai më foli pa ndrojë: "Petraq, unë në projekt nuk kuptoj mirë. Ma bën dot ashtu si i bën ti, me karton, maket, a si i thoni?"

Brenda një jave, e bëra maketin e ndërtesës prej kartoni, në shkallën 1:100, ia tregova, e pëlqeu dhe pa asnjë ndryshim, u bë projekti i zbatimit. Ishte një zgjidhje arkitektonike, që dallohej shumë nga projektet e tjera, të cilat zbatoheshin në atë kohë. Si pasojë, filluan të dëgjohen thashethemet keqdashëse, ku më shumë dëgjohej daullja e rrezikut të modernizmit, përpara së cilës mund të stepej dhe vetë Ministri. Ndërkohë, po mbaronte viti 1962. Urgjentisht u nisa për në Korçë me projektin e themeleve të ndërtesës nën sqetull. E bisedova gjendjen me Drejtorinë e Ndërmarrjes së Ndërtimit, e cila gjithashtu, ishte e interesuar të fillonte punën, për ta pasur front të hapur për vitin tjetër. Më 29 Dhjetor, në një ditë të ftohtë, përmes një dëbore të dëndur, bëmë sikur piketuam një plint, u gërmua, u hodh ca beton,

u bë një situacion, që të nesërmen u dorëzua në Bankë dhe kështu u quajt që ajo godinë kishte filluar dhe nuk "u dogjën" fondet e caktuara për të, por "u dogjën" planet e mbrapshta të keqdashësve, thashethemet e të cilëve vazhduan edhe pasi godina mbaroi.

Me këtë rast, vlen të tregohet kjo ndodhi:

Duhet të ketë qenë vera e vitit 1964. Nuk di përse isha në Korçë bashkë me zv/Ministrin, Sh Dragoti. Atëhere, në Korçë, sekretar Partie ishte Pirro Kondi. Me sa duket ai si sekretar Partie, i kishte dëgjuar fjalët për modernizmat, të thëna kush e di se ku, për banesën tek ish Fusha e Tenisit dhe ndërsa po kalonim së bashku pranë saj (ende e pa përfunduar), P.Kondi e pyeti Sh. Dragotin: Si ju duket kjo ndërtesë?

U!-tha Shinasiu-ne, si na duket? Ne, e kemi bërë! Juve, si ju duket?

P.Kondi-vazhdoi: Një delegacion i Partisë Komuniste Franceze, që ishte këtu, na tha, se të vetmen godinë me arkitekturë moderne, kini këtë.

Askush nuk bëri më asnjë koment. Unë, u gëzova e s'gëzohesha dot, se modernia në Shqipërinë e asaj kohe, mund të quhej fare lehtë moderniste.

Me ndërtesën e lartpërmendur, filloi seria e projekteve të mia, për disa ndërtesa në Korçë. Për këtë çështje, u bashkuan dy interesa:

Interesi i parë:

Pas kritikës së rëndë që m'u bë për banesën prapa Bankës, në Tiranë, Drejtoria e ish Ndërmarrjes Projekti, që tashmë ishte bërë Institut Projektimi, kishte interes dhe bëri çmos të më largonte nga projektet e godinave që bëheshin për Tiranën.

Interesi i dytë:

Në atë kohë, Kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Korçës, ishte Myftar Grabocka, burrë i mençur, që e dinte se duhej t'i shërbente mirë atij që e kishte vënë në atë vend dhe mirë i shërbeu, por donte të linte emër të mirë në Korçë për vitet, që do të qëndronte atje. Pati zotësinë ta kuptonte shpejt që këtë mund ta arrinte, duke i kushtuar vëmendje ndërtimeve. Tani, nuk jam në gjendje të them me saktësi se në ç'vit, por e di që ishte verë, mbase që në fillim të caktimit të tij si Kryetar të Komitetit Ekzekutiv,

kur na thirri arkitekt S.Luarasin, me gjithë gruan e vajzën e tij, arkitekt A.Lufin dhe mua e na shtroi një drekë në një sallë pranë dhomës së Drejtorit të Fabrikës së Birrës në Korçë, ku na gostiti me birrë speciale të asaj fabrike dhe na kërkoi bashkëpunimin tonë për ndërtimet në atë qytet.

Pas asaj dreke, arkitekt S.Luarasi e arkitekt A.Lufi, nuk u dukën më në Korçë, ndërsa unë, i mbështetur nga Kryetari, munda të bëja projektet e atyre ndërtesave në Korçë, që po të ishin në Tiranë, nuk do t'i bëja dot.

Kështu mund të përmend banesën (të emërtuar pranë monumentit të Stalinit), e cila më kushtoi shumë punë, por nuk më krijoi probleme, pa çka se zgjidhja arkitektonike vazhdoi në frymën e arkitekturës moderne. Me të njëjtën lehtësi, kaloi edhe Shtëpia e Oficerëve, që u ndërtua jo shumë larg saj.

SHKOLLA 12 VJEÇARE NE KORÇE

Për shumë vite me radhë, shkollat tek ne u ndërtuan sipas projekteve tip të njëllojtë për çdo qytet të vogël apo të madh e për cilëndo klimë, bregdetare të butë, apo malore të ashpër e me dëborë.

Aty nga viti 1958, mbaroi studimet në Moskë dhe erdhi në Ndërmarrjen Projekti arkitekt S.Mosko, i cili ndër projektet e para, u mor me rishikimin e projekteve tip të shkollave, të cilave u bëri disa ndryshime e plotësime, duke u shtuar punishte e palestra, strehë të mbuluar për pushimin e nxënësve me zgjidhje planimetrike simetrike dhe asimetrike. Kjo punë ishte një hap përpara në krahasim me tipet e mëparshme.

Herë pas here kërkohej ndërtimi i ndonjë shkolle të

re nëpër qytete të ndryshme, gjë që sipas orientimit të përgjithshëm, zgjidhej duke dhënë për zbatim projektin tip, në rastin më të mirë, duke i bërë ndonjë ndryshim të vogël në fasadë me ngjyrosje, korniza dritaresh, apo artificë tjetër.

Një ditë erdhi kërkesa e projektit për ndërtimin e një shkolle 12 vjeçare në Korçë. Merr projektin tip-më tha drejtor Eqremi-dhe shko vendose atje ku e kërkojnë ata të Komitetit Ekzekutiv.

Duhet të ketë qenë vjeshta e vitit 1963. Deri atëhere unë kisha bërë disa ndërtesa në Korçë, kisha fituar besim ne veten time dhe përkrahjen, siç e shpjegova më lart, nga Kryetari i Komitetit Ekzekutiv.

Shkova në Korçë, jo për të dhënë projektin tip që kisha marrë me vete, por për të fituar kohë e të shikoja vendin e ndërtimit. Sa dëgjova, se në Korçë do të ndërtohej një shkollë e re, i thashë vetes: Jo! Nuk do ta lë të ndërtohet shkollë tip. Do të bëj një projekt të ri. Ndërkohë kisha grumbulluar një farë bagazhi teorik për ndërtimin e shkollave sipas parimeve të pedagogjisë moderne. Kisha studiuar librin **"Le scuole"**, ku kishte shembuj ndërtimi të shkollave nga disa vende të përparuara të botës. Gjuaja edhe nëpër revistat e arkitekturës kur kishte edhe ndonjë projekt shkolle. Shkurt, kisha formuar bindjet e mia te reja për projektimin e shkollave, të cilat binin në kundërshtim me ato që ndërtoheshin tek ne.

Duke punuar në fshehtësi dhe shpejt, si në kllapi, bëra projektidenë dhe e paraqita duke mos zbatuar urdhërat e dhëna. Në mbledhje erdhi dhe Kryetari i Komitetit Ekzekutiv, i cili mbështeti projektin që kisha bërë dhe kështu u miratua.

Tek ai projekt vura në zbatim për herë të parë tek ne klasat me përmasa afër katrorit të orientuara në Lindje dhe në Jug. Ndava bllokun e laboratorëve nga klasat, vura palestrën në katin e dytë e brenda trupit të ndërtesës, si dhe sallën e pushimit të nxënësve krejtësisht të mbyllur, gjëra këto të domosdoshme për klimën e ashpër të Korçës.

Përveç këtyre rrita disi sipërfaqen e klasave, ndërsa ndriçimin natyral gati e dyfishova dhe u përkujdesa t'i jap

ndërtesës një zgjidhje arkitektonike te veçantë e moderne. Mirëpo pengesat nga ana e drejtorisë u shtuan.

Pas miratimit të projektidesë, kërkova inxhinjer konstruktor, për të bërë shpejt projekt-zbatimin, por drejtor Eqremi tha: "Për shkollat kemi projekte tip. Nuk lejohet të bëhen projekte individuale, prandaj nuk të jap inxhinjer konstruktor".

Atëhere i thashë vetes: "Ç'e do inxhinjerin konstruktor? Kaq llogaritje di t'i bësh edhe vetë. Bëji!". Dhe ashtu veprova. Bëra vetë përpunimin arkitektonik, vetë llogaritjet konstruktive. I ndihmuar edhe nga gruaja, përfundova projektin e zbatimit dhe shkolla u ndërtua. Koha tridhjetëvjeçare, që ka kaluar, tregoi se nuk gabova. Kam biseduar me pedagogë të asaj shkolle, me nxënës, kam hyrë në klasat gjatë mësimit dhe kam dëgjuar vetëm fjalë shumë të mira. Meqenëse u pat pëlqyer, ajo shkollë u përsërit dhe në Lushnje.

Eshtë për t'u shënuar se, në këtë ndërtesë, me këmbënguljen time, u arrit të bëhej në fasadën e hyrjes një basoreliev me motive nga jeta e shkollës. Për këtë, në gazetën "Zëri i Popullit" (8 Qershor 1969) skulptori Thoma Thomai ka shkruar:

"Sa shkolla janë ndërtuar, por vetëm në njërën prej tyre, me inisiative nga ana e arkitektit, u bënë përpjekje për një bashkëpunim artistik... dhe mbas saj nuk pati raste të tjera më".

BANESA SHTATEKATESHE NE KORÇE

Arkitektët, gjithmonë i ka tërhequr ngritja e godinave në lartësi. Shembujt në botë janë me mijra duke filluar që nga Kulla e Baabelit e deri tek grataçielat. Nga kjo grishje nuk mund të shpëtonin as arkitektet shqiptarë

e ndërmjet tyre, as unë.

Viti 1963-1964. Në Korçë po prishej lagja Katavarosh, po hapej e gjërë rruga kryesore e hyrjes në qytet. Nga Komiteti Ekzekutiv i Korçës, m'u kërkua të projektohej një ndërtesë banimi shtatëkatëshe në krye të kësaj rruge, e cila do të shënonte fillimin e qytetit, por duke e ditur se do të kisha probleme me projektimin e një ndërtese të tillë, thashë ta bënin kërkesën zyrtarisht.

Në shkresën Nr.2/555, datë 20.08.1964, Komiteti Ekzekutiv kërkonte:

"Shtojmë veçanërisht se duhet që ky objekt të jetë i punuar në mënyrë speciale nga ana e paraqitjes së jashtme, mbasi është objekt në hyrje të qytetit nga rruga kryesore, si dhe apartamentet të jenë të bollshëm".

Duke pasur mbështetje këto kërkesa, punova disi më i qetë projektidenë, ku futa disa elementë të rinj funksionalë dhe arkitektonikë në apartamentet e banimit.

Së pari, në krahasim me projektet tip, i rrita sipërfaqet e ambienteve. Shtova aneksin e gatimit pranë kuzhinës, parashikova kanal për shkarkimin e plehrave, si dhe ashensor për ngjitje-zbritjen e njerëzve. Edhe zgjidhjen konstruktive e konceptova me elementë të papërdorura më parë e në përshtatje me kushtet sizmike të Korçës, si p.sh. kollonat me seksion në formë L nëpër qoshet, etj.

Projektin gati e kisha përfunduar për ta paraqitur në Këshillin Teknik, por një ditë vdiq komshiu im dhe nuk shkova në punë. Pikërisht atë ditë kishte ardhur Kryetari nga Korça, kishte biseduar me Ministrin dhe me lejen e tij kishte marrë projektin nga zyra ime dhe e kishte çuar ta shihte e ta miratonte E.Hoxha.

Ndërkohë dërguan më thirrën mua të shkoja të takoja Kryetarin në Komitetin Qëndror, se mund të duhesha për ndonjë sqarim. Siç isha i veshur për përcjelljen e të vdekurit, u nisa e me nxitim arrita në ndërtesën e Komitetit Qëndror. (Doemos më këmbë, se veturë nuk më dërguan).

Ndërsa po ngjisja shkallët për në katin e dytë, pashë Kryetarin që po zbriste buzëqeshur me tubin e projekteve nën sqetull.

"I madhi e pa - më tha - e miratoi. Bëj projektin dhe ta ndërtojmë".

U ktheva në Institut i gëzuar, por të nesërmen filloi tjetër muzikë.

U bë mbledhje me arkitektët e inxhinjerët konstruktorë, ku u kritikova ashpër nga drejtori për individualizëm, për gjigandomani, për kërkim të lavdisë personale e të zeza të tjera. U vu kusht i domosdoshëm të ulja sipërfaqen e apartamenteve dhe të zvogëloja koston. (4,

Në atë kohë, sikur dikujt tjetër t'ia miratonte projektin E.Hoxha, me siguri që shokët e Partisë e të Drejtorisë, do ta merrnin hopa e do të thërisnin: Hurra! Kurse për mua u bë një mbledhje vetëm për të më kritikuar, pa thënë makar **njëckë** fjalë të mirë.

Këtu duhet të ndaloj e të tregoj diçka që më duket e rëndësishme:

Aty nga fundi i vitit 1991, ish drejtori i atëhershëm, S.Angoni, gjatë një bisede me të, tha:

"Na fal, o Petraq, se atëhere nuk të patëm kuptuar". Sipas mendimit tim, këto fjalë nuk ishin pasojë e një çasti dobësije sentimentale, por forcë karakteri, që i lejoi atij burri të ashpër të ngrihej mbi marrëzitë e asaj kohe.

Po le të kthehemi përsëri tek ajo mbledhje... Nga atmosfera që u krijua, u stepën inxhinjerët konstruktorë dhe asnjeri nuk shfaqi gadishmërinë të punonte me atë projekt. Të gjithë, doli se ishin "shumë të ngarkuar" me projekte të tjera.

Atëhere, i ndjeri, inxhinjeri Lutfi Strazimiri, e kërkoi ta bënte projektin vullnetarisht. Me te ndjerin Lutfi, e kisha të lehtë të punoja. Projekti u mbarua shpejt dhe gjithë gëzim, me fletët e tushuara në letër transparente, shkova ta firmoste shef Eqremi.

Dale-tha ai. "S'ka shteti ynë aq para sa të bëjë ndërtime shtatëkatëshe. Fasadën e katit të shtatë kruaje me brisk. Ndërtesa do të bëhet gjashtëkatëshe".

Ky ishte një budallallëk, të cilin e lashë të kalonte, se s'më prishte punë. E krova katin e shtatë në fasadën e projektit arkitektonik. Shefi u kënaq dhe e firmosi, por harroi se projekti i konstruksionit mbeti shtatëkatësh, nuk u krua dhe godina u ndërtua shtatëkatëshe.

KREU I GJASHTE

Kemi arritur kështu në vitin 1965. Shkëputja nga arkitektura ruse me kohë ishte bërë fakt. Kishin filluar të vinin revista të arkitekturës rumune, çeke, bullgare, ku arkitektura moderne po gjente zbatim gjërësisht. Edhe tek ne kush më shumë e kush më pak, mundohej të ecte në rrugën e kësaj arkitekture. Për qëllime thjesht propagandistike, gazetat botonin fotografi të ndërtimeve të reja, që për t'u rritur dozën propagandistike, nuk ngurronin t'i quanin moderne.

Ja, p.sh. banesa prapa Bankës, në Tiranë, megjithëse dihej që u kritikua, kur mbaroi, gazeta "Zëri i Popullit" (datë 28 Nëntor 1963 dhe 11 Janar 1964), botoi foto të madhe të saj e shkruante fjalë lavdëruese:

"Ja edhe një nga ndërtesat e bukura te përfunduara ditët e fundit"

Ndërsa për banesën në ish fushën e tenisit në Korçë, gazeta "Zëri i Popullit", datë 26 Korrik 1964, shkruante:

"Përkrah stadiumit është në përfundim e sipër edhe një ndër godinat më të bukura të qytetit, me një arkitekturë të ndryshme nga ato që janë ndërtuar më parë".

Po në "Zërin e Popullit", datë 8 Janar 1965, për këtë ndërtesë, shkruhej:

"Kjo godinë është një nga më të mëdhatë e më të bukurat që është ndërtuar këtu".

Ndërsa foto të kësaj godine, botojnë gazetat "Zëri i Popullit" (1 Janar 1965), "Puna" (24 Janar 1964), "Bashkimi" (1 Maj 1965), revista "Ylli" Nr.3/64.

Megjithëse frika e ndonjë nofke të befasishme "moderniste" ende nuk ishte zhdukur, arkitektët nuk u stepën. Stili i ri i ndërtimeve gjente miratim në popull e përkrahje morale prej intelektualëve të sferave të ndryshme. Kështu po krijohej një opinion publik i

favorshëm. Erdhi koha të kishim një platformë teorike, mbi të cilën të diskutonim e të shënonim qartë rrugën ku duhej të ecnim.

Për këtë qëllim, botova në gazetën "DRITA" (datë 1 Gusht 1965) artikullin me titull **"Bisedë mbi arkitekturën"**.

Ndër të tjera aty i bija kambanës, për të dëgjuar të gjithë, duke shkruar: "Duhet të futim në ndërtimet tona parimet, iderat dhe shëmbujt më të mirë të arkitekturës moderne."

Si atëherë, ashtu edhe sot, titulli duket pa ndonjë veçanti.

E vërteta, që mund ta them sot, është kjo:

Arkitekti francez Eugéne Viollet-le-Duc, 100 vjet më parë (më 1863), pati botuar librin me titull **"Entretiens sur l'architecture"** (Biseda mbi arkitekturën), libër që u bë themeli ku u mbështetën arkitektët përparimtarë të fundit të shekullit të kaluar, të cilët u shkëputën nga arkitektura neoklasike dhe çelën rrugën drejt arkitekturës moderne.

Duke i vënë shkrimit tim të njëjtin titull, dëshiroja të vazhdoja aspiratën madhore te francezit Viollet-le-Duc, për shkëputjen nga arkitektura e vjetër e kalimin në arkitekturën bashkëkohore.

Shkrimi im u prit ngrohtë nga kolegët dhe u vazhdua me disa shkrime të tjera prej tyre në disa numra te gazetës "DRITA", por kjo i pati tronditur vigjilentët partiakë dhe siç mora vesh, një telefonatë nga lart në redaksinë e gazetës, i mbylli diskutimet.

Në vazhdim të krijimit e të forcimit të opinionit publik pro arkitekturës moderne e me synim të veçantë në rrethet intelektuale, botova në gazetën "DRITA" (9 Maj 1966) shkrimin përkujtimor me titull:

"ADOLF LOOS, një nga pionieret e arkitekturës moderne",

ndërsa më 5 Shtator të atij viti, botova në gazetën "DRITA" shkrimin përkujtimor për eksponentin e arkitekturës moderne botërore, arkitektin francez **Lë Korbyzjé**, ndaj të cilit kishin alergji drejtuesit e atëhershëm e me emrin e tij na përqeshnin.

Shkrime mbi arkitekturën vazhdova të bëj herë

pas here ku, ndonjëherë, prekja dhe krijimtarinë e kolegëve. Tani që i shoh këto shkrime në largësinë kohore prej dhjetëvjeçarësh, përsëri them se kam bërë mirë, paçka se, në këto raste, për kritikat e bëra apo lëvdatat e pabëra, nuk patën munguar meritë.

Gjithnjë me idenë e bërjes së njohur të arkitekturës moderne në rrethet intelektuale, në Qershor 1966, në Klubin e Lidhjes se Shkrimtarëve dhe Artistëve, munda të organizoja një mbledhje (e para e këtij lloji deri më sot tek ne), ku fola e bëra një panoramë të historisë së arkitekturës moderne në botë, të shoqëruar me projektimin e pamjeve të veprave kryesore.

Këtu duhet të rikujtojmë se jemi në kohën e afrimit më të madh me Kinën, ku po vlonte revolucioni kulturor proletar dhe zhvillimi i kësaj teme dukej, në mos çmenduri, një nonsens. Në mbledhje erdhën kryesisht arkitektë. Erdhi dhe sekretari i partisë i Tiranës, Fadil Paçrami. Para fillimit, Foto Stamo, m'i kërkoi t'ia jepja të shkruara ato që do të thoja, sepse-tha-ky është rregull që nuk e shkelim dot.

"S'kam gjë të shkruar-i thashë-Ato, që do të them, i kam në kokë".

Me gjithë tensionin, që u krijua, mbledhja u bë. Fola për arkitekturën moderne dhe pastaj-heshtje. Të nesërmen e më tej-heshtje varri. Në asnjë kronikë të ndonjërës prej atyre gazetave, që dilnin atëhere, nuk u përmend.

Që të mos harrohet, po e vë këtu ftesën e asaj mbledhje, që as sot, pas më se 30 vjetësh, nuk është përsëritur.

Ftesë

SH.....

Të Mërkurën më 23 Qershor 1966, ora 18. Klubi Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve ju fton në biseden:

ARKITEKTURA MODERNE

Biseden, shoqëruar me ilustrime, do ta mbajë

inxhiner Petraq Kolevica

Duke mos dashur të mbetesha vetëm në planin teorik, më 28 Janar 1966, pata botuar në "Zërin e Popullit" artikullin me titull **"Një vështrim kritik ndërtimeve tona",** ku mbasi kritikoja monotoninë me ndërtimet tip të banesave, shkollave e probleme të tjera, e thoja shkoqur: **"Duhet të futim në arkitekturën tonë parimet më të shëndosha të arkitekturës moderne".**

Ky ishte një shkrim që i pati thartuar fort Drejtorinë e Institutit të Projektimeve, ku punoja atëhere, si dhe inxhinjerin e Byrose Politike dhe hakmarrja e tyre ndaj meje doli sheshit tepër shpejt.

Jemi, pra në vitin 1966. Me bujë të madhe shpërtheu e ashtuquajtura "Luftë kundër burrokracisë", që në fillim të atij viti. Nën flamurin e asaj lufte, u dërguan lart e poshtë, ne fshat, në gjirin e klasës punëtore e gjetiu, shumë kuadro.

Me objektet e projektuara e të kritikuara, si dhe me shkrimet e lartpërmendura, vetëkuptohet që e kisha mbushur kupën dhe i pari e i vetmi arkitekt, tashmë i njohur, që u largua nga Instituti "për të forcuar" Zyrën e Projektimit të Komitetit Ekzekutiv të Tiranës, isha unë.

KREU I SHTATE

Në Zyrën e Projektimit të Komitetit Ekzekutiv të Tiranës, fillova punë, aty nga mesi i vitit 1966. Në fillim, ai grup kishte nja 10-12 inxhinjerë e teknikë të specialiteteve të ndryshme të ndërtimit, të ardhur nga Ndërmarrje, apo Institucione, ku disa s'kishin patur ndonjë përvojë të mirëfilltë projektimi. Kryetar i Zyrës ishte Kryearkitekti i Tiranës, Koço Miho. Në atë kohë, "me qarkullim", erdhi në zyrën e Projektimit dhe Enver Myrtezai. Ai kishte mbaruar dikur një shkollë teknike, por nuk e kishte ushtruar profesionin. Ishte nga komunistët e

hershëm dhe si i tillë, për shumë vjet, punoi në Komisionin e Kontrollit të Shtetit. Tani, që ishte me flokë krejtësisht të bardha, me sa duket, i kishte shkelur hijen dikujt lart dhe e nisën "të forconte" Zyrën e Projektimit.

Me gruan e tij, Dritën, që ishte teknike në Institut, kisha bashkëpunuar e prej saj isha njohur me Enverin. Që kur erdhi, zuri vend në një dhomë të vogël me mua. Tepër shpejt i dhanë të projektonte një banesë, që do të ndërtohej diku, pranë "Bllokut". Shkuam së bashku pamë vendin e ndërtimit. Enveri ishte shumë i shqetësuar, se vetëkuptohet, që s'mund të bënte një punë të tillë, për të cilën nuk kishte kurrfarë përvoje. Mos kij merak-i thashë. Projektin do ta bëjmë së bashku, por unë nuk do të firmos dhe vetvetiu projekti quhet i yti. Ti-vazhdova-e di, që një projekt si ky, mua nuk ma japin, por as unë nuk e dua, sepse mund t'i hap vetes telashe të mëdha. Dhe kështu ramë dakord.

Brenda jo më shumë se një jave, bëra projektidenë arkitektonike. Madje, i ndihmuar nga Enveri, të cilit i vinte mjaft për dore, bëmë dhe maketin e ndërtesës. Në atmosferën e luftës kundër burokracisë, ishin thjeshtuar proceset e miratimit. Nga shefi i zyrës K.Miho nuk patëm ndonjë pengesë. Ndërmarrja zbatuese ishte e interesuar të bënte figurë të mirë para "Bllokut" dhe e ndërtoi atë banesë shpejt dhe me cilësi të mirë.

Përveç zgjidhjes së veçantë planimetrike e vëllimore të asaj ndërtese, aty vura dhe një element të papërdorur me parë e që nuk u përdor më gjetiu. Pranë hyrjes parashikova ndërtimin e një baseni të cekët me ujë e një shatrivan. Vaska prej betoni e basenit u zbatua, por pastaj se kush dha urdhër e u mbush me dhé, për ta bërë gjoja lulishte, ku nuk mbiu kurrë ndonjë lule.

Ndërtesa doli e bukur, por nga Ministria dhe Instituti, vinin e iknin të dërguarit e posaçëm, për të gjetur të meta, si rritje sipërfaqesh, rritje kostoje, etj.

Të sigurtë, që këto i ka bërë Petraqi, donin të gjenin të meta të tilla, për të më dhënë një mësim (dmth dënim) të mirë. Dhe Petraqi qeshte me ta, se nuk kishte vënë firmë askund dhe s'mund t'i ngarkonin asnjë faj. Projektin e kishte bërë Enver Myrtezai!

* * *

Pas kësaj ndërtese, bëra projektin urbanistik e arkitektonik të bllokut të banesave para uzinës "Dinamo", ku u përdorën seksione me apartamente tip, si dhe studimin për bllokun e quajtur "8 Marsi", por këtë punë, e vazhdoi Ferri Dishnica, që u bëri shumë saktësime e plotësime dhe ndoqi me përkushtim të veçantë ndërtimin e tyre.

Ferri me moshë ishte afërsisht sa unë dhe u miqësuam shpejt. Inxhinjerinë e kish mbaruar me vonesë, se kishte pasur hallet e kohës. Megjithatë mund të them, se ishte inxhinjer i zoti, me intuitë konstruktive të pagabueshme, me shije të hollë e një bonsens mahnitës.

Rridhte nga një familje bejlerësh të pasur dhe gruan gjithashtu e kishte nga një familje e pasur tiranase, prandaj e kishin lënë nëpër punëra pa rëndësi.

Ndër punët që bëri në Zyrën e Projektimit te Tiranës, ishte dhe projekti i një depoje për patate, që u ndërtua në rrugën Bardhyl. Mirëpo, për ters, një ditë, andej na paskësh kaluar me makinë diktatori, të cilit nuk i paskësh pëlqyer depoja.

Fjalët erdhën shpejt e shpejt në Komitetin Ekzekutiv dhe Ferri filloi të shihej shtrembër. Në atë zyrë ai vetëm me mua mund të fliste hapur. E shihja të shqetësuar, por nuk e pyesja se s'desha t'ia ngacmoja plagët që po i hapnin. Akullin e theu ai. Ishim vetëm në zyrë, kur më tha: Do të iki që këtu. Më kërkuan të bëhesha bashkëpunëtor i sigurimit, por nuk pranova.Nuk bëhem dot spiun. Do të më dërgojnë në Vlorë.

I dhashë rrigën time llogaritëse, librin rusisht me shembuj llogaritjesh konstruktive, nja dy dispenca te mbetura nga Universiteti dhe u ndamë me Ferrin. Atë e çuan me gjithë familje në Fermën e Llakatundit, ku projektoi e ndërtoi stalla moderne për lopët, ura të varura e ç'do gjë që i kërkohej, por kushtet e rënda të jetesës nuk iu përmirësuan. Në vend që ta afronin nga qyteti, e çonin thellë e më thellë.

NE TURQI

Jemi nga fundi i viteve '60. Dhoma e Tregtisë, prej disa vjetësh, merrte pjesë në panairet tregtare ndërkombëtare, si në Paris, Milano, etj. me nga një pavion të vogël, ku ekspozoheshin kryesisht minerale dhe ato çikë prodhime të Shqipërisë së asaj kohe.

Për përgatitjen e këtyre pavioneve, ngarkohej ndonjë arkitekt, i cili edhe shkonte në ato panaire. Në vitin 1967, një shoku im i rinisë së herëshme shkollore në Korçë, i cili punonte në Dhomën e Tregtisë, më tha, se e kishte rregulluar të më jepej mua të projektoja pavionin për panairin e Plovdivit në Bullgari. Pavionin e projektova dhe u kujdesa të përgatitej. Duhet të rikujtoj se pas prishjes së marrdhënieve diplomatike me Bashkimin Sovjetik, vazhduan prishjet e tilla edhe me vendet e tjera të traktatit të Varshavës Një ditë, kur kisha mbaruar përgatitjet e pavionit, që në mëngjez po shkoja në Dhomën e Tregtisë për të marrë porositë e fundit, se po afrohej koha për t'u nisur për në Plovdiv të Bullgarisë. Rrugës pashë njerëz me gazetën "Zëri i Popullit" në dorë, që e lexonin me interes dhe dëgjova njërin që i thoshte shokut të vet me zë të lartë: U prishëm dhe me revizionistët bullgarë. U afrova, pyeta, lexova diçka në gazetë dhe kuptova që nuk mund të shkoja në panairin e Plovdivit.

Vitin tjetër më thanë të modifikoja materialet e pavionit të Plovdivit, për t'i përdorur në panairin e Izmirit, në Turqi. Në fillim të Korrikut 1969, u nisa për tek ai panair. Me mua ishte dhe një përfaqësues i Ministrisë së Tregtisë. Dalja jashtë shtetit atëhere ishte një ngjarje e madhe. Në radhë të parë quhej besim e konsideratë, që vlente për opinionin e përgjithshëm e pastaj i gëzoheshim ndonjë përfitimi të mjerë material. Shkuam me aeroplan Tiranë-Budapest-Stamboll. Një ditë e një natë qëndruam në

Budapest. Për mua, që dilja jashtë shtetit për herë të parë, Budapesti ishte një shkollë e madhe për të vendosur gjërat në balancën e krahasimit.

Si arkitekt shikoja bukuritë mahnitëse urbanistike e arkitektonike të Budapestit. Shihja ato rrugë, atë gjelbërim, ato ndërtesa, ato skulptura, në çdo kryqëzim rrugësh, gjithë ato gjëra mahnitëse dhe më vinte të vija kujën për ato që ndërtonim ne.

Pastaj pashë gjithë ata njerëz të rinj e pleq, të shëndetshëm, të veshur bukur, të pastër, ndërsa unë po shkoja me kostumin e dhëndërisë të kthyer mbrapsht. Shihja gjithë ato vajza të bukura me minifunde, çizme treçerekëshe e çanta lëkure dhe mendoja: sikur të ishin në Shqipëri, këto nuk vinin dot të gjalla në shtëpi.

Hyra në disa dyqane e disa i pashë nga jashtë, në vitrinat dhe vetvetiu bëheshin krahasimet me mjerimin e vendit tim.

Në mbrëmje ishim për darkë tek një punonjës i ambasadës, që nuk e kishte familjen aty. Aty hëngra për herë të parë kofshë pule hungareze, që vite më vonë, në Shqipëri zëvendësuan çdo lloj mishi. Piva nja dy gota raki dhe i lodhur nga gjithe ato përshtypje, më zuri një gjumë i rëndë mbi një dyshek të shtruar në dysheme.

Në mëngjez, më shkojnë sytë tek valixhja ime që s'ishte e mbyllur mirë. Çudi! Unë e pata mbyllur mirë! E hapa. Shoh teshat jo në vendin e tyre. Aty thellë kisha vënë ato çikë para, që na kishin dhënë si dietë 6 dollarë në ditë, 4 prej të cilëve i merrte pagesa e hotelit! I marr, i numëroj Mungonin gjysmat! Kujt t'i thoja? Përveç të zotit të shtëpisë dhe shoqëruesit tim, nuk kishte njeri tjetër. Heshta. Ata, të dy tani kanë vdekur dhe s'dua të trondis eshtrat e tyre me fjalë fyese. Nuk kishin faj. Nuk ka qenë kleptomani e ndonjërit. Ishte varfëria lemeritëse, ku e shpuri shqiptarin ai sistem i mbrapshtë, që e deformoi moralisht njeriun.

Të nesërmen shkuam në Stamboll, ku ndejtëm nja dy ditë e pastaj, natën, me autobus, shkuam në Izmir. 600 km, 11 orë rrugë. Stambolli ishte shkolla e madhe për profesionin tim. Pashë të gjallë arkitekturën bizantine. Pashë madhështoren Shën Sofi, kupolën e saj, që duket sikur varet diku në qiell, kollonat madhështore me ato

kapitele si dantella, pashë gjithë ata mozaikë në katin e sipërm dhe nuk të besohej se këto i kishin bërë duar njerëzish.

Pastaj pashë arkitekturën islamike, të famshmen xhami blu, kupolën, minaretë elegante, veshjen e brendëshme me majolikë të zbukuruara me arabeska, me gjithë ato intonacione të ngjyrës blu si dhe ndërtime të tjera e gjithshka e zhytur në mes të gjelbërimit.

Së fundi, pashë ndërtimet moderne, vila, banesa meapartamente, ndërtesa qeveritare, etj. por gëzimin e kënaqësinë që ndjeja, vinte ma mbyste dallga e dëshpërimit, kur mendoja ç'kisha lënë në vendin tim e ç'do të gjeja kur të kthehesha.

Në Izmir ndejta gati 1 muaj. Nuk ishin të pakta mbresat nga ndërtimet as atje, veçanërisht me banesat moderne në rrugën gjatë bregdetit, hoteli Efes, etj. Pastaj mbresat nga gjithë ato pavione të panairit, për të cilët isha porositur të mos vizitoja pavionin e Izraelit, te Bashkimit Sovjetik dhe të Amerikës.

Në kushte më të mira, mbase do të kisha përfituar më shumë, por m'u desh të jetoja me gjysmën që më mbeti prej asaj diete të mjerë, duke e mbajtur shpirtin me jogurt, me një "kele çorba" të pështirë e ndonjë frutë, që për fat të mirë, ishin të lira.

* * *

Viti 1970. Tashmë kisha gati 4 vjet që punoja në Zyrën e Projektimit të Komitetit Ekzekutiv të Tiranës. Vazhdoja të punoja i pakursyer për çdo gjë që më ngarkohej, por syrit vigjilent të organizatës së partisë, nuk i paskam shpëtuar. Në një karakteristikë të atij viti, sekretari i partisë, Adem Rada, pasi thotë fjalë të mira për punën, e mbyll me këtë shënim:

"...këmbëngul disa herë në mendimet e veta. Tip pak i mbyllur në vetvete. Aktivizohet për punë shoqërore, vetëm kur e ngarkojnë".

KARAKTERISTIKË PUNË PETRAQ KOLEVICA

Profesionalisht i mire,me talent.Punon shume me rendiment.Studjoz,me horizont të gjerë kulturalë.I sjellshëm,korrekt. Kembëngul disa herë në mendimet e veta.Tip pak i mbyllur ne vete vehte. Aktivizohet për punë shoqerore vetëm kur e ngarkojnë.

SEKRETARI ORGANIZATËS BAZE PARTISE
TË SEKTORIT ARËSIM-KULTUR
(Adem Reda)

6/IV/1970.-

HOTELI I TIRANES

Viti 1972. Tashmë isha bërë i njohur si arkitekt me projektet e banesave të ndërtuara në Tiranë e në Korçë, si dhe me shkrimet e herë pas herëshme në shtypin e përditshëm, mbi probleme të arkitekturës. Ishte bërë takimi i parë kombëtar i arkitektëve, ku ndonëse në radhën e dytë, isha në tribunë dhe fola në atë takim. Në këtë kohë, pushteti komunist donte të bënte diçka që të dukej, të bënte përshtypje në popull e në ata pak të huaj që vinin. Si mjet efikas u gjend ndërtimi i hoteleve (gjoja turistike) nëpër qendrat e qyteteve kryesore, ku mund të bëheshin ndërtime disi të larta. Arkitektëve, kjo gjë, u pëlqente shumë, se ishin të etur të projektonin objekte të këtij lloji. Pra, interesat e pushtetit dhe të specialistëve në këtë pikë shkonin paralel. Gjithashtu, linja moderne në arkitekturë, tashmë ishte bërë fakt dhe ndihmonte në projektimin e hoteleve.

Në këtë atmosferë, u dha lajmi i bujshëm, se do të projektohej hoteli i madh në qendër të Tiranës. Vendi i ndërtimit dhe forma relativisht e lartë e objektit, ishte caktuar që më parë nga disa studime urbanistike, të bëra për qendrën. Rëndësi kishte se kush do ta projektonte.

Kur ishte fjala për projektim objektesh të tillë të rëndësishëm, udhëheqja shtetërore e partiake e Ministrisë dhe e Institutit të projektimeve, nën parrullën banale të "luftës kundër individualizmit", e kishte gjetur çelësin e artë. Krijonte një grup pune "me specialistët më të mirë". Edhe për projektimin e hotelit të Tiranës, ky çelës hyri fort në punë. U krijua grupi i punës, ku ishin: V.Pistoli, K.Çomi, M.Pepa, nga Instituti, Petraq Kolevica nga Zyra e Projektimit e Komitetit Ekzekutiv Tiranë, si dhe disa arkitektë, që posa kishin mbaruar fakultetin, por që duhej t'u hapej vendi në Institut, si K.Kolaneci, N.Theodhosi, etj.

Të gjithëve na mblodhi drejtori, S.Angoni dhe na

propozoi që të kishim si kryetar grupi V.Pistolin, që-siç tha ai-është arkitekte me përvojë, anëtare partie...

Askush s'kishte pse ta kundërshtonte. As unë. Por çështja ishte se cili do të qe roli i kryetarit në këtë grup. Këtë nuk e tha njeri, as ajo vetë. Prita, se mos thoshte dikush diçka, por të gjithë heshtën. Atëhere thashë: Rolin e kryetarit në këtë grup, unë e kuptoj sipas fjalës latine, që e cilëson **"Primus inter pares"** (i parë ndërmjet të barabartëve). Nuk u dha përgjigje. U la të kalohej me qeshje të kolegëve, zhurmë lëvizje karrigesh e nënqeshje ironike të ndonjerit. Shpejt, filloi puna.

Para se të hiqja vijën e parë, e kisha vendosur të thoja deri në fund fjalën time, megjithëse e dija që nuk do të më dëgjohej. Kjo ma bënte më të lehtë të mos kërkoja bashkëpunim. Gjithashtu M.Pepa, për arsyet e veta, e dinte që nuk e kishin për zemër, as të rinjtë e as të vjetrit, prandaj dhe ai u përpoq të punonte i pavarur.

K.Çomi dhe bijtë e baballarëve të mëdhenj, u afruan më shumë si fraksion i padukshëm i grupit. Valentina mundohej ta dridhte shkopin e dirigjentit, por orkestra me instrumenta frymorë e atij grupi, ekzekutonte melodítë e parapëlqyera. Për fat të mirë, të gjithë e pranuam mangësinë e madhe që kishim: Ne, që do të projektonim hotelin e madh të Tiranës, nuk kishim parë asnjë hotel turistik të vërtetë. E ngritëm problemin në Drejtori, në Ministri. Nga Komiteti i Partisë ndihmoi F.Paçrami dhe Ministri R.Hanku, keqdashës i deklaruar i arkitektëve, mbeti ngushtë dhe tha: "Mirë, le të venë në Jugosllavi, por unë kaq para kam. Me këto para le të shkojnë. Për sa ditë do t'u sosin, aq le të rrinë".

E pranuam. I mbushëm valixhet tona me sallam, konserva e kaçkavall, na dhanë një mikrobus, prodhim polak, na dhanë ato të shkreta pasaporta për jashtë shtetit dhe u nisëm. Ishim shtatë: Përfaqësuesi i Turizmit, V.Pistoli, F.Stërmasi, K.Çomi, P.Kolevica, R.Agalliu dhe shoferi.Fjetëm një natë në Shkodër dhe të nesërmen ishim në Titograd. Të prirur nga Përfaqësuesi i Turizmit, filluam me hotelet aty. Shihnim me radhë ambientet, merrnim ndonjë përmasë. Unë kisha marrë aparat fotografik dhe fotografoja gjërat që më dukeshin me interes. Pas Titogradit, i ramë përgjatë bregut të

Dalmacisë, nga Dubrovniku, deri ne Rijeka e pastaj në Slloveni (në Lubjanë, ku pamë hotelin "Sllon") e zbritëm poshtë, duke parë hotelet në Zagreb, Beograd, Shkup. Pastaj nuk pati interes tjetër, përveç se natyra e bukur e Shën Naumit, Kisha e Manastiri i atjeshëm, disi Struga dhe kaq. Në dy javë udhëtimi të lodhshëm, pas kësaj fasade, që mund të duket e bukur, hapej kapaku i varfërisë së turpshme. Pesë inxhinjerë, të njohur në vendin e tyre, hanin bukë e djathë, apo bukë e sallam e ndonjë konservë, duke ikur udhëve me makinë, pa guxuar të hynin në ndonjë gjelltore, të hanin makar një supë orizi të ngrohtë. Flinin nëpër hotelet më të lirë të periferive dhe copat e sallamit e të djathit, që ende nuk i kishin ngrënë, i vinin natën jashtë dritares, që t'u rrinin në fresk e të mos u prisheshin.

Në aventurën e trishtuar të të ushqyerit tonë autarqik, nuk do të mund të harroj të gjorën Valentinë: Si ushqim, ndër të tjera, ajo kishte marrë një pulë të zier. Ditët e udhëtimit ishin të nxehta, ca më shumë brenda në makinë dhe pula filloi të binte erë. S'mbetej veçse të hidhej. Pastaj, gjatë rrugës, e gjora Valentinë, mblidhte fara trëndafili të egër, se siç i kishte thënë Cirili, kishin shumë vitamina dhe Valentina bënte me to çaj dhe njomte bukën. Po, Valentina Pistoli, që kishte punuar një çerek shekulli si arkitekte!

Nga dieta mizerabël që na ishte caktuar, mundoheshim të kursenim diçka, për të blerë diçka. Para se të nisesha, gruaja më tha: Nëse të mbetet ndonjë para, shiko mos marrësh ndonjë pardesy, se ke mbetur për turp. Por unë kisha një synim tjetër. Doja një palë këpucka të buta e të bukura për çupën e vogël, që do të çohej më këmbë së shpejti. Kur i bleva ato këpucka, m'u duk se ranë nga qielli. Gjeta dhe një pardesy të lirë. Ma zgjodhi Koçoja.

Kështu u kthyen argonautët shqiptarë, për të hyrë përsëri në labirinthin e jetës shqiptare, ku sundonte Molohu.

Për të mos u harruar ajo ngrënie e bukës me djathë, që na mbajti gjallë, e fotografova gjithë grupin duke ngrënë në një çezmë afër Quksit (në fund të Qafë Thanës\ kur u kthyem në Shqipëri.

* * *

Pas kthimit, puna filloi edhe më intensive. Diskutuam të gjithë e ramë dakort me zgjidhjen planimetrike të katit, të formës, mobilimit e përmasave të dhomave, banjove e ambienteve të tjera. Me vizatimin konkret të tyre u mor kryesisht Valentina.Kur erdhi puna e trajtimit arkitektonik të fasadave, mendimet u ndanë Ndërkohë po formohej një si variant projekti më i preferuar, ku zë i parë dëgjohej K.Kolaneci. Ai këmbëngulte me kryeneçësi që fasada të ishte rretheqark krejtësisht xhamllëk. Kundër isha unë e M.Pepa, kurse K.Çomi, ndonëse i mbështeste, vazhdonte të bënte më vete zgjidhjen planimetrike e vëllimore të dy kateve të parë. Unë, gjithashtu, vazhdoja të punoja variantin tim.

Po afrohej dita e Këshillit Teknik. Atje, e dija se zëri im nuk do të dëgjohej, prandaj idetë e mia dhe kundërshtimet për variantin që po parapëlqehej, i shkrova e ia dorëzova S.Angonit (fotokopjen po e vë pas kësaj faqeje).

Mbledhja e Këshillit Teknik u bë në sallën e Komitetit Ekzekutiv (që u prish). Mori pjesë dhe F.Paçrami. Atë ditë mua më kishte qëlluar radha të bëja roje tek porta e brendëshme e Komitetit Ekzekutiv. Mbledhja e Këshillit Teknik për miratimin e projektit të hotelit, bëhej 10 metra larg vendit, ku unë bëja roje, por asnjëri nga kolegët e as nga Drejtoria, nuk u kujtuan të më thërrisnin brenda, duke më zëvendësuar me dikë, në mënyrë që të ruante portën e Komitetit Ekzekutiv, të mos hynte "armiku".

Projekti u miratua, por unë, anëtari i grupit, refuzova të quhem autor i atij projekti dhe nuk firmosa as një fletë.

Shoku Letraq.

E lexova materialin që më dërguat, ka mjaft mendime të drejta, me të cilat jam d'akord dhe do pëfijem ti ngrë. Mora shënimet që më nevojiten. Po u- kthej materialin.

Të fala dhe faleminderit.

S. Angrei

13. 12. 1972

BIBLIOTEKA E KORÇES

Duhet të ketë qenë fundi i vjeshtës së vitit 1967, kur shkova në Korçë, i thirrur nga Kryetari i Komitetit Ekzekutiv, M.Grabocka. Gjatë qëndrimit të tij si kryetar, u bënë disa gjëra të mira

U ndërtua rruga e gjerë në hyrje të Korçës. Me këtë rast prishi lagjen e quajtur Katavarosh, një pellg varfërie e imoraliteti shekullor, ku në kohën e italianëve ishte dhe një shtëpi publike.

U prish lagjia e Kullës së Hirit, një pellg tjetër i papastërtisë e mjerimit, që shoqja mund t'i gjendej në ndonjë krahinë të humbur të Indisë, prej nga mund të kishin ardhur banorët e atij pellgu.

Veçse, siç dëgjoja atëhere, u tregua tepër aktiv në kohën e aksionit të verbër të prishjes së kishave.

Në atë kohë, me preteksin e zgjerimit të zones industriale u prish Kisha e Shën Marisë, kisha më e vjetër e Korçës. Gjatë heqjes së varrezave, që ishin pranë kësaj Kishe, u prish dhe varri i madh i familjes Turtulli, i ndërtuar sipas shembujve të familjeve fisnike europiane. Të tillë varreze kam parë në "Cimitero monumentale" të Milanos, por në Korçë, ai u prish pa mëshirë.

U prish, rrafsh me tokën, Kisha e Shën Thanasit. U prish pjesërisht e u kthye ne kafene verore Kisha e Shën Ilise, të dyja në maja kodrash dominuese përmbi qytet

U prish Kisha e Shën Triadhës, që nuk i prishte punë askujt, se ishte në një cep jashtë Korçës.

U Prish Kisha e Shën Ilisë e Mborjes, që shihte përmbi Korçë nga maja e vargmalit të Moravës dhe u kthye në "pikë turistike". Kryetari më kishte thirrur të më thoshte se do të prishej Kisha e Shën Gjergjit dhe në vend të saj të ndërtohej nje bibliotekë. Fondet do t'i jepte Ministria e Arsimit Më tha që për ndërtimin e bibliotekës, të shfrytëzoheshin gurët e bardhë si mermer të asaj Kishe Më kërkoi të merrja përsipër bërjen e projektit të bibliotekës. Pas bisedës, i shoqëruar nga përgjegjësi i kulturës, H.S, shkova pashë Kishën e Shën Gjergjit nga jashtë e nga brenda

Prej vitesh, kisha lexuar librin "Memoriet e mia" të

V.Dodanit, e njihja figurën e patriotit Anastas Lakçe, kontributin e tij për çështjen kombëtare e veçanërisht për Korçën. Ishte ky Lakçe, që kishte dhënë milionat për ndërtimin me gurë të gdhëndur të kësaj Kishe, ku sipas testamentit, u varros trupi i tij i balsamosur dhe u vendos busti i bronxtë. Lakçe-siç më thoshte Lasgushi-ishte nga ata miliunarë, që hynte pa trokitur në dhomën e Mbretit të Rumanisë.

Në kishën e Shën Gjergjit Fan Noli, prift, celebroi të parën meshë shqip. Dhe kjo Kishë duhej të prishej!

Me përgjegjësin e kulturës shkuam dhe në Kishën e madhe të Mitropolisë.

O Zot, ç'pashë atje! Nga jashtë kalamajtë qëllonin me gurë xhamat me ngjyra të dyerve anësore. Kambanoret kishin filluar t'i prishnin. Hymë brenda. Në parahyrje, majtas, ku fillonte shkallarja e kambanores, ishte një kambanë. Pranë saj ishte një grumbull librash fetarë e përmbi to copa suvaje, copa tullash, pluhur gëlqereje.Kisha brenda,bosh,si një shkretëtirë rrënqethëse. Isha në ëndërr? Jo! Po prishej Kisha më e madhe e fesë ortodokse në Shqipëri. Pse?

U ktheva përsëri tek vendi, ku ishte grumbulli i librave. Doja të shihja ç'ishin e në mund të shpëtoja diçka. Po si? Ngandonjëherë edhe gënjeshtra duhet! I ndihmuar nga zhurma e poterja e kalamajve, e gënjeva përgjegjësin e kulturës, duke i thënë: Shiko, andej nga fundi, nga aiodhima, kanë hyrë kalamajtë Ai më besoi dhe shkoi me nxitim andej Në mungesë të tij, rrëmbeva dy libra. Hapa kapakun dhe pashë që ishin përkthime të Fan Nolit I futa shpejt nën pulovër, i shtrëngova me rripin e pantallonave, mbërtheva xhaketën e pardesynë dhe kur erdhi përgjegjësi, isha i qetësuar Kjo ishte vjedhje, por për të nuk jam penduar.

Pasi u ndava nga përgjegjësi i kulturës, shkova përsëri nga Kisha e Shën Gjergjit dhe i bëra nga jashtë një fotografi. Mbase është fotografi e fundit e asaj Kishe, që sapo kishin filluar ta prishnin. U prishën dhe varri i A.Lakçes, ku ishte trupi i balsamosur dhe busti i tij. Ku përfunduan vallë?

Në Tiranë, shkova takova Ministrin Thoma Deliana. I thashë që kisha marrë përsipër bërjen e projektit të Bibliotekës së Korçës, që do të ndërtohet në vendin e Kishës. U tregua i pakursyer në premtime. Caktoi një fond të mirë për ndërtimin. Tha që do të jepte edhe valutë për blerje dritare duralumini (për në atë kohë-lluks i madh!), për ndriçuesa, etj. (5)

Me Ministrin Thoma Deliana, isha njohur vite më parë dhe më ishte dukur një bonaccione. Kur ndërtohej shkolla në Korçë, më ndihmoi, duke dhënë fonde shtesë për bërjen e basorelievit në fasadë. Madje njëherë më mori në Pukë, për t'i dhënë ndonjë mendim rreth rregullimit të Shtëpisë së Kulturës atje. Gjatë rrugës së kthimit për në Tiranë, siç m'u duk, më shumë i shtyrë nga instikti i ish mësuesit se sa nga detyra e Ministrit, u kthye të shihte një shkollë fshati. Hymë në klasë. Pamë atë mësues të varfër, të veshur me një xhaketë, që mezi i mbërthehej e që përpiqej diç t'u mësonte atyre nxënësve të dobët, të zbehtë e të veshur me vjetërsira.

Ndërsa dilnim e linim pas gjithë ata "Lula të vocërr", e "Zenela", Ministri Thoma mundohej t'u qeshte atyre fëmijëve, duke u ledhatuar flokët ngjyrë kashtë, sikur donte të zbuste me këtë veprim mërinë e Thomait mësues, që ishte zgjuar i lebetitur brenda tij. Duke nxituar për të hipur në makinë, ai fliste nëpër dhëmbë: "Si i kemi këto shkolla!..."

Me shpresën time të kotë prej idealisti budalla, për të ndihmuar në përmirësimin e ndërtesave shkollore, atëhere i bëra Ministrit Thoma një promemorje

Tani le të kthehemi të vazhdojmë tregimin e dramës së Bibliotekës:

I ngrohur nga premtimet dashamirëse të Ministrit Thoma Deliana dhe nga interesi profesional i projektimit të një objekti të tillë, iu vura punës me ngulm.

Studiova bibliotekat e ndërtuara kohët e fundit në Angli, vendet skandinave, Gjermani e Zvicër dhe them se mundimi s'më shkoi kot.

Në fillim bëra një përpjekje të dështuar. Si vend ndërtimi propozova vendin në kopshtin e Th.Gërmenjit, para bibliotekës së vjetër, pa e prishur atë, por duke e lënë të funksionojë si bibliotekë për fëmijë deri në klasën e 8-të. Për këtë propozim, paraqita një projektide në Korçë. Idea e ndërrimit të vendit të ndërtimit nuk u pranua, sepse duhej justifikuar prishja e Kishës me ndërtimin e bibliotekës në vend të saj.

Të mos e zgjatim, projektin e bëra, u miratua, Zyra e Korçës vazhdoi projektin e konstruksionit dhe filluan punimet e bashkë me të dhe zvarritjet e qëllimta. Ja p.sh. se ç'shkruhet për këtë çështje në 'Zërin e Popullit", datë 10 Gusht 1970:

"Detyrën e projektimit e ka patur Instituti i projektimit, që në Dhjetor të vitit 1968, por në marrveshje me atë, e mori përsipër Zyra e Projektimit e Korçës, e cila e ka kryer projektin e pjesëshëm dhe e ka dhënë pë zbatim ne Dhjetor 1969. Më në fund, në bazë të këtij projekti punimet filluan, por ndodhi e papritura: Ministria e Ndërtimit i pezulloi ato me pretekstin, se projekti duhet të aprovohet nga Këshilli Teknik i saj".

Ministria dhe Instituti nuk patën kundërshtim t'ia linin ta bënte projektin dikush në Zyrën e Projektimit të Korçës, por kur morën vesh se atë e kishte bërë Petraq Kolevica, donin ta shihnin në këshillin Teknik, që ta anullonin. Duke qenë me punë në Zyrën e Tiranës, dmth. disi i pavarur nga Instituti, nuk pranova të shkoj në mbledhjen e Këshillit Teknik, ku do të shihej projekti. Atë e paraqiti Zyra e Korçës dhe-siç më thanë-me mbështetjen e Kryetarit, u miratua dhe punimet vazhduan, por gjithnjë me ngadalësi. Kështu, deri në fillim të vitit 1975, pra, më se 4 vjet, ende s'kishte mbaruar si karabina.

Ndërkohë, më 1974, filloi lufta kundër burokracisë dhe lufta kundër ndikimeve të huaja në letërsi e në artet, sipas orientimeve të famëkeqit Plenium i IV. Nga kjo nuk shpëtoi as arkitektura.

Për ta sqaruar më mirë këtë çështje, duhet të kthehemi nja 3 vjet prapa. Siç e shpjeguam pak më lart, prishja me Bashkimin Sovjetik, solli dhe shkëputjen pa hezitim nga arkitektura butaforike sovjetike Megjithëse pas kësaj, lidhja me Kinën Maoiste, solli vitet më të errëta për kulturën e artin shqiptar, arkitektët vazhduan të punonin në rrugën e nisur drejt arkitekturës moderne.Përmes vështirësish materiale e trysnish ideologjike-psikologjike-burokratike të pabesueshme nga arkitektët e nesërm, ai brez arkitektësh arriti të projektojë ndërtesa që mbajnë tipare të qarta individualitetesh krijues. Rrallë, megjithatë, bëhej ndonjë shkrim mbi arkitekturën, botoheshin foto të objekteve të ndërtuara e kështu personaliteti i arkitektëve po rritej dhe ata radhiteshin përkrah intelektualëve e artistëve të shquar të kohës. Një atmosferë e tillë ndihmoi që në Maj 1971,

të bëhej takimi kombëtar i arkitektëve. Dihet, që kjo u bë me miratimin e udhëheqjes më të lartë partiake, e cila bashkë me fjalët mikluese-lavdëruese, rriste vigjilencën, për ta mbajtur nën kontroll këtë fushë të veprimtarisë intelektuale, që po afirmohej, si dhe për një qëllim meskin që doli fare i qartë tre- katër vjet më vonë.

Në atë takim të arkitektëve, erdhi vete Nexhmia Hoxha, dy sekretarët e Partisë së Tiranës, dy anëtarë të Byrosë të Komitetit Qendror, dy Ministra, Kryetari i Lidhjes së shkrimtarëve dhe artistëve.

Në raportin e mbajtur e veçanërisht në diskutimet, krahas shprehjeve konformiste, pati kritika për shumë aspekte të ndërtimeve, që e bënë inxhinjerin e Byrosë Politike, të mos e nxinte lëkura e vet.

Me qëllimin e qartë të mbajtjes nën kontroll të veprimtarisë së arkitektëve, u bë përpjekja për krijimin e një seksioni të arkitektëve pranë Lidhjes së Shkrimtarëve, që nuk funksionoi, sepse arkitektët nuk e gjenin dot veten në atë organizatë.

Me gjithë kundërshtimet e shfaqura haptas nga udhëheqësit partiakë në takimin e parë të arkitektëve, autoriteti i tyre, si krijues u rrit dhe puna e tyre ecte me guxim në kahun e mëparshëm. Duke përfituar nga kjo atmosferë, bashkë me dy kolegë (S.Mosko e K.Çomi) shkruam artikullin me titull: **"Ndërtim, që e zbukurojmë, apo bukuri, që e ndërtojmë"**, (Zëri i Popullit Mars 1972), ku bëheshin kritika për ndërtimet tek ne dhe hidheshin ide të reja për disa probleme.

Artikulli i tërboi inxhinjerin e Byrosë Politike dhe Ministrin e asaj kohe. Për këtë çështje, në Ministrinë e Ndërtimit, më 18 Korrik 1972 u organizua një mbledhje, ku ai shkrim, u quajt **"artikull i zi"**. As mua, as K.Çomin, nuk na ftuan në atë mbledhje. S.Mosko ishte me shërbim në Jugosllavi. Atëhere, Ministrit R.H. dikush i kishte thënë se unë kisha shkruar nëntëdhjetë përqind të atij artikulli. Këtë ai ma përmëndi në takimin që pata me të në mbrëmjen e 30 Dhjetorit 1974 pikërisht, kur po çohej dallga kundër ndikimeve të huaja dhe unë i u përgjigja: " Sikur ky artikull të mos ishte kritikuar, por të ishte lavdëruar, i njëjti njeri nuk do të kishte vrapuar t'ju sillte sihariqin se sa përqind kisha shkuar unë në të."

Erdhi viti 1974. Shpërtheu sërishmi e ashtuquajtura luftë kundër burokracisë e kundër ndikimeve të huaja. Sipas zakonit të atëhershëm, në fillim dolën fjalët vesh më vesh e pastaj u tha haptas sikur në Korçë paskësh qenë shoku Enver, i cili nuk e paskësh pëlqyer bibliotekën. Ç'është ky mur kështu pa dritare?- paskësh thënë.

Siç e shpjegova më lart, në fillim m'u tha t'i përdorja gurët e bardhë të kishës në ndërtesën e bibliotekës dhe unë parashikova veshjen e murit pa dritare me ata gurë tek të cilët në gjithë sipërfaqen, mendova të gdhëndej një basoreliev. Projekti kështu u bë, por kur u interesova për fatin e gurëve të Kishës, më thanë se kishin përfunduar për bordura trotuaresh. Kështu që faqja e madhe e murit pa dritare mbeti për shumë kohë vetëm mur me tulla të pa suvatuara.

E kisha shpjeguar disa herë privatisht e në takime zyrtare me Ministrin R.H. e të tjerë se ç'doja të bëja në atë faqe muri, që po quhej "bosh". Për ta sqaruar edhe më mirë, bëra fasadën në shkallën 1:50 dhe vizatova një lloj kompozimi të basorelievit të mundshëm dhe ia dorëzova Ministrit, i cili do ta çonte më lart.

Kam shpresë se ajo fletë mund të gjendet ndonjë ditë nëpër arkivat e ish Komitetit Qendror. Megjithatë çështja lihej qëllimisht zvarrë, që të fryhej e të zmadhohej me thashetheme. Sado që pyesja ç'të bëj, askush nuk përgjigjej. Ndërtimi ishte pezulluar.

Gjatë vitit 1974, unë drejtoja punimet në ekspozitën "Shqipëria Sot", që u bë me rastin e 30 vjetorit të çlirimit. Ekspozita u inaugurua pa ndonjë bujë, sepse nga Qeveria e Partia i ishte ngarkuar ta mbikqyrte Abdyl Këllezit, të cilit në atë kohë, po i rrinte sopata përmbi kokë. Do të duhej një film dokumentar i xhiruar nga dy-tre kamera për të dhënë një ide të atij inagurimi dramatiko-qesharak. Megjithatë, do të mundohem ta përshkruaj: Jemi më 27 Nëntor. Ditë e vrënjtur pus e me shi të rëndë që nuk dinte të pushonte. Ekspozita prej disa ditësh ishte gati për inaugurim dhe kish kohë që oficerët e sigurimit kontrollonin gjithkund e nuk linin kënd të hynte pa lejë. Me rastin e festës pritej të vinte një delegacion qeveritar Kinez. Shiu rridhte. Në ekspozitë, çdo pavion kishte nga

një ciceron që do t'u fliste vizitorëve. Të gjithë rrinin në pritje. Në një çast Pupo Shyti, që me sa kuptohej, kishte ardhur në vend të Abdyl Këllezit, i mblodhi të gjithë ciceronët e u tha:" Erdhi delegacioni qeveritar Kinez. Nga aeroporti do të vinë drejt e këtu, por ata dhe udhëheqja janëtë lodhur e të lagur, prandaj ju do të flisni tepër shkurt vetëm kur t'ju pyesin, në mënyrë që të kalojnë shpejt". Nuk vonoi dhe ata erdhën ndërsa shiu vazhdonte të rrihte me furi llamarinat e çatisë së ekspozitës. Filloi vizita. Ciceronët heshtnin. Në krye të grupit ecte Mehmet Shehu. Kaluan kështu disa vitrina dhe arritën tek maketi i madh i Kombinatit Metalurgjik të Elbasanit "ndihmës" më të madhe që na kishte dhënë R.P.e Kinës. Doemos aty dikush duhej të fliste, por ciceroni rrinte si i ngrirë. S'di të flasësh ti?- thirri Mehmeti. Ai i trembur, çoi shkopin tregues por, në vend ta drejtonte atë nga maketi e drejtoi nga Mehmeti i cili, i ra shkopit gjithë inat e shkoi më tej duke thirrur:" Kjo është një bacë që i jepet Byrosë Politike!" Më tutje nuk di se ç'thoshte e se ç'ndodhte, vetëm se shihej që turma e njerëzve të ftuar, e cila nuk ishte e pakët, ecte pas delegacionit si një tufë dhënsh brënda vathës, ku ka hyrë ujku. Rrija në mes të sallës e ndërmjet njerëzve që vërtiteshin të hutuar, kur m'u afrua Manush Myftiu e Xhafer Spahiu e më thanë:" Shko ti shpjegoi delegacionit". Tanithashë që doli flaka në çati, nuk kam ç'të bëj unë. Dhe nuk shkova. Vizita mbaroi ashtu në rrëmujë, delegacioni u largua dhe gjithçka mbaroi si një flluskë. Të nesërmen erdhi Abdyl Këllezi, nuk hyri brenda në ekspozitë, bisedoi pak me Drejtorin, e pyeti se si shkoi vizita. U thanë gjërat larg e larg por gjithçka kuptohej se me ç'ka ndodhi ishte një sajesë për të gjetur një argument fajësimi më tepër për Abdyl Këllezin. Ekspozita u quajt e inauguruar. Të nesërmen gazeta "Z.P." mbushi faqet me lëvdata për partinë e me fotografi dhe kaq. Shumë shpejt atmosfera e pompuar festive u shfry. Kaloi gati një muaj.

Më 24 Dhjetor 1974, në mëngjez, erdhi papritmas e me nxitim në shtëpinë time Drejtori i Ekspozitës, Anastas Gëdeshi e më tha: "Vishu dhe eja shpejt, se vjen "Ay" të shohë ekspozitën e mund të kërkojë ndonjë sqarim". Anastasin e kisha mik, flisnim pa doreza, prandaj e dija se kush ishte "Ay" në fjalorin e Anastasit. U vesha e

shkuam së bashku.

"Ay" erdhi bashkë me Mehmetin e me suitë tjetër, vizitoi ekspozitën dhe afër fundit, Drejtori më prezantoi si arkitektin, që kisha drejtuar punimet e Ekspozitës dhe atje u zhvillua biseda e tij me mua, që në veprën Nr.54, faqe 61-62, është shkruar krejt ndryshe.

Meqenëse kundërshtova Enver Hoxhën në sytë e të gjithëve, gjë që për mentalitetin e atëhershëm ishte një skandal i rrezikshëm, tekstin e bisedës e daktilografova dhe të nesërmen, që në mëngjez, ia dorëzova Ministrit që të mos lija shteg për deformime nga keqdashësit. (6)

Fotokopjen e saj po e vendos në faqen në vazhdim.

Pas disa ditësh, më thirrën në Komitetin Qendror, Sh.Dragoti, i cili me porosi të Haki Toskës, më tërhoqi vërejtjen për qëndrimin tim në atë bisedë. Ai e kishte porositur të më thoshte se sjellja ime ishte mungesë respekti ndaj udhëheqjes. Dhe kjo-vazhdoi-për ty nuk është hera e parë. Edhe kur të kritikoi shoku Mehmet, ti nuk mbajte qëndrim të mirë.

Personalisht nga Shinasiu, e dija që nuk më vinte ndonjë e keqe, por as për ndonjë farë mbrojtje prej tij nuk shpresoja, se e dija që nuk kishte të tilla valenca.

Shumë shpejt, pas kësaj, mua më çuan në Ndërmarrjen 21 Dhjetori për t'u edukuar në gjirin e klasës punëtore.

Ndërkohë vazhdonte të ngrihej stuhia kundër ndikimeve të huaja në arkitekturë. Bombën më të madhe e lëshoi Mehmet Shehu. Siç e di, i gjithë brezi im, në ato vite ishte e ndaluar, që djemtë të mbanin flokë të gjatë, pak përmbi qafë, sepse quhej ndikim i dëmshëm nga mënyra borgjeze e jetesës. Atëhere as ata pak turistë që vinin, nuk i shpëtonin dot berberit të aeroportit, i cili i qethte mirë e mirë e pastaj lejoheshin të hynin në Shqipërinë Socialiste. M.Shehu, ata djem që guxonin t'i mbanin flokët paksa të gjatë, i quante me përbuzje **"qafëleshë"**. Këtë nofkë u vuri ai edhe ndërtesave, që atëhere u quajtën moderniste e me ndikime të huaja. Këto-tha-M.Shehu janë qafëleshët në arkitekturë. Të ndryshohen, të ndreqen!

Me urdhër të posaçëm, u ngarkuan arkitektë të

[illegible] TË NDËRTIMIT
SHOKUT RAHMAN HANKU

Po ju shkruaj bisedën që zhvilloi shoku Enver Hoxha me mua sot, ditën e martë, dt. 24.12.1974 ora 13 mbasi vizitoi Ekspozitën "Shqipëria sot" ku ndenji dy orë.

Kjo bisedë ka rëndesi të madhe për projektin e Bibliotekës së Korçës dhe këtu jam përpjekur t'a riprodhoj sa më [illegible] risht.

Shoku Enver, duke më shtërnguar dorën, filloi kështu:

" Ju lumtë, kini bërë një ekspozitë shumë të bukur.

- Ju jeni Kolevica ?

u përgjegja - Po

Sh. Enver - Juve jeni nga Korça ?

u përgjigja - Po

Sh. Enver - Juve keni ndertuar disa gjëra shumë të bukura në Korçë, por në një m'a kini prishur pak qefin.

u përgjigja - E di shoku Enver ...

Sh. Enver - Me gjithse aty pati influencuar Todi Lubonja.

u përgjigja - Vetëm ay s'ka vend këtu në këtë çështje.

Sh. Enver - Po mua kështu më kanë informuar.

u përgjigja - Gabim ju kanë informuar

Sh. Enver - Të përpiqesh që ay objekt të dalë mirë, ç'po bën ?

u përgjigja - As unë s'di se ç'bëhet. Më kanë futur në një "Çirkole viçios" ku s'po marr vesh asgjë.

Sh. Enver - Si kështu ?

u përgjigja - As njeri s'po më thotë se çduhet bërë me taj.

Sh. Enver - Pasvarësisht nga këto ti si autor duhet t'a mbarosh atë deri në fund duke marrë dhe mendimin e shokëve.

Por sa kam shkruar mbaj përgjegjësi.

ME RESPEKT

ING. (Petraq Kolevica)

tjerë, që i bënë shtesa e ndryshime Kinoteatrit të Fierit (të arkitekt S.Mosko), shtëpisë së kulturës në Sarandë (të arkitekt K.Çomi). Dhëndri i diktatorit, si arkitekt me liçencë ideologjike, bëri projektin me ndryshimet që duheshin bërë në Bibliotekën e Korçës, por unë protestova dhe nuk lejova të zbatohej projekti i tij. Ndryshimet që kërkoheshin, hapje dritaresh në murin e lënë për basoreliev, etj. i bëra vetë.

Për t'i dënuar publikisht këto ndikime të huaja, aty nga fillimi i verës së vitit 1975, u organizua mbledhje me të gjithë arkitektët, inxhinjerët projektues, etj. në sallën e Pallatit të Kulturës në Tiranë. Në presidium ishin S.Koleka, Ministri R.Hanku, etj.

Në bangon e të akuzuarve, isha unë për Bibliotekën. M.Velo për banesën pranë MAPO-s dhe godinën e ATSH, M.Bego për godinën e Institutit të Lartë të Arteve dhe S.Mosko e K.Çomi, për objektet që përmenda më lart.

Për këtë mbledhje, isha përgatitur seriozisht në mbrojtje të punës sime shumëvjeçare dhe kisha shkruar mbi 30 faqe të daktilografuara. Kur fola, pasi lexova disa faqe, më ndërprenë, se s'bëja asnjë farë autokritike. Ato fletë, që lexova, erdhi m'i mori inxhinjeri N.K., që e dinim se kishte lidhje me sigurimin. Kush e di, mbase janë diku në ndonjë dosjen time.

Pas meje foli M.Velo. Edhe atë e ndërprenë e nuk e lane të fliste. M.Bego ishte dërguar në Fier dhe në këtë mbledhje mungoi.

Në fund, foli Koleka e Ministri, me sulme e sharje të paimagjinueshme [7].

Për të kuptuar diçka nga atmosfera e rëndë e mbledhjes ne Pallatin e Kulturës, duhet të citoj pak nga shkrimet e asaj kohe. Ja, p.sh. se ç'shkruan Shinasi Dragoti në revistën "Rruga e Partisë" Nr.12/74:

"Në projektet tona, shohim ndikimet pa vend të arkitekturës moderniste. Kinoteatri, në Fier, është kritikuar me të drejtë për formën e tij aspak tërheqëse, por të lë përshtypjen e një vepre të ngjashme me kishën, si ato që ndërtohen në vendet kapitaliste dhe që reklamohen nga propaganda borgjezo-revizioniste. Por ka dhe prirje të tjera të huaja, që janë

shfaqur në disa ndërtesa, ku shohim faqe muri pa asnjë dritare. (është fjala për Bibliotekën e Korçës. Shënimi im P.K.) **Këtu kemi të bëjmë me konceptime gjoja estetike, të cilat e kanë burimin në ndikime të dëmshme të arkitekturës moderniste".**

Pas kësaj mbledhje,nga Tirana më çuan në ndërtimet e fabrikës në Valias e pak më vonë erdhi transferimi për në Fierzë,që nuk u zbatua,se më ngarkuan me projektin e Muzeut Historik Kombëtar. Por edhe në këtë kohë, isha i emëruar në Kombinatin e Materialeve të Ndërtimit, në Uzinën e 2000 Apartamenteve. **Profesioni im si projektues kishte marrë fund!**

M.Velos, iu sajuan motive të tjera e përfundoi në burg. M.Bego. ishte dërguar në Ndër. Komunale të Fierit.

Në mbledhjen e Pallatit të Kulturës, unë bashkë me gruan e i "shoqëruar" nga një punëtor i kantjerit, rrinim në rreshtin e fundit të asaj salle dhe dëgjoja gojëkyçur poshtërsitë që villnin të poshtrit.

Ç'u pat shkruar dikur nëpër dosjet e zyrave portëmbyllura të kuadrit, po i lexojmë sot. Gruas sime, pas njëzetë e ca vjet pune, karakteristika e parë i bëhet më 1976, pikërisht kur unë dënohesha për ndikimet e huaja. Tek ajo karakteristikë, ku thuhen fjalët më të mira për punën e saj, shënohet se *"Ka jashtë shtetit nga të afërmit e saj, njerëz të nënës në Gjermani, dajat e tezen në Amerikë, Çekosllovaki dhe Austri, ku ka lidhje ma ata të Çekisë dhe të Amerikës"* Por nuk shënonte se e vetmja *"lidhje"* ishin kartolinat që vinin për urimin e Krishtlindjeve

Në fund shënimi mbyllet me frazën më hipokrite,

"...U vendos të qarkullojë, meqenëse ka një kohë të gjatë në këtë Institut".

Megjithatë, gruaja nuk qarkulloi, sepse Institutit i duheshin hamejtë e mirë për të mbajtur peshat që linin pezull disa anëtarë partie Pas këtyre masave shkatërruese, jehona e kritikave dhe e dënimit të ndikimeve të huaja, duhej të vazhdonin. Në Korçë u organizuan mbledhje, gjoja për karakterin kombëtar të arkitekturës, por çështja ishte dënimi i ndikimeve të huaja në arkitekturë.

Mbledhja u bë në Korçë, sepse atje ishte Biblioteka e dënuar U gjetën njerëz si arkitekti V.B., i cili duke

diskutuar-siç tha ai-për ndikimet e huaja që kishin depërtuar para Pleniumit IV edhe në arkitekturë, shtoi:

"Kështu na ndodhi me Bibliotekën e Korçës, e cila jo vetëm nuk ka asgjë kombëtare në formën e saj, por edhe stonon në planin e përgjithshëm të ndërtimeve të qytetit". (Shih "DRITA", 14 Mars 1976). Ndërsa bashkautori i "artikullit të zi", i ndieri Sokrat Mosko, në shkrimin e tij autokritik thoshte:

" Tendenca të gabuara u dukën në punën e disa arkitektëve me tendencë lluksi e gjigandomanie, përpjekje për lavdi personale, me faqe muresh të plota të ndikuara nga shija e shëmtuar e huaj si Biblioteka e Korçës, Agjensia Ajrore..." (Drita, 4 prill 1976)

Bishti i jehonës së dënimit të ndikimeve të huaja në arkitekturë, zgjatet gjer nga fundi i vitit 1977, kur A.Uçi shkruan.

"Në diskutimet e bëra vitet e fundit, është pranuar njëzëri nga opinioni ynë i shëndoshë artistik, se format e Kinoteatrit të Fierit, Të Bibliotekës së Korçës, të godinës së ATSH, kanë qenë shprehje e ndikimit të formalizmit... Ato janë krijuar në kundërshtim me shijet e shëndosha të shoqërisë sonë socialiste". (Shih "NENTORI" 8/77, Faqe 45)

Krijuesit, që e jetuan atë kohë të mbrapshtë, e dinë mirë se ç'donte të thonte atëhere, të të vihej etiketa, se "*kishe krijuar në kundërshtim me shijet e shëndosha të shoqërisë socialiste*".

Për ta mbyllur këtë panoramë plagëshumë, është e nevojshme të theksoj që lufta kundër ndikimeve të huaja në arkitekturë, e cila drejtohej me kujdes të madh nga lart, shumë shpejt u kuptua se, përveç arsyeve ideologjike, kishte dhe një qëllim të rëndësishëm praktik: T'u hiqte nga rruga konkurentët e aftë e të njohur dhe t'u siguronte vendet drejtuese arkitektëve me prejardhje princërore nga dinastia bllokiste.

Sapo zunë ata vendet e dëshiruara në Institut dhe filluan të merreshin me projektim u shua menjëherë "lufta" kundër ndikimeve të huaja në arkitekturë (18)

Këtë atmosferë të favorshme e shfrytëzuan me mënçuri disa arkitektë të rinj e të talentuar në Tiranë e në rrethe, të cilët mundën të projektojnë objekte me zgjidhje

origjinale, ndonëse pa përkrahje e me mungesa të mëdha materiale.

AGJENSIA AJRORE KINEZE NE TIRANE

Në vitin 1973, përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës e Projektimit të Tiranës, ishte Sokrat Mosko, por në këtë kohë, ai merrej me ndërtimin e shtëpisë së E.Hoxhës kurse me drejtimin e punëve të Zyrës, përgjithësisht merresha unë, duke mbajtur lidhje me të.

Që në vitin 1972, na erdhën dy detyra projektimi: njëra për ndërtim apartamentesh për pedagogët e huaj, që gjoja do të vinin të jepnin leksione në Universitetin tonë dhe tjetra për ndërtimin e Agjensisë Ajrore Kineze që kërkonte gjithashtu apartamente banimi për pilotët e linjës Tiranë-Pekin-Tiranë dhe disa zyra, etj

Të dy objektet kërkoheshin të ndërtoheshin diku në qendër të qytetit. Për të dy objektet, e projektova unë anën arkitektonike, duke i shkrirë të dukeshin si një objekt i vetëm, pavarësisht se funksiononin të veçuar.

Me paramendim dashakeq ministri, Rrahman Hanku, kërkoi t'a shihte projekt idenë që kisha bërë dhe më dha urdhër të përdorja patjetër vetëm dyer e dritare tip, vaskat e dusheve t'i bëja prej çimentoje dhe suvatimin e jashtëm, të thjeshtë.

Kushdo e kuptonte se ky urdhër jepej që godina të dilte sa me e varfër në materiale e si pasojë, mundësisht sa më e shëmtuar

Gjatë vitit 1973, u ndërtua një pjesë e mirë e karabinasë e ndërtimet vazhduan deri më 1975

Pas bisedës që pata me E.Hoxhën dhe rritjes se luftës kundër ndikimeve të huaja, më dërguan ne Ndërmarrjen 21 Dhjetori e prej atje më çuan të përfundoja ndërtimin e godinës së Agjensisë Ajrore Kineze, që e kisha projektuar.

Për disa muaj ndoqa punimet e zbatimit dhe godina përfundoi. Kishte mbetur vetëm lyerja nga jashtë Për t'iu përshtatur disi destinacionit të ndërtesës, qe kishte të bënte me fluturime aeroplanesh në qiell.

ndërtesën e leva me ngjyrë të bardhë e disa pjesë me blu të çelur (bojë qielli). Ky ishte një kombinim ngjyrash të papërdorura më parë tek ne.

Mirëpo, pas nja dy ditësh, aty para, paskësh kaluar S.Koleka me *Bencin* e vet, e paska parë ndërtesën të lyer me ato ngjyra e paskësh thënë: Ç'është kështu?! Mu në qendër të kryeqytetit qenka bërë flamuri i Greqisë! I dashur lexues, mos qesh.

Të nesërmen erdhi Ministri R Hanku bashkë me Drejtorin e Kantjerit, më thirri,e më tha:

-Ç'është kjo që ke bërë këtu?-dhe urdhëroi: **"Të lyhet me të verdhë, siç janë të tjerat. Mateni dëmin dhe t'i paguajë ky!".**

Hipi në *Fiatin* e tij të kuq dhe iku.

Për ndonjë, që nuk beson, po vë në vazhdim fotokopjen e shkresës dhe të faturës, ku shënohet që kam paguar atëhere rreth 600 leke të reja, por këtë ia di për nder normistes Drita Sara, e cila e kuptonte budallallëkun që po bëhej, i vinte keq për mua dhe vuri më pak se gjysmën e vlerës reale të harxhimeve.

Për këtë çështje, u bë mbledhje e posaçme në Ndërmarrje, ku mua nuk më ftuan, por atje u tha se unë kisha bërë flamurin e Greqisë në qendër të kryeqytetit, pra një nga ndikimet e huaja më të rënda rëndonte mbi mua.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPERISE
NDERMARJA NDERTIMIT 21 DHJETORI
KANTIERI NR.2

Tirane 9/8/75

Nr Prot. 191.

URDHER ÇDEMTIM

SH. PETRAQ KOLOVIÇA

K E T U

Ne mbeshtetje te proçes verbalit dt.17/7/74 mbi punen e kryer per lyrjen e ballkoneve me hidromat ne objektin Agjensisa Ajrore, pune e cila eshte anulluar, duke shkaktuar njo dem ne material e puntori lek 568 .

URDHEROJ

Ne baze te kodit te pune te çdemtohet arka shtetit lek 568.- duke ju bere ne ngarkim kjo vlefte.

D R E J T O R I
(Adem Kertaku)

Proçes - Verbal

I mbaytur me dt. 19/VII/45 ne objektin Ayzensja Agrovi, ne prezencë te Kr/Llogaritarë Kautient Veive Wullar, Referentes nosimave, L. Dila Sara dhe Inzenient objektit Petraq Kolovica dhe Brigadier Ahmet Canjar, per punen e kujer ne vele objektet per lyerjen e ballkonevë me Hidromat, punë e cila anullohet -

1.- Lyerje taream me ballkonet me dy duar hidromat: $1.3 \times 5 \times 7 = 45^{50}$

2/ Lyerje ball ballkonesh me dy duar hidromat:

$08 \times 5 \times 6 = 24$

$03 \times 5 \times 1 = 1^{50}$

m^2 71.

Kjo sasi (m^2 71) kaps nje vlefte te $71 \times 4 = 284$

$71 \times 4 = 284$

568

Proçes Verbal mbahet ne dy kopje, nje dergohet Kautient dhe tjetre mbahet ne objekte -

Ref. Hidromat
(Dila Sara)

Kr/Llogaritar
(Veive Wullar)

Inzenient Petraq Kolovica

Brig. Ahmet Canjar

BANESA PER DIPLOMATET E HUAJ NE TIRANE

Në atmosferën e rëndë të krijuar nga i ashtu-quajturi "artikull i zi" dhe famëkeqi Plenium i IV, projektova dhe u ndërtua kjo banesë, që kishte disa kërkesa komoditeti për apartamentet, të cilat në atë kohë quheshin tepërime.Meqë kjo banesë ndërtohej për diplomatët e huaj i kushtova vëmëndje zgjidhjes funksionale të apartamentit, dhe trajtimit arkitektonik nga jashtë.

Në mënyrë, që apartamentet të kishin mundësi të shihnin nga jugu, të gjithë fasadës e cila ishte dety-rimisht e orientuar nga perëndimi, i krijova thyerje të njëpasnjëshme dhe kështu ballkonet e kishin diellin të siguruar dhe horizontin të hapur, ndërsa fasada merrte plasticitet me dritë e hije të harmonishme.

Mirëpo inxhinieri i Byrosë Politike, që s'mund të duronte të bulëzonte asgjë e re në arkitekturë, shkoi e pa ndërtesën kur ishte ende karabina e sipas zakonit të tij, klithi: Ç'është kjo godinë në formë sharre? Ku e keni marrë këtë, në Honolulu?

Nejse. Me ndërhyrjen e Zyrës së Shërbimit Diplomatik, që e kishte porositur, ndërtesa mbaroi siç ishte projektuar. Mirëpo kusuret e mia nuk mbaruan Ndërtesa ishte afër fundit, por Ndërmarrja Zbatuese "21 Dhjetori" thoshte se nuk i dilte fondi i parashikuar Çështja shkoi deri në Arbitrazhin e Lartë Shtetëror.

Për një gabim banal, preventivuesi kishte harruar të shtonte koston e soletës së një kati Si pasojë, për këtë gabim të preventuesit, nga Arbitrazhi i Lartë mua m'u dha një vërejtje e rëndë me paralajmërim pushimi nga puna Këtë shpërblim kam marrë për zgjidhjen arkitektonike të asaj godine për të cilën shpesh herë kam dëgjuar fjalë të mira nga kolegë e njerëz të panjohur, veçse në atë kohë "godina në formë sharre" u përmend për keq edhe në mbledhjen e përgjithëshme "kundër ndikimeve të huaja" në Pallatin e Kulturës në Tiranë. Por si çdo gjë, që kalon në ekstrem bëhet qesharake, ashtu dhe shprehja "godina në formë sharre", përdorej enkas nga kolegët dashamirës nëpër bisedat, për ta përtallur atë që e tha

Për kohën që ka qënë në Komitetin Ekzekutiv KP të Rrethit është kritikuar për disa projekte të tij lidhur me ndikimet e tyre nga format e arkitekturës së huaj.

Kritikat e bëra i kanë vlejtur dhe në punën e tij ka përmirësime të dukëshme.

Ministria e Ndertimit propozon që të emërohet në punë në kombinatin "Josif Pashko".

Drejtoria e NN "21 Dhjetori" nuk është dakort.

Seksioni i Ndertim- Komunikacionit due sy i kuadrit jan.ëdime propozimin e Ministrine e Ndertimit.

PERGJEGJESI SEKSIONIT KUADRIT
(Vangjel Gjeçi)

ZEVENDESKRYETARI
(Omer Haxhiu)



6/4/78 Coronarospazm 3dP Dispiro Oirko
2PPT

[illegible] Pathologisch [illegible]
Insuff. Coronarium acuta
[illegible]
Dr. S. Oirko 2050

25/4/78 KMC [illegible] $L_1 + L_2$
Coronarosclerosis. Insuff. coron. / ch.
Stenocardi [illegible] [illegible]
10/ [illegible] / [illegible] [illegible] Dr. S. Oirko N.

Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë Forma 70

POLIKLINIKA 197/

Nr. Regjistrit 2430 23/10/79

K.M. L E PATH. L 1 2 TIRANE

RAPORT MJEKO-LIGJOR

U vizitua nga Komisioni Mediko-Ligjor i Poliklinikës

Shoku Petrag Kalevica dhe u konstatua

se vuan nga Coronarosklerosis isuj. coronare brana

Coronarospasna te perseritura S.Z. pasz. otikatomia

A.S Prandaj komisioni vendosi:

I afte per pune ri Inah. pa sforca

te renda fizike pa cije te gjatu ne lente

Antar	Kryetar i komisionit	Antar
Mjeku	Mjeku	Mjeku
Shenoter Demi	Rasan	Sonia Sulejmani

Shqetësimet e rënda nervore nga gjithë sa ndodhën dhe lodhja e vazhdueshme fizike, sollën pasojën e pashmangshme:

Kriza të vazhdueshme të zemrës.

Në kartelën shëndetësore personale dhe në dosjen e kudrit, ndodhen gjithë ato raporte mjeksore, që japin diagnozën:

Coronarosclerosis, Insuffic. coronare, Stenocardi.

Dhe së fundi, komisioni mjeko-ligjor, më 23.10.1979, jep rekomandimin kategorik:

I aftë për punë si inxhinjer, pa sforco të rënda fizike, pa ecje të gjata me këmbë.

Pikërisht, në këtë gjendje, Ministria e Ndërtimit e gjeti të arsyeshme të më largonte nga Ndërmarrja 21 Dhjetori e më dërgoi në Kombinatin e Materialeve të Ndërtimit (Uzina e 2000 apartamenteve), ku isha i detyruar të bëja patjetër të kundërtën e asaj që rekomandonin mjekët.

REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPËRISË
M.N."21 DHJETORI"
DEGA KUADRIT
Nr 2238 Prot

Tiranë, më 17/10 1979

Shokut Petraq Kolovica

K Ë T U

Me urdhër të Ministrisë Ndërtimit Nr.3436 datë 11.9.1979 transferoheni në Kombinatin "Josif Pashko". Bëni dorëzimet dhe para gitunë nu detyrë brenda datës 12.10.1979.

D R E J T O R I
(Xhemal Simixhiu)

REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPËRISË
NDERMARRJA NDERTIMIT 21 DHJETORI
TIRANË

Lënda: Emërim kuadri

KOMBINATIT "JOSIF PASHKO"

T I R A N Ë

Me vendim të Komitetit Ekzekutiv KP të Rrethit Nr. 333 datë 15.11.1979 mbështetur edhe në propozimin e Ministrisë së Ndertimit, Petraq Kolovica, inxhinjer ndertimi, deri tani në N.N. "21 Dhjetori", emërohet me punë në atë Kombinat.

Bashkëngjitur ju dergojmë dokumentat e tij si kuadër.

DERGJEGJESI SEKSIONIT KUADRIT
(Vangjel Gjeçi)

Nuk do t'i harroj ato gra, që ngjitnin kova me llaç deri në katin e shtatë në ndërtesën e Agjensisë Ajrore: Nuk do ta harroj një nuse të re me dy fëmijë, që nuk vinte dot në orën 7 pa një çerek në mëngjes në mbledhjen e brigadës dhe duhej të duronte për ditë klithmat e brigadierit për atë vonesë, ndërsa në ballë e përmbi buzë i ndrisnin sumbulla të mëdha djerse nga nxitimi për të arritur në orar e të punonte gjithë ditën që të merrte 160 lekë të qelbura.

Brezat që do të vijnë e do të shohin ndërtimet e kohës sonë, nuk do të mund ta besojnë se ato janë bërë nga punëtorë që hanin bukë si baltë, dyzetë lekëshe, me domate apo hallvë të kuqe pesë lekëshe. Ndërsa i shihja kur uleshin të hanin drekën dhe hapnin ato qeset e tyre të mjera, më bëhej më i qartë mjerimi i jetës së një populli të tërë. Shihja ato gra të urta teknike ndërtimi, që binin copë gjithë ditën duke u ngjitur e zbritur nëpër skela e duke hyrë nëpër baltrat e themeleve, ndërsa në mbrëmje në mbledhjen e kantierit, dëgjonin sharjet e drejtorit për mos realizimin e planit.

Në Valias pashë barakat shkatarraqe, ku kishin jetuar të burgosurit, që kishin bërë ato ndërtime. Pashë minatorët e zbrita thellë në minierë, prej nga nxirrej më shumë baltë se qymyr. Aty njoha dhe një topograf me biografi të keqe, që hynte në minierë herët në mëngjes e dilte vonë në mbrëmje.

Jam më mirë këtu poshtë si urithi-më tha një ditë-se, po të dal sipër kush e di se kush më sheh e kush e di se ç'avaz mund të hapë.

Nga gjithë këto mbresa të forta të përditshme, nuk kishte se si të mos lindnin tek unë poezitë, si "Tekniket e ndërtimit", "Të burgosurit","Vajzat që shtrojnë pllaka,etj. Përmes atij mjerimi të përgjithshëm, populli i vuajtur e nxirrte dufin e vet me thumba të mprehur hollë. Sipas një ligji që nuk zbatohej, punëtorëve që punonin në kanalizimet e ujrave të zeza, duhej t'u jepej qumësht falas. Një ditë punëtorët po më ankoheshin mua se nuk kishin marrë qumësht, por brigadier Mazllëmi u tha: Mos u mërzisni, se dje doli ligji që juve evgjitëve të kanaleve, do t'u japin qumësht dallëndyshe.

Në Valias punonin dhe mjaft fshatarë nga fshatrat

përreth. Ishte koha, kur fshatarëve nuk u lejohej të mbanin as pula dhe ata u detyruan t'i thernin. Një ditë, ndërsa u ulën të hanin drekën, njëri nga fshatarët-punëtorë, e lëshoi një romuz të rëndë: Rroftë partia-tha-që na bëri të hamë pula, se ne budallenjtë i rritnim pulat e i shisnim në qytet, nuk dinim ti hanim vetë. Ore, qejf që kemi bërë këto ditë! U shembëm duke ngrënë pula. Rroftë Partia!

Të tilla thumba, dëgjoje gjithandej, nëpër bisedat dhe ata bënin të shpoheshin e t'u dilte era e qelbët kacekëve ideologjikë e propagandistikë të kohës.

Në ato vite pune të rëndë, që i kalova atje me punëtorët, unë me të vërtetë u edukova, veçse jo në drejtimin në të cilin dëshëronin idiotët, që më dërguan.

PUNA PER PROJEKTIMIN E MUZEUT HISTORIK KOMBETAR

Ndërsa vazhdoja punën në Valias, më erdhi urdhëri i transferimit për në Hidrocentralin e Fierzës. Mora paradhënien dhe pas dy-tre ditësh do të nisesha. Besoj, se ishte fundi i vitit 1977. Pikërisht, në ato ditë, më lajmëruan të mos nisesha, sepse duhej të punoja për projektimin e Muzeut Historik Kombëtar.

Siç ishte zakon në kësi rastesh formohej një grup pune me disa specialistë, me një kryetar të emëruar nga lart. Kësaj radhe kryetar ishte S.Mosko. Për t'i dhënë rëndësi çështjes, thuhej se interesohej vetë "i madhi", i cili paskësh thënë që ndërtesa e Muzeut të bëhet në tri pjesë: Periudha para luftës, Lufta Nacional Çlirimtare, Ndërtimi i Socializmit. Sipas këtij orientimi, u punua për nja dy-tre muaj, natyrisht në skicë ide. Mirëpo një ditë, u tha se "i madhi" paska thënë që Muzeu të jetë një i tërë, jo i ndarë "sepse edhe revolucioni i popullit shqiptar është një i tërë, jo pjesë pjesë!". Na u dërgua dhe një platformë ideore e shkruar, se si duhej të trajtohej ky objekt. Madje, njëherë na thanë që gjithë ndërtesa të ketë një farë lloj trajtimi apo dekori rreth e qark, që të duket si gjerdan me

fishekë. Zaten, ai rryp dekori që është sot rreth e qark ndërtesës së Muzeut, është mbeturinë e asaj ideje të gjerdanit me fishekë.

U fol për arkitekturë kombëtare, pastaj për arkitekturë bashkëkohore, etj. I përmënda këto, për të treguar atmosferën e turbullt, ku duhej punuar e krijuar. Në fillim grupi kishte mjaft vetë, por dalëngadalë u larguan dhe mbetëm katër arkitektë. Si zakonisht grupi nuk formonte dot një unitet mendimi. Bëheshin diskutime, por pastaj secili qëndronte në të tijën dhe në fund u paraqitën tre variante.

Gjithmonë e kam pasur të pamundur bashkpunimin në krijimtarinë arkitektonike. Kjo për fajin tim, jo të të tjerëve,sepse idetë e mia nuk i shartoja dot me ato të të tjerëve. Në rastin e punës për projektin e Muzeut, këtë e pata më të theksuar për disa arsye:

Kthehesha përsëri në tufë si bishë e plagosur, me plagë ende të përgjakura, por që do të vrapojë për t'i prirë tufës.

Kthehesha pas afro katër vjetësh përsëri në projektim dhe desha të tregoja me kryeneçësi, se ai dëbim, nuk më kish dëmtuar.

Qysh në fillim kisha idenë e bërjes së një projekti me arkitekturë patjetër moderne, por të shkrirë në të motive të arkitekturës kombëtare. Me këtë ide bëra variantin e fundit që u paraqit në një Këshill Teknik të zgjeruar, ku nuk u miratua. Diskutimet e mia këmbëngulëse për shumë çështje arkitektonike të objektit nuk u pritën mirë nga kolegët e grupit. Madje, nuk di kush, hodhi dyshimin që unë këtë e bëja sepse doja të isha, apo të quhesha, autori kryesor i projektit. Për këtë çështje u bë një mbledhje e grupit me sekretaren e partisë të Institutit, G.H. ku më tërhoqën vërejtje për atë tendencë që kisha shfaqur. Pas kësaj ndodhie, më shumë i dëshpëruar se i inatosur, gjatë hartimit të projektzbatimit, u mora vetëm me çështje teknike të tij. Pas mbarimit të projektit më dërguan përsëri në folenë time të mëparshme, në Uzinën e 2000 apartamenteve.

Ende pa mbaruar punimet e ndërtimit të godinës, filloi puna e projektimit dhe e paisjeve të sallave nga brenda. Më thirrën përsëri të punoja. Më caktuan të

merresha me sallat e periudhës së ndërtimit të socializmit, meqënëse kisha përvojë nga dy ekspozitat që kisha bërë më parë ("Shqipëria 1971" dhe "Shqipëria sot").

8 Nëntor 1981. Do të bëhej inaugurimi i Muzeut Historik Kombëtar. Doemos pritej të vinte "i madhi". Në këto raste dihej se "udhëheqja" d.m.th. "i madhi" përshëndetej dhe u shtërngonte dorën projektuesve. Deri ditën e fundit mua nuk më dhanë ftesë për në ceremoninë e përurimit. Më 8 Nëntor isha në shtëpi. Radioja transmetonte muzikë dhe fliste për inaugurimin e pritshëm të Muzeut. Gruaja ime me të drejtë ishte e shqetësuar që nuk më dhanë ftesë, d.m.th. se vazhdonte të'isha i padëshëruar, të isha ende me njollën e ndikimeve të huaja, ndërsa unë e quaja fat, sepse nuk doja t'i jepja dorën E.Hoxhës e M.Shehut.

Në këtë kohë, trokiti dera. E hapa Ishte miku im piktori dekorator A.Kote, që kishim punuar bashkë në sallat e Muzeut. Të solla ftesën - më tha. Dikush ta kishte lënë mbi tryezë. E pashë dhe erdha me vrap.

Gruaja u gëzua. Vishu e shko shpejt-më thoshte, po unë nguroja. Nuk vete, nuk vete-i thoja. Aman, shko-vazhdonte ajo. Ç'do të thonë bota kur të shohin se vetëm ti mungon? Veten e more në qafë. Tani do të marrësh më qafë edhe çupat. Do t'i lësh pa shkollë.

U vesha me përtesë dhe ika ta qetësoja atë, por isha i vendosur të mos shkoja. Me këtë mëndje arrita tek Pallati i Kulturës. Prej atje pashë që erdhën makinat e "udhëheqjes". Ndërsa ata hynin brenda, u afrova tek turma para Muzeut. Duartrokitjet e turmës pushuan, porta u mbyll. U qetësova dhe dalngadalë, dola në rreshtat e parë. Aty takoja plot njerëz që më njihnin. "pse këtu? Projektuesit hynë"- më thoshin. E po ja, ma sollën ftesën me vonesë dhe nuk arrita-përgjigjesha. Për fatin tim të mirë, kjo gënjeshtër u bë e besueshme.

Muzeu mbaroi, u inaugurua dhe unë u ktheva përsëri në strofkën e vjetër, në Uzinën e 2000 apartamenteve, që tashmë varej nga Ndërmarrja e Ndërtimit të Banesave. Kisha dhe një si titull-Kryetar i Degës Teknike - për të pasur ca punë më shumë gjatë gjithë ditës dhe mbledhje të gjata çdo natë.

Kështu kaluan tre vjet.

Viti 1984. Më lajmëruan të shkoja në një mbledhje, ku do të jepeshin çmimet e Republikës. Ç' ishte kjo? Asgjë. Taktika e njohur e diktaturës dhe e mashës së saj, Partisë së Punës që mbasi i shkatërronte njerëzit, u mbyllte gojën e i bënte të thoshin: Falemderit.

Më dhanë dhe mua minimumin e mundshëm, çmimin e Republikës të Klasit të tretë. Për mua kjo ishte njëlloj sikur ma jepnin pas vdekjes. Më jepej ky çmim për merita si projektues, ndërsa unë, si projektues, kisha vdekur, sepse më bënë të vdisja vite më parë.

Dhënia e çmimit ishte hipokrizi dhe poshtërsi. Me këtë veprim, ata që më nxorrën si të pandehur përpara 300 inxhinierëve e arkitektëve të Shqipërisë, i jepnin vetes të drejtën të thoshin: Ja! Partia i dha dorën. Ai bëri gabime të rënda, por Partia përsëri u tregua zemërgjerë. Rroftë Partia!

Çmimi i Republikës më jepej për merita si projektues i njerit prej objekteve social kulturorë më të rëndësishëm të ndërtuar deri atëhere, por për mua, "Laureatin e Çmimit të Republikës" nuk u gjend dot më një copkë vend për të punuar si projektues i ndonjë koteci pulash.

Dyert e Institutit të Projektimeve ishin mbyllur përfundimisht për mua. Dhe kjo nuk ishte pak.

Duke folur me vete atëherë dhe sot shpesh e përsëris se nuk do të skuqem as përpara të tjerëve, as përpara ndërgjegjes sime po të them që punës së projektimit i pata kushtuar gjithë aftësitë e mia, gjithë dijenitë, gjithë kohën time, gjithë rininë time, madje guxoj të them edhe shëndetin tim. Mundet që dikush t'i ketë kushtuar më tepër. Unë s'kisha ç't'i jepja më shumë se zemrën...

LEHJET E ZAGAREVE

Fundi i vitit 90 e fillimi i 91. Dallga e fuqishme popullore për Liri e Demokraci, nuk mund të ndalej më. Ajo po trondiste themelet e sistemit komunist. Diktatura ishte në grahmat e fundit... U lejua pluralizmi politik. U

formua Partia Demokratike dhe filloi botimi i organit të saj, gazeta "Rilindja Demokratike". Më 5 Janar 1991, në numrin e parë të asaj gazete, emri im ishte shënuar në krye të listës së anëtarëve të Këshillit Botues.

Të nesërmen, më pritën plot buzëqeshje e përqafime shokësh e miqsh e kërcëllitje dhëmbësh, nga ata që po shkonin me errësirën.

Ndërkohë, përplasja e forcave të verbra të diktaturës me urrejtjen popullore, ishte një rrezik real, që mund ta çonte vendin në gjakderdhjen e vëllavrasjes së pashoqe.

Për këtë çështje, në numrin 3, datë 9 Janar 1991, u botua artikulli im me titull **"Abetarja e së vërtetës"** Në faqen e parë, prej atij artikulli, u mor e u shkrua me gërma të mëdha, ky paragraf:

"Popullit, zot të fateve të tij, popullit, të aftë të mendojë, i ka hije të luftojë jo me armë, por me ide. Për demokracinë, kjo është abetarja e së vërtetës".

Në ato ditë entuziaste, emri im ishte bërë i dashur e i respektuar më fort nder miq, shokë e kolegë të profesionit. Qysh në mbledhjen e parë që bëmë në Institutin e Projektimeve Nr.1, në mbështetje të demokracisë që po lindte, në anën e Partisë Demokratike, kaluan rreth 90 vetë

Mirëpo zagarët, pjellë dhe mbrojtës të sistemit që po përmbysej, meqenëse nuk mund të kafshonin dot, filluan të angullinin e të lehnin, që nga fundi i humnerës, ku i flaku koha.

Më 26 Janar 1991, në gazetën "Rilindja Demokratike", botova një artikull, të cilin po e ribotoj të plotë këtu më poshtë:

PO ARKITEKTURA?

Shumëkush, posa të lexojë titullin e këtij shkrimi, mund të thotë: "Ç'halle kemi ne, e përse na folka ky!". I japim të drejtë, por përsëri këmbëngulim në mendimin tonë se është rasti urgjent të flasim sot, madje me zë të

lartë, për arkitekturën. Pse?, do të pyesni juve

Sot po dëgjohen përherë e më shumë thirrjet për investime të firmave të huaja në ndërtimet tek ne. Thuhet se do të ndërtohen hotele në Tiranë e nëpër plazhe. Thuhet se puna e projektimit ka filluar, por është ironia e historisë sonë të dhimbshme kjo që do të përshkruaj më poshtë:

Pallati i Kongreseve dhe Muzeu në formë piramide në Tiranë, u projektuan në fshehtësinë më të madhe prej një njeriu dhe prej arkitektëve të zgjedhur sipas preferencës së tij, të cilët punuan të izoluar në një vilë të posaçme e me roje të armatosur te porta

Përseri, po i njëjti njeri, me arkitektë të zgjedhur sipas preferencës së tij, po punon në fshehtësinë më të madhe, tek e njëjta vilë, për të projektuar, në bashkëpunim me firmat e huaja, hotelet e rinj, etj.

Po, mirë Ç'të keqe ka?-do të thoni.

Dihet se arkitektura në çdo kohë, ndër të tjera, ka shprehur një ideologji të caktuar. Arkitektura e Pallatit të Kongreseve apo e Muzeut, që përmendëm, shprehin një ideologji që s'ka të bëjë me ideologjinë demokratike, e cila duhet të shprehet me ndërtesat për turizmin, etj A mund t'i bëjë këto dy lloj ndërtimesh i njëjti arkitekt? Jo! Themi jo, se historia e arkitekturës botërore na tregon të kundërtën: Kur fitoi Revolucioni socialist në Rusi, dhe bota përparimtare përshëndeste krijimin e një shoqërie të re, arkitektët e mëdhenj modernë Le Korbuzje Gropius, Majer, etj. u sulën të ndërtojnë atje e morën pjesë në konkursin ndërkombëtar për projektin e Pallatit të Sovjetëve, por ata u larguan posa filloi të sundojë ideologjia totalitare në art e në arkitekturë, që ishte kundër aspiratave të tyre demokratike. Të njëjtën gjë bënë dhe vetë arkitektët modernë sovjetikë, që ishin në pararojë, po pastaj i thyen lapsat Dëshirojmë të flasim qartë: Në këto pak radhë nuk marrim dot përsipër të bëjmë vlerësimin e kësaj apo asaj ideologjie, nëse është e mirë apo e keqe Ne këmbëngulim vetëm te ky mendim: Ai artist, që e ka vënë artin e vet në shërbim të një ideologjie,nuk e braktis dot atë për t'i shërbyer një ditë të bukur një ideologjie tjetër tërësisht të kundërt me të parën. Ai do të lartësohet, kur ajo ideologji është në ngritje dhe

do të shëmbet në u shëmbtë ajo. Historia e artit botëror këtë e thotë qartë.

Ja për shembull, Marçelo Piaçentini, arkitekti i talentuar italian, që shprehu ideologjinë fashiste të glories romane në arkitekturë, s'mund të krijonte më në kushtet e reja të shoqërisë italiane të pasluftës.

Skulptori Tomski, që pati bërë monumentin e Stalinit, s'mund të bënte dot një monument të Jan Palahut!

Po ja që arkitekti ynë mendon, se mund të kalojë lehtë nga një lloj arkitekture tek tjetra!

Para njëzet vjetësh ecëm drejt një arkitekture moderne, por shpejt filluan nofkat "moderniste" e "borgjezo-revizioniste". Ndër të tjerë këto i tha edhe arkitekti, që ka shkuar disa herë në Itali e gjetiu për ta mësuar atë arkitekturë e që po rreket të na bëjë hotelet me firmat e huaja, por harron se ai që ka shkuar dikur për ta parë dhe është entuziasmuar nga Muzeu dhe shtatorja faraonike e Kim Ir Senit, nuk e ndjen dhe nuk e kupton dot qëndrën kulturore Pompidu!.

Të dashur kolegë! Kemi fatin të jetojmë kohën e transformimeve të mëdha Deri dje pritej të bëhej gjithë Evropa si Shqipëria Sot Shqipëria po kërkon të bëhet si gjithë Evropa. Tani priten të hapen portat prej nga do të hyjnë firmat e huaja e të bëjnë shumë ndërtime në vendin tonë. Kush do t'i projektojë këto objekte?

Para disa ditësh më theri fort në zemër, kur pashë në televizion një tregtar të huaj të paraqiste projektet që do të zbatoheshin tek ne. E duam dorën e huaj ta shtrëngojmë fort si dorën e mikut dhe duam të ecim me ta krah për krah. Kemi nevojë për ndihmë dhe duam të punojmë, por jo si raja. I përbuzim fjalët e atij paralliut grek, që na u mburr duke thënë: "Juve jeni aq të varfër, sa tani nuk refuzoni asnjë propozim". Nuk na e merrte mendja të mos ia kishte mësuar e ëma, qysh fëmijë, rregullat e mirësjelljes në shtëpinë e mikut!.

Zyrtarë, që kini sot në dorë lidhjen e kontratave me firmat e huaja! Mos harroni se universiteti ynë ka nxjerrë për gati 30 vjet me rradhë kuadro që e kanë treguar veten se s'janë të fundit në botë! Populli ynë thotë: "Kali i mirë do mejdan". Hapuani specialistëve tanë mejdanin. Bëni lidhje me firmat e huaja ku të gjejnë kushte të

përshtatëshme pune specialistët tanë. Mos e varfëroni edhe më tej vendin, duke i shtyrë ata të bjerrin rininë e aftësinë "Te dheu i huaj" e të hanë bukën e hidhur të mërgimtarit.

Të dashur kolegë! Për vite me rradhe ju lanë pa libra e pa revista arkitekture. Shumë, shumë pak prej jush patën mundësi të shohin diçka nga arkitektura moderne botërore. Nuk jeni të përgatitur për të përballuar detyrat e mëdha, që dalin përpara sot. E megjithatë kërkohet të bëhet mbinjerëzorja! Arkitekturën në Shqipëri na duhet ta bëjnë arkitektët shqiptarë! I duam dhe i mirëpresim arkitektët e huaj modernë me më shumë talent e përvojë nga ne. Duam të mësojmë, po të themi dhe fjalën tonë.

Ju e dini rolin që luajti Le Korbuzje në futjen e arkitekturës moderne në Amerikën Latine, po të mos harrohet se ai atje gjeti një plejadë të tërë arkitektësh vendas entuziastë, si Oskar Nimajer e Luçio Kosta me shokë. Prandaj guxoj ta përsëris: Arlitekturën moderne në Shqipëri na duhet ta bëjnë arkitektët shqiptarë! Të dashur Kolegë! Përpiquni për këtë. Kërkojeni këtë. Çojeni zërin ta dëgjojnë ata që lidhin kontratat me firmat e huaja, ku ju të hyni jo si argatë të thjeshtë, po si bashkëpunëtorë të denjë. Shkolleni, shtypeni me forcë në fund të ndërgjegjes suaj kompleksin e inferioritetit të kultivuar nga kushtet e kohës dhe shiheni syhapur, drejt, diellin që po lind. S'ka gjë se ju lotojnë sytë. Janë lot gëzimi! Nga ju arkitektë të lodhur, të munduar, të përçmuar,të deziluzionuar, pritet të dalin sot heronj. Jo heronj me shpata e jataganë, po me moral të lartë patriotik. Të tillë kërkohet të jini juve, që do të kini fatin të projektoni ndërtesat e para e demokratike të Shqipërisë së nesërme. U vaftë mbarë!

Më 31 Janar 1991, dmth pas 5 ditësh të botimit të artikullit, mora një letër anonime të mbushur me ndyrësira. Këtë letër e kam ruajtur tok me dokumenta të tjera, për ta parë ata që do të vinë pas nesh se ç'fytyrë kishin të

pafytyrët e kohës sonë.

Pas fitores së Partisë Demokratike më 22 Mars 1992, mora përsipër kryerjen e reformës në ISP Nr.1 e Nr.4, duke shkuar atje si Drejtor.

Se ç'bëra mirë e keq në atë punë, do ta thonë nesër njerëzit gjakftohtë. Unë sot them vetëm se e bëra në mënyren më të hapur e demokratike, me paanësinë më rigoroze dhe se munda të shpëtoj farën për rimëkëmbjen e atyre Instituteve, që do të ishin shkatërruar përfundimisht

Por edhe këtu, lehjet e zagarëve nuk pushuan. Mora disa letra anonime me ofendime e kërcënime. të cilat nuk vlenin më shumë se sa t'i grisja e t'i hidhja në plehrat prej nga kishin dalë. Në ato ditë nuk ishte e vështirë ta gjeje se ç'ndyrësirë i kishte shkruar ato letra, por s'meritonin t'u kushtoje vëmendje as një minutë

Për më tepër, unë e dija se H.Hajne, për këso rastesh, thotë:

Më e tmerrshmja nga të gjitha
Eshtë lufta me instiktet,
Që kanë armë qelbësirën,
Dyluftimi me një çimkë,
Se dhe ta shtypësh,
Ajo të ndyn.

FJALET E FUNDIT

Ja pra këtu mbaron një jetë profesionale e trazuar dhe e shqetësuar. Vitet kalojnë e marrin me vete jehonën e dallgëve të saj, ndërsa unë përjetoj brengën e Taras Shevçenkos:

"Mendime, të shkreta mendime,
e kam pisk me ju mendime..."

Dhe ndërsa bluaj e ribluaj mendime, në këto çaste zymtie, fillojnë e stisen vargjet e një poezie, që rreh të mbyllë këtë shkrim:

Rri në shtëpi
Si ariu në strofkën e tij,
Por s'dua të fle,
Të bie në letargji
Dhe nis lëpij
Plagët e vjetra,
Madje i kruaj fort,
Sa i gjakos,
Me kthetra.
Dhe kështu dita sos
Dhe natë vjen
E qetësi...
Po unë s'dua të fle,
Të bie në letargji
Dhe nis lëpij
Plagët e vjetra,
Plagë që nuk shërohen kurrë.
Plagë, që kullojnë
E do kullojnë gjak
Dhe kur të më vënë kapak
Me gurë.

Tiranë, më 2 Prill 1996

SHENIME PLOTESUESE

(1) f.9

Tani, që po i rikujtoj ato kushte, çuditem se sa të urtë e të bindur (apo të shtypur?) kemi qenë!

Nga shkolla e konvikti (sot shkolla Q.Stafa), shkonim në mencën kundrejt stadiumit S.Stermasi, që në mëngjes, të pinim një gotë alumini me të ashtuquajturin çaj dhe një copke marmalate. Racionin e bukës (600 gr në ditë) e mbaronim një ditë më parë. Në drekë, një supë me makarona e një lëng të kuq, që quhej yndyrë. Tri-katër herë në javë nga një copkë mish. Gjellë me presh, lakër, kungull, etj.

Dy vjetët e parë, buke misri. Më 7, 8 e 29 Nentor, ëmbëlsirë! Dy lugë allve...

Dhomat e fjetjes nga 5, 6 deri në 12 vetë. Asnjë lloj ngrohje. Larje në banjot publike dimër-verë, afër sheshit A.Rustemi.

Të veshur keq. Gjithmonë me këmbë të lagura. Njëri, që dukej se kishte pallto të mirë, kishte pallton e vjetër të babait të kthyer mbrapsht.

Njëri nga studentët (A.B.) kishte një palë pantallona. Pjesa e tyre përmbi gjunjët ishte holluar e vjetëruar dhe ai hekuroste vetëm pjesën nga gjunjët e poshtë, pjesën që i dilte poshtë palltos.

Një student tjetër (Z.S.) në vend të shallit, vinte peshqirin.

Nuk do ta harroj festimin e Vitit të Ri 1953! Nja pesë-gjashtë shokë, me ato çikë lekë të kursyera nga bursa, dolëm të blinim ndonjë pije. Atëherë nuk kishte as birrë, as verë, as raki. Gjetëm e blemë një shishe gjysëm litri liker (që s'ishte veçse alkool me sheqer e ngjyrë jeshile) e që quhej "Lule mali". Asnjë lloj embëlsire. Mundëm të

blinim vetëm nga dy prej atyre biskotave të famshme, që quheshin me tallje "ingranazhe". Radio nuk kishim. Bëmë sikur kënduam të trallisur nga alkooli i likerit. Kështu e festuam Vitin e Ri...

Keq ishin dhe kushtet e mësimit. Tekste pergjithësisht nuk kishim. Gjatë orëve të mësimit ktheheshim në automatë shenime mbajtës. Mjetet e punës mungonin. Mësimin e gjeodezisë e bënim me një instrument të stërvjetër, që me tallje, e quanin Astrollap.

Vizatimet i bënim me rriga (trikëndesha) druri të vjetër, shpesh të shtrembët, të huazuar nëpër miq e shokë. Dhe të doje të blije, nuk gjeje dyqan që të shiste gjëra të tilla. Mund të vazhdoj të shkruaj pa fund, por po e mbyll me atë shprehjen tiranase: Qoftë për ateherë...

(2) F.43

Gjithë sa ndodhën aty, e kam përshkruar në bazë të bisedave të atëherëshme me kolegët dhe të bashkëbisedimeve kohët e fundit me z. prof.Besim Daja dhe piktorin K.D., i cili me tha se po i shkruan edhe vetë këto kujtime.

(3) F.46

Ndërtimi i katit përdhè të kësaj godine me kollonadë e trotuar të mbuluar, sot mund të duket i pakuptimtë, por çështja qëndron kështu:

Të mos harrojmë se jemi në kohën, kur qendra e Tiranës ende nuk kishte një zgjidhje përfundimtare urbanistike dhe ndërtimet aty ishin të vjetra e pa vlerë. Në një bisedë profesionale shoqërore ndërmjet arkitektësh e inxhinierësh më të vjetër, që e njihnin Evropën, u hodh e u pëlqye ideja e ndërtimit të Qendrës së Tiranës me godina, që e kanë katin përdhè me kollonada e trotuarë të mbuluar siç janë disa qytete të njohur të Rilindjes Italiane e të Evropës Qendrore.

Kjo ide e pëlqyeshme, që u lejonte këmbësorëve të qarkullonin nëpër qendrën e qytetit të mbrojtur nga shiu i shumtë dhe vapa përvëluese e Tiranës, u zbatua në fillim te kjo godinë, e vazhdoi Ibrahim Prushi te godina

e gjatë në Rr.Luigj Gurakuqi e pastaj arkitekti bullgar Kozhubarov në projektidenë, që bëri për ndërtimet e banesave në anën lindore të rrugës së Barrikadave. Por kjo mbeti vetëm projektide.

Studimet e mëvonëshme urbanistike dhe ndërtimet e mëpastajme, nuk e mbështeten idenë e ndërtimeve me kollonada e trotuarë të mbuluar. Ato pak sa u bënë, mbetën fragmente e nuk luajnë rolin e duhur.

(4) f.55

Absurditeti arriti deri atje, sa më thanë:"Shoku Enver ka pëlqyer e miratuar fasadën, jo planimetrinë. Prandaj, mbaj këtë fasadë dhe përdor seksionin tip".

Vetëkuptohet, që kjo ishte e pamundur të bëhej dhe mbeti planimetria që kisha bërë, duke i zvogëluar detyrimisht sipërfaqet e ambienteve.

(5) F.71

Pasi ishte ngritur dallga e kritikave për bibliotekën, që ende ishte karabina, shkova tek Ministri Th.Deliana për të më dhënë fondet e premtuara për ndritçuesa, dritare duralumini, etj., por atëherë edhe atij po i vinte festja rrotull dhe ma tha me keqardhje: "Tani s'bëj dot gjë. Shiko ç'do të mundesh të bësh vetë". Pra, askund asnjë përkrahje. Në këto kushte, shkova në Korçë dhe sajova një lloj fanari me xhama për ndritçimin nga sipër të sallës së leximit, që u zbatua me materiale të papërshtateshme e në mënyrë artizanale, por që gjithsesi për ca kohë nuk funksionoi keq, ndërsa dyert e dritaret u bënë të gjitha prej druri.

(69 F.79

Vetëkuptohet se fillimi i bisedës nga diktatori me ton lajkatar, s'ishte veçse taktika e tij e njohur, e cila fshihte qëllimin djallëzor, që ca nga frika e kundërshtimit e ca nga mirsjellja, të më bënte të pranoja haptas, duke thënë me gojën time para të gjithëve, se kisha bashkëpunuar me Todi Lubonjën.

Në këtë mënyrë, dënimi për mua bëhej fare lehtë, sepse fare lehtë mund të ma vinte vulën poshtëruese:

"Këlysh i Todi Lubonjës", shprehje që siç dihet, diktatorit i pëlqente fort ta përdorte.

Duke kundërshtuar me të drejtë atë bashkëpunim, mbase evitova një të keqe të madhe, por s'mund të lihesha pa u dënuar për kundërshtimin pa takt ndaj atij, që s'mund t'i bëhej fjala dy.

Atmosferën e rëndë, që u krijua pas atij kundërshtimi, e dinë ata që ishin të pranishëm asaj dite ose ata që dëgjuan jehonën e thashethemeve të atyre ditëve, por peshën e vërtetë e di unë, që mbeta i vetëm, kur të gjithë largoheshin pa më thënë as një fjalë dhe vetëm ndonjeri, nga larg, guxonte të hidhte fshehtas një vështrim të shpejtë, që shprehte tmerr.

(7) f.81

Disa kolegë, ish pjesmarrës në atë mbledhje, të cilët e lexuan këtë libër në dorëshkrim, shprehën dëshirën këmbëngulëse, që ta përshkruaja hollësisht mbledhjen e atëherëshme.

Duke respektuar dëshirën dashamirëse të këtyre kolegëve, them se, meqë isha në qendër të goditjeve të asaj dite, isha tepër i tronditur dhe shumë gjëra më kanë shpëtuar.

Me këtë rast, do t'u propozoja të gjithë kolegëve që u ndodhën atje, të mos ngurrojnë t'i shkruajnë mbresat e tyre nga ajo mbledhje. Mozaiku i përshtypjeve të gjithësecilit, besoj se do ta japë të plotë atmosferën e rëndë, që u krijua e që i solli aq shumë dëme arkitekturës shqiptare dhe arkitektëve.

(8) f 83

Në këtë kohë, në Institutin Shtetëror të Projektimeve Nr.1, erdhën njëri pas tjetrit, çupa e dhëndëri i diktatorit, si dhe katër bij e bija të anëtarëve të tjerë të Byrosë Politike të PPSH, ndërsa e bija e Hysni Kapos, pushtoi katedrën e arkitekturës së UT.

A nuk ju duket se nxorri ca si shumë arkitektë ajo Byro?

Shumë shpejt, këta bij të Byrosë, në Institutin e Projektimeve, filluan të rrëmbenin çdo projekt të

rëndësishëm. Në këtë rrugë, printe dhëndërri i diktatorit, duke shfrytëzuar mundësitë e pakufizuara që i siguronte krushqia dhe posti i lartë zyrtar

Për këto objekte nuk kishte kursime fondesh e valute e as ndonjë fjalë për ndikime nga arkitektura perëndimore. Doemos, tani projektonin bijtë e Byrosë!

Për këto çështje, u bie të flasin sot atyre kolegëve, që nuk ishin bashkëpunëtorë të ndërgjegjshëm të atij, që u shfrytëzoi krijimtarinë.

PJESE NGA SHKRIMET E BOTUARA TË AUTORIT MBI ARKITEKTUREN

Në kushtet e vështira të kohës së diktaturës, me shkrimet mbi arkitekturën që munda të botoja, edhe se me ngarkesën e pashmangshme të ndonjë shprehje konformiste, munda të tregoja disa nga problemet që shqetësonin arkitektët dhe që shkatërronin arkitekturën.

Nga artikulli: *"Bisedë mbi arkitekturën"* (DRITA, 1 Gusht 1965)

"Arkitektura e vërtetë - shkruan arkitekti i përmendur F.LL.Rajt - është poezi. Një ndërtesë e mirë organike është më e madhja ndër poemat.

Kurse Gëte - thotë: "Arkitektura është muzikë e gurosur.

Ne duhet të bëjmë që në banesat tona, në shkollat, në fabrikat, të ndjehet kjo poezi, të degjohet kjo muzikë"

"Arkitektura jonë duhet t'u përshtatet kërkesave dhe shijes së kohës.

Banesa jonë nuk është më vënd mbrotjeje e luftimi, por është vënd prehje, gëzimi e kenaqësie dhe do të na japi aq gëzim e kënaqesi, sa më komode të jetë...

Dritarja s'ka pse të jetë një vrimë në mur prej nga hyn me zor dielli. Nuk duhet të jetë ndarëse, por bashkuese e ambientit të brendshëm me natyrën. Vetë natyra e gjallë të jetë, nëpërmjet dritares, si një kuadër peisazhi në dhomën tonë. Banesa jonë duhet të jetë e mbytur në mes të gjelbërimit, që ta bëjë të këndshme e të shëndetshme jetën."

"Arkitekti varet gjithmonë nga materialet me të cilët duhet të ndërtoje. Të paret patën gurët. qerpiçin, tullat dhe me to ndërtuan. Ne kemi beton-armenë hekurin, xhamin. Me to duhet të ndërtojmë."

"Ne sot duhet të ndërtojmë ndryshe, me një stil tjetër, jo nga mania për të dhënë diçka të re kot më kot, por sepse me ndryshimin e epokave, të rendeve shoqërore, të kushteve materiale e teknike, ndryshojnë mundësitë dhe mënyrat e ndërtimit, ndryshojnë kërkesat, ndryshon shija dhe kuptimi i së bukurës. Si pasojë, ndryshon arkitektura."

"Arkitektura klasike - thoshte arkitekti A.K.Burov - është shkruar, si të thuash, "latinisht". Këtë latinishte të arkitekturës duhet ta dish, por duhet të flasësh në gjuhën tënde dhe të ndërtosh në përputhje me kohën."

Nga artikulli: *"Një vështrim kritik ndërtimeve tona"*
(Z.Pop. 28 Janar 1966)

"Banesat tip, të fshehura nën variantet e fasadave, që jeta i provoi se nuk ishin variante, u ndërtuan jo vetëm në të gjithë qytetet, por dhe në qendrat e vogla bujqësore. Pak ndryshueshmëri nga ndërtesa në ndërtesë, nga ndërtimet në një rrugë tek ndërtimet e një rruge tjetër, nga ndërtesat e një qyteti tek tjetri."

"Është fakt i njohur historikisht dhe problem (por jo i pazgjidhur) i arkitektures botërore, se ndërtimi me seksione tip dhe i industrializuar paraqet rrezikun e monotonise. Këtë rrezik ne nuk e kemi mënjanuar, por e kemi shtuar."

"Në ndërtimet tona do të fillonte një erë e re, po të viheshin në përdorim konstruksionet prej betonarmeje të paranderur.

Futja e këtyre metodave në ndërtim kërkon një projekt të bazuar në parime të tjera nga ato të ndërtimit tradicional dhe jep në mënyrë të natyrshme pamje të reja të ndërtesave, duke i dhënë një grusht të fortë monotonisë."

"Na duhet doemos dhe menjëherë të kemi një ngritje të theksuar kualitative në arkitekturë. Duhet të futim në arkitekturën tonë parimet më të shëndosha të arkitekturës moderne. Të përfitojme nga shembujt e saj më pozitivë.

Nga artikulli: *"Probleme urbanistike dhe arkitektonike të Tiranës"* (Z.Pop. 7 Qershor 1970)

"...Në planin ekzistues urbanistik të qendrës së Tiranës, me gjithë përpjekjet, ka mbetur i pazgjidhur problemi i qarkullimit të automjeteve në shesh. Ashtu siç parashikohet në plan, sheshi mbetet, sic është edhe sot, një nyje trafiku.

Lënia e trafikut në shesh dhe kryqëzimi i tij me vijat e kalimit të këmbësorëve përbëjnë, siç thuhet në literaturën përkatëse, metodën më të mirë për të shkatërruar një qendër qyteti.

...Nuk është aq i pakët sa kujtohet qarkullimi i makinave në qendrën e Tiranës. Por pas 50 vjetësh sa do të jetë ky qarkullim?"

Në të vërtetë koha eci tepër shpejt dhe jo pas 50, por pas 20 vjetësh ndodhi ajo që s'mund ta shkonte nëpër mend njeri. Sot të gjithë e shohin se sa të vështirë e kanë këmbësorët të kalojnë qendrën e Tiranës. Lënia e trafikut automobilistik në shesh e ka shkatërruar qendrën që duhet të ishte një vend i qetë takimi e argëtimi për kembësorët.

"E keqja më e madhe sot është se të ndërtuarit pa patur të qartë perspektivën e ndërtimeve përreth ka filluar të kërcënoje tani edhe qendrën. Ndërtesa nga më të zakonshmet për ditë e më shumë po i afrohen qendrës...

Një ndërtim i tillë i pakoordinuar me zgjidhjen e qendrës në tërësi është i gabuar e i dëmshëm."

"Nëqoftëse deri para disa vjetësh, për arsye të shumta objektive, ishte e mjaftueshme ose e pranueshme të ecej sipas atij plani rregullues me vija të trasha, sot kur ritmi i ndërtimeve është shtuar dhe po shtohet gjithmonë e më tepër dendësia e ndërtesave në qytet, është e domosdoshme të kalohet në studime më të hollësishme."

Për fat të keq këto fjale janë bërë më aktuale sot, pas njëzet e pesë vjetësh dhe përsëri, për fat të keq, si atëherë edhe sot janë një *Vox clamans in deserto.*

Nga diskutimi në Takimin Kombëtar të Arkitektave
(Nëntori 6/1971)

Profesioni ynë na ngarkon me përgjegjësi të madhe ndaj shoqërise. Guxoj të them, madje, me përgjegjësi më të madhe se sa mjekët apo pedagogët...

Duhet ta kuptojmë se sa përgjegjësi të madhe kemi ndaj shoqërisë, e cila na ka dhënë në dorë një lapës dhe tok me të edhe dhjetra milionë lekë, na ka lënë në dorë rrugët, ndërtesat, gjelbërimin, qytetet dhe fshatrat. Na ka besuar ndërtimin e Shqipërisë së sotme e të nesërme.

Ajo që bie më shumë në sy në rradhët tona është mungesa e njohjes së thelluar të profesionit nga ana teorike. Përgjithësisht në punën tonë mbizotërojnë dilentatizmi dhe prakticizmi.

Njohja e historisë së arteve dhe historisë së arkitekturës në veçanti si mjet interpretimi i fenomeneve të sotëm, mungon.

Përveç boshllëqeve të kulturës teknike, ndër në kultura e përgjithshme ka mbetur e cekët dhe fragmentare.

Duhet të jemi të bindur se nëqoftese arkitektët nuk do të behën pjesa më e kulturuar e intelektualëve të vendit tonë, të mos kemi asnjë iluzion për ndonjë ndryshim të dukshëm në arkitekturë.

Nga intervista dhënë revistes "Ylli" **(Shtator 1971)**

Pasurinë arkitektonike që trashëgojmë nga e kaluara, një pasuri të çmuar, e dimë, e njohim në vija të përgjithshme.

Por, lind pyetja: A duhet të marrim sot dicka nga kjo trashëgimi? S'ka asnjë dyshim! Të gjitha degët e tjera të artit dhe të kulturës, gjatë rritjes dhe zhvillimit të tyre, ruajnë vazhdimësinë nëpërmjet huazimeve nga e kaluara, por të shprehura këto në frymën e kohës.

Lindi një arkitekturë e re e cila, megjithëse s'është kristalizuar tërësisht, ka filluar të formojë tiparet e veta moderne. Tani, duhet medoemos që këto tipare të kenë diçka shqiptare. Arkitektura jonë duhet të jete moderne, por njëkohësisht të dallohet që atje tutje se është shqiptare.

Shumë vende kanë hyrë në kërkim të profilizimit të arkitekturës moderne me tipare kombëtare. Këtu mund të përmendim shembujt më të mirë të arkitekturës moderne në Meksikë, ku është shfrytëzuar në mënyrë krijuese visari kultural Astek. Mund të kujtojmë veprat kryesore të arkitekturës moderne japoneze. Shembuj, ku më pak e ku më shumë të goditur, ka në të gjithë botën.

Detyra jonë si projektues është që të fillojmë të ecim në këtë drejtim. Rruga është e gjatë. E përpjetë. Humbet shpesh herë në mes të shkurreve të keqkuptimeve, por duhet të ecim medoemos.

Nga artikulli: *"Ndërtim që e zbukurojmë, apo bukuri që e ndërtojmë"* (Z.Pop.19 Mars 1972)

"Duhet të kuptohet se çdo arkitekturë është e lidhur pazgjidhshmërisht me epokën e saj dhe që ajo mund ta shprehë veten vetëm me format e kohës dhe vetëm me gjuhën e kohës.

Dhe asnjëherë s'ka qenë ndryshe.

Gjithmonë e gjithmonë bëhemi dëshmitarë të asaj që arkitektë të talentuar dështojnë, kur vepra e tyre nuk shkon në një hap me kohën"

"...Përherë e më dendur shfaqen në arkitekturën e kohës sonë forma që arkitekturat e kohëve të mëparshme nuk i kanë patur pasi nuk ishte e mundur t'i kishin. Mbulesat me hapësira të mëdha prej armo-cementi, mbulesat e ndryshme me kurbaturë të dyfishtë, mbulesat e varura etj. me format e tyre të çuditshme e të panjohura deri më sot, nuk duhet të na bëjnë të stepemi. Ato janë përfundimi logjik i evolucionit dhe madje i revolucionit në fushën e konstruksioneve."

Por ajo që këtë artikull, të ashtuquajtur të zi, e bëri edhe më të zi, ishte fragmenti i mëposhtëm:

"Arkitekturës sonë tani po i del në horizont një tjetër rrezik për monotoni, të cilin nuk duhet ta lënë të na futet në liman. Këtu e kemi fjalën për monotoninë që mund të sjellin ndërtimet e ardhshme të banesave me pjesë të montueshme të parafabrikuara."

Fjalët e paragrafit të fundit u quajtën si armiqësi ndaj R.P. të Kinës e cila na jepte uzinën e prodhimit të paneleve b/a. për ndërtimin e banesave.

Koha provoi vërtetësinë e këti jparashikimi, por atëherë mua më dërguan tek ajo uzinë me shprehjen cinike: *"Ty, që nuk të pëlqejnë, shko rregulloi."*

Për këtë çeshtje, me një grup specialistësh, bëmë disa studime për ndryshime e përmirësime të mundshme, por Ministrisë i hynë nga njëri vesh e i dolën nga tjetri. Me ato

panele prej betonarmeje u ndërtuan mbi 20 000 apartamente. Banorët e gjorë, të gëzuar atëherë se merrnin një copë banesë, provuan gjatë viteve lagështinë, të ftohtit e zhurmat, ndërsa Shqipëria u mbush me pamjet e tyre monoton



AUTORI, inxhinier i posadiplomuar.
Korrik 1957



Një ndër projektet e parë të zbatuar.
Apartamente banimi në tiranë, pranë kinema
"PARTIZANI" viti 1958



Maket i njërit prej projektideve të Postës në Tiranë
Viti 1960
(shih shkrimin faqe 43 - 45)



Me arki. S. Luarasi dhe ark. E. Dobi
duke parë maketin e Senatoriumit në Tiranë.
Viti 1959



Pamje e banesës prapa Bankës në Tiranüe.
Viti 1963 përfundoi ndërtimi.
(shih shkrimin faqe 45 - 47)



Apartamente banimi në Korçë,
pranë kinema "MORAVA".
Viti 1964 mbaroi ndërtimi



Apartamente banimi në ish fusha e tenisit në Korçë.
Viti 1965 mbaroi ndërtimin
(shih shkrimin faqe 49 - 51)



Apartamente banimi në ish-fusha e tenisit në Korçë.
Viti 1965



Shkolla 12-vjeçare në Korçë.
Viti 1969 mbaroi ndërtimi.
(shih shkrimin faqe 51 - 53)



Shkolla 12-vjeçare në Korçë.
Viti 1969



Banesa shtatë katëshe në Korçë.
Viti 1968 mbaroi ndërtimi
(shih shkrimin faqe 53 - 55)



Banesa shtatë katëshe në Korçë.
Viti 1968 mbaroi ndërtimi

Banesë në Tiranë, përkundrejt "Bllokut".
Viti 1969
(shih shkrimin faqe 59 - 60)



Një nga projektidetë për hotelin "Tirana".
Viti 1972
(shih shkrimin faqe 66 - 68)



Një nga projektidetë për hotelin "Tirana".
Viti 1972

Te çezma afër Quksit, pas kthimit nga Jugosllavia.
(shih shkrimin faqe 66 - 68)



Biblioteka e Korçës. Viti 1980 mbaroi ndërtimi.
(shih shkrimin faqe 71 - 83)

Ish kisha e Shen Gjergjit, Korçe,
kur kishte filluar ta prishnin.
Viti 1967



Pamje e agjensisë ajrore në Tiranë.
Viti 1975
(shih shkrimin faqe 84 - 85)



Banesë për diplomatët e huaj në Tiranë.
Pamje gjatë ndërtimit. Viti 1974.
(shih shkrimin faqe 88)



Variant projektide për Muzeun Historik Kombëtar.
Viti 1979
(shih shkrimin faqe 97 - 100)



Foto e projektidesë të Muzeut Historik Kombëtar
Viti 1979
(shih shkrimin faqe 97 - 100)



Një nga variantet e projektidesë për Konkursin e Varrezave të Dëshmorëve në Tiranë.
Viti 1968



AUTORI në fund të një kariere të vështirë
Viti 1995

PETRAQ KOLEVICA
Ka botuar edhe këta libra:

Origjinale:
Këngë nga koha e keqe
Lasgushi më ka thënë

Përkthime:
Demoni
Poezi gjermane dhe austriake
Perla nga perlat
Nektar poetik

MARIN BARLETI